Ilmihal Praktik

Dr. Osman Bilgen

Ilmihal Praktik

Dr. Osman Bilgen

Copyright © Shtëpia Botuese PRIZMI

ILMIHAL PRAKTIK

Titulli origjinal turqisht:

PRATİK İLMİHAL

Autor: Dr. Osman Bilgen

Editor: Ali Budak, Muharrem Yıldız

Përktheu: Aisa Kokiçi

Redaktoi: Dorian DEMETJA

Design: MS Design

Isbn: 978-99956-767-5-9

Shtëpia Botuese PRIZMI, Tiranë

Adresa: Rr. Muhamet Gjollesha

Tel: 042234586

www.prizmi.com

prizmi@prizmi.com

Shtypur në Shtypshkronjën Arbëria. 2010

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	13
HYRJE	15
NJERIU	15
PSE ËSHTË KRIJUAR NJERIU?	16
FEJA	16
FEJA ISLAME	18
PJESA E PARË	23
BAZAT E BESIMIT	25
1. BESIMI NË ALLAH	26
GJITHËSIA U KRIJUA RASTËSISHT?	27
ATRIBUTET E ALLAHUT	28
A. Atributet individuale (dhati)	28
B. Atributet qenësore (thubuti)	29
NJERIU QË BESON ALLAHUN....	30
2.BESIMI NË ENGJËJT	30
KRIJESAT E TJERA JOLËNDORE	31
XHINDI	31
SHEJTANI	32
NJERIU QË BESON NË ENGJËJT	33
3.BESIMI NË LIBRAT	34
SHPALLJA	34
LLOJET E SHPALLJES	34
FLETËT (SUHUF)	35
LIBRAT	35
NJERIU QË BESON LIBRAT	36
4. BESIMI NË PROFETËT	36

PROFETËT E PËRMENDUR NË KURAN 38
NJERIU QË BESON PROFETËT 38
5. BESIMI NË AHIRET 39
NJERIU QË BESON AHIRETIN 39
BESIMI NË KADER (CAKTIMIN E ALLAHUT) 40
NJERIU QË BESON NË KADER 40
DISA ÇËSHTJE LIDHUR ME BAZAT E BESIMIT 40

PJESA E DYTË 59
VEPRAT E TË OBLIGUARIT DHE PASTËRTIA 59
VEPRAT E TË OBLIGUARIT 61
Kur fillon obligimi? 61
Ç'do të thotë mosha e pjekurisë? 62
Kur fillon mosha e pjekurisë? Si mund ta dimë? 62
Cilat janë detyrat fetare të një të obliguari? 63
PËRGATITJA PËR NAMAZ 64
ABDESI 64
FARZET E ABDESIT 65
SUNETET E ABDESIT 66
MARRJA E ABDESIT 67
GJËRAT QË PRISHIN ABDESIN 70
GJËRAT QË NUK E PRISHIN ABDESIN 70
ABDESI I PERSONIT TË JUSTIFIKUAR 70
MES'HI MBI FASHË DHE MESTE 71
FËRKIMI MBI FASHË 71
MES'HI MBI MESTE 72
GUSLI 73
KUR DUHET MARRË GUSUL 73
FARZET E GUSULIT 75
ÇFARË DUHET PASUR KUJDES GJATË MARRJES SË GUSULIT 76
GJËRAT E NDALUARA PËR PERSONAT QË DUHET TË MARRIN GUSUL 76
GJËRAT MEKRUH PËR PERSONAT QË DUHEN TË MARRIN GUSUL 77
TEJEMUMI 77

FARZET E TEJEMUMIT 78
SI MERRET TEJEMUMI? 78
RASTET QË PRISHIN TEJEMUMIN 79
GJENDJET SPECIFIKE TË FEMRAVE 79
Menstruacionet (hajdi) 79
Lehonia (nifasi) 80
Istihadha 81
Gjërat e ndaluara kur femra është në periudhën e menstruacioneve dhe të lehonisë 81
ÇFARË DUHET TË BËJNË FEMRAT NË GJENDJET SPECIFIKE? 82
DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME ABDESTIN DHE GUSULIN 82

PJESA E TRETË 87
NAMAZI 87
EZANI 89
IKAMETI 90
NAMAZI 90
KOHËT E NAMAZEVE 92
KUSHTET E NAMAZIT 92
SHTYLLAT E NAMAZIT 94
VAXHIBET E NAMAZIT 95
SUNETET E NAMAZIT 95
MEKRUHET E NAMAZIT 96
RASTET QË PRISHIN NAMAZIN 96
SI FALET NAMAZI 97
TABELA E NAMAZEVE 105
NAMAZI I SABAHUT 105
NAMAZI I DREKËS 107
NAMAZI I IQINDISË 109
NAMAZI I AKSHAMIT 110
NAMAZI I JACISË 111
NAMAZI I VITRIT 112
NAMAZI I XHUMASË 112
NAMAZI I BAJRAMIT 113
NAMAZI I TERAVISË 114

NAMAZI I UDHËTARIT 115
NAMAZI I XHENAZES 115
SI FALET NAMAZI I XHENAZES? 115
NAMAZET KAZA 116
NAMAZI ME XHEMAT 116
SEHVI SEXHDJA 119
SEXHDJA E TILAVETIT 119
DISA NAMAZE NAFILE 120
NAMAZI EVVABIN 120
NAMAZI I DUHASË 120
NAMAZI TEHEXHUD (NATËS) 121
NAMAZI TESBIH 121
TAHIJJETUL MESXHID 122
NAMAZI I NEVOJËS (HAXHET) 122
NAMAZI ISTIHARE 123
FALJA E DY NAMAZEVE NË NJË KOHË (XHEM) 124
NJERIU QË FAL NAMAZ 125
DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME NAMAZIN 126

PJESA E KATËRT 137
AGJËRIMI 137
FARZET E AGJËRIMIT 140
LLOJET E AGJËRIMIT 140
RASTET QË PRISHIN AGJËRIMIN 141
RASTET TË CILAT PRISHIN AGJËRIMIN DHE KËRKOJNË VETËM KAZANË 141
RASTET TË CILAT PRISHIN AGJËRIMIN DHE KËRKOJNË KAZA DHE KEFFARET 142
GJËRAT MEKRUH PËR AGJËRUESIN 142
RASTET TË CILAT NUK PRISHIN AGJËRIMIN 143
AGJËRUESI.... 143
FITRI 144
KEFARETET 145
1. KEFARETI I AGJËRIMIT TË RAMAZANIT 145
2. KEFARETI DHIHAR 147
3. KEFARETI I BETIMIT 147

4. KEFARETI I TË QETHURIT 147
5. KEFARETI I VRASJES SË NJË PERSONI 148
ITIKAFI 148
KUSHTET E ITIKAFIT 148
ETIKA E ITIKAFIT 149
GJËRAT QË E PRISHIN DHE NUK E PRISHIN ITIKAFIN 150
DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME AGJËRIMIN 151

PJESA E PESTË 155
ZEKATI 157
KUJT DUHET T'I JEPET ZEKATI 158
KUJT NUK MUND T'I JEPET ZEKATI 159
MALLRAT QË MUND TË JEPEN ZEKAT 159
NJERIU QË JEP ZEKAT 161
PREMTIMI 161
KUSHTET E PREMTIMIT 162
KURBANI I PËRKUSHTUAR 163
DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME ZEKATIN 164

PJESA E GJASHTË 167
HAXHI 169
Kushtet e detyrimit të haxhit 169
Kushtet që duhet të plotësoje personi që kryen haxhin: 170
KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË HAXHIT 170
SHTYLLAT E HAXHIT 171
Qëndrimi në Arafat 171
1. TAVAFI I VIZITËS 171
VAXHIBET E HAXHIT 172
1. Vrapimi mes kodrave Safa dhe Merve 172
2. Qëndrimi në Muzdelife 173
3. Goditja me gurë e shejtanit 173
4. Qethja tërësisht e flokëve ose shkurtimi i tyre 174
5. Tavafi i lamtumirës 174
SUNETET E HAXHIT 174
ETIKA E HAXHIT 174
UMRE 175

SI BËHET UMREJA 175
LLOJET E HAXHIT 176
A. Llojet e haxhit sipas konkluzionit 176
B. Llojet e haxhit sipas përbërjes 177
Haxhi ifrad 177
Haxhi temettu 177
Haxhi kiran 177
Kushtet e haxhit Temettu dhe Kiran 178
Njeriu i cili bën haxhin 178
DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME HAXHIN 179

PJESA E SHTATË 183
KURBANI 183
KUSHTET E THERJES SË KURBANIT 185
KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KAFSHA PËR KURBAN 186
Mangësitë të cilat pengojnë bërjen kurban të kafshës 186
Mangësi të cilat nuk pengojnë bërjen kurban të kafshës: 187
MËNYRA E THERJES SË KURBANIT 188
KURBANI AKIKA 188
DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME KURBANIN 189

DISA SURE DHE DUA 193
SURJA FATIHA 193
SURJA FIL 194
SURJA KUREJSH 195
SURJA MAUN 196
SURJA KEUTHER 197
SURJA KAFIRUN 198
SURJA NASR 199
SURJA MESED 200
SURJA IHLAS 201
SURJA FELEK 202
SURJA NAS 203

SUBHANEKE 204
AJETUL KURSI 204
DUAJA E KUNUTIT 204
ETTEHIJATU 204
SALAVATET 205
DUAJA 205
Burimet që janë shfrytëzuar 206

PARATHËNIE

Çdo mysliman duhet të ketë njohuri fetare të mjaftueshme për të praktikuar fenë e tij. Njohuritë e nevojshme që duhet të ketë një mysliman rreth adhurimit quhen '*ilmihal*'.

Ilmilahet zënë një vend të rëndësishëm në jetën fetare të myslimanëve. Për nga përmasat dhe sipas kohës apo kushteve, ilmihalet mund të jenë të gjatë ose të shkurtër, por në përgjithësi përmbajnë njohuritë themelore të domosdoshme për praktikimin e fesë në jetën e përditshme të myslimanëve.

Libri që mbani në dorë është përgatitur duke vlerësuar ato çështje me të cilat mund të përballet vazhdimisht një mysliman gjatë kryerjes së adhurimeve. Duke mos hyrë deri në detajet e çështjeve që përmbajnë librat e ilmihalit, në këtë libër janë përfshirë njohuritë më praktike të nevojshme për adhurimet e një besimtari. Çështjet e parashtruara janë analizuar në veçanti nën prizmin e urtësisë. Për arsye të shkaqeve që përmendëm më sipër, në libër nuk janë vënë *footnota*, ndërkohë referimet e ajeteve janë treguar brenda tekstit.

Përveç kësaj, në fund të çdo pjese u është dhënë përgjigje disa pyetjeve që mund të na vijnë në mendje menjëherë në lidhje me temën.

Padyshim që lexuesit janë ata të cilët do të japin vlerësimin më të saktë rreth librit. Lusim Allahun e Madhëruar që ky punim modest të jetë i dobishëm për lexuesin...

Osman Bilgen

HYRJE

NJERIU

Njeriu i parë në sipërfaqen e tokës është Ademi (a.s.). Allahu i Madhëruar e ka krijuar Ademin nga dheu e, pasi ka përfunduar krijimin e tij, i ka fryrë dhe i ka dhënë shpirtin.

Allahu (xh.sh) pas Ademit krijoi Havanë dhe të gjithë njerëzit që erdhën më pas lindën nga fëmijët e Ademit dhe të Havasë. Njeriu i parë është njëkohësisht dhe përfaqësuesi, profeti dhe robi i Allahut të Madhëruar në tokë.

Ata që e shohin njeriun dhe natyrën me syrin materialist kanë pohuar teorinë e ardhjes së njeriut nga majmuni. Teoria e njohur si teoria e evolucionit është formuluar për herë të parë nga biologu anglez Çarls Darvin (1809-1882) dhe është quajtur ndryshe teoria e Darvinit. Qëllimi i teorisë së Darvinit është të justifikojë ardhjen e njeriut me anë të një gjallese dhe të këpusë lidhjen e tij me fetë hyjnore dhe Krijuesin e Lartësuar. Por rregulli dhe harmonia që ekzistojnë në gjithësi e përgënjeshtrojnë atë. Tashmë askush nuk i beson më idesë së krijimit rastësisht të gjithësisë dhe forcës së verbër të natyrës.

Njeriu i parë, Ademi (a.s), është dërguar si rob dhe profet i Allahut duke u pajisur me një sërë njohurish

në lidhje me botën. Edhe brezat pas Ademit (a.s) nuk janë lënë vetëm. Janë mbështetur nga profetët e tjerë të cilëve u janë dhënë njohuri të reja. Nga ana tjetër njeriu ka zgjeruar njohuritë e tij me anë të eksperimentit dhe eksperiencës, duke bërë kërkime rreth botës dhe asaj që e rrethonte. Si rezultat i kësaj, njeriu pa ndryshuar tipin ka krijuar shoqëri të reja dhe mbi njëzet civilizime në historinë e njerëzimit.

PSE ËSHTË KRIJUAR NJERIU?

Allahu i Madhëruar, i cili ka krijuar tokën dhe qiejt, nuk i ka krijuar kot gjallesat apo sendet jo të gjalla. Në gjithësi çdo krijesë zë një vend të rëndësishëm. Ligjet e rregullit, harmonisë dhe përsosmërisë të cilat shihen tek bimët, kafshët, gjallesat e jogjallesat dhe që mahnisin mendjen duke iu vënë në shërbim të njeriut, janë disa nga argumentet e urtësisë së krijimit të njeriut.

Por në të vërtetë argumentin më të madh të krijimit të njeriut nga asgjëja, lajmërimin e ekzistencës së Tij, caktimin e Tij si përfaqësues në tokë duke e nderuar si rob të Tij, Allahu i Madhëruar e shpreh në ajetin 56 të sures Dharijat me fjalët: *"Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë."*

Njeriu është dërguar në tokë për t'u provuar brenda një kohe të caktuar. Rruga e marrjes së provimit është veprimi brenda rrethit të lejuar duke iu bindur urdhrave dhe ndalesave të Allahut.

FEJA

Feja është tërësia e ligjeve hyjnore që e drejtojnë njeriun drejt të mirës me dëshirën dhe vullnetin e tij. Këto ligje hyjnore janë transmetuar dhe dorëzuar tek njerëzit nga

njerëz të mrekullueshëm të dërguar si profetë nga ana e Allahut.

Fetë ndahen në dy grupe, ato që mbështeten në burime hyjnore dhe ato që nuk mbështeten në burime hyjnore.

Fetë e mbështetura në burimet hyjnore janë bazuar gjithnjë mbi të njëjtat baza dhe kanë pohuar të njëjtat të vërteta. Nga ana e disiplinave themelore dhe në bazë të kushteve dhe rrethanave të kohës, çdo profet i dërguar nga Allahu ka qenë një vazhdim i profetit të mëparshëm, e ka plotësuar atë, ka përsëritur mesazhin e profetëve të mëparshëm, ka shpjeguar dhe analizuar çështje të pasqaruara dhe ka sjellë ndryshime, risi në çështje të tjera të nevojshme.

Allahu i Madhëruar i ka udhëzuar profetët në mënyrë të detajuar duke u bazuar tek niveli i perceptimit dhe i diturisë së shoqërive, natyra e kërkesave, nevojave dhe tipit të problemeve, dhe për këtë ka vendosur ligje specifike.

Ja pra, bazuar në këtë disipline themelore, në mesazhet e të gjithë të dërguarve duke filluar nga profeti i parë e deri tek profeti Muhamed (s.a.s.), kemi vënë re ndryshime në lidhje me çështjet dytësore. Por asnjë nga këto ndryshime nuk kanë ndikuar në shpirtin e vërtetë të mesazhit dhe nuk kanë cenuar kornizën e detajeve.

Transmetohet se Profeti ynë (s.a.s) në një hadith ka thënë: "*Profetët janë të gjithë vëllezër. Feja e tyre është një.*" (Buhari, Enbija, 48: Muslim, Fedail, 143). Besimin tek mesazhi që kanë transmetuar profetët, Islami e ka pranuar si një nga kushtet e besimit. Në pjesët e tjera do të qëndrojmë më shumë mbi këtë temë.

Të gjithë profetët përveç transmetimit të fesë së vërtetë e kanë pasqyruar atë para të gjithëve duke e jetuar ashtu siç duhet. Fesë së Musait (a.s) më vonë i është dhënë emri

"hebraizëm". Edhe feja e transmetuar nga Isai (a.s) është quajtur më vonë "krishterim". As Musai e as Isai (a.s) nuk i kanë përdorur këto emra.

Për shkak të mbrojtjes së formës origjinale dhe duke pasur një burim hyjnor, Islami është feja e fundit e vërtetë. Feja e krishterë dhe hebraizmi bazohen në burime hyjnore, por me kalimin e kohës nuk kanë mundur dot të ruajnë origjinalitetin e tyre. Megjithatë, nuk janë të pakta pikat ku Kurani bashkohet me librat përkatës të këtyre feve.

Hebrenjtë dhe të krishterët ndryshe quhen '*ehli kitap*'. Disa dijetarë kanë futur në këtë grup edhe mexhusitë për arsye se dyshojnë në ekzistencën e librit.

Fetë që nuk mbështeten në burime hyjnore quhen fe të rreme (false). Përveç kësaj ka edhe organizata të paraqitura si fe, të tilla si joga, të cilat nuk janë të mbështetura as tek një profet e as tek ndonjë shpallje hyjnore.

Pasi folëm shkurtimisht rreth feve, tani do të kalojmë tek feja Islame.

FEJA ISLAME

Islam do të thotë t'i dorëzohesh Allahut, t'i bindesh urdhrave të Tij, të ecësh i palëkundur në një rrugë të sigurt dhe të besueshme, të dhurosh butësi dhe besim, të mos shqetësosh askënd me gojë apo me dorë.

Islami është emri i fesë hyjnore, bazat e së cilës mbështeten në mesazhet e Allahut e që janë transmetuar dhe jetuar nga ana e Profetit tonë (s.a.s).

Feja Islame përbëhet nga bazat e besimit (itikad), adhurimet (amel) dhe nga vendimet që kanë lidhje me moralin (ahlak). Ja, feja e vërtetë, Islami, është feja hyjnore që ka përcaktuar të gjitha vendimet në lidhje me jetën

e njeriut. Gënjehen ata të cilët e shohin fenë si tërësi vendimesh të lidhura vetëm me besimin.

Baza e Islamit është besimi i palëkundur tek Allahu i Madhëruar dhe tek e vërteta hyjnore. Ndërsa kulmi i tij është të zbatosh përgjegjësitë e tua me ndjesinë sikur e sheh Atë dhe Ai të sheh ty (ihsan), si dhe të jetosh vetëm me qëllimin për të arritur kënaqësinë e Tij (ihlas).

Të jesh fetar do të thotë ta mbash gjallë fenë brenda teje dhe ta jetosh atë duke e transmetuar tek të tjerët. Mysliman do të thotë ai i cili i dorëzohet mesazhit të Islamit, i bindet, ai i cili pasqyron dhe rrezaton paqe dhe qetësi. Emrin mysliman e ka vënë vetë Allahu i Madhëruar në Kuranin Famëlartë: "***Ai ju ka quajtur juve myslimanë qysh me parë (në shkrimet e shenjta) dhe në këtë Kuran..***" (Haxh, 78).

Prandaj nuk është e drejtë që një myslimani t'i drejtohesh me emrin 'islamik'.

Mu'min do të thotë njeri i sigurt, i besueshëm dhe ai i cili vërteton besimin tek Allahu. Në kuptim më specifik, do të thotë ai i cili beson fenë e sjellë nga Profeti Muhamed (s.a.s). Duke krijuar një nuancë mes tyre, fjalët mu'min dhe muslim përdoren dhe në vend të njëra-tjetrës.

Besimtar quhet ai person i cili beson, transmeton dhe jeton fenë Islame dhe të gjitha degët e lidhura me moralin dhe veprat.

Vepra e kryer pa besuar është *nifak* (dyfytyrësi, hipokrizi) dhe besimi i pashoqëruar me vepra është *fisk* (mëkat i hapur). Nifaku (hipokrizia) duke qenë në vetvete një *kufër* (mosbesim) i fshehtë nuk ka mundësi të falet, *fisk* ose *fuxhur* (kryerja e një mëkati) mund të falet gjithnjë me anë të pendimit duke iu drejtuar Allahut (xh.sh) i pastër dhe i penduar sinqerisht. Prandaj çdo njeri i cili nuk ka kryer vepra dhe nuk e ka nënvlerësuar besimin, duhet

të mendojë pozitivisht dhe të kontrollojë mosbesimin (kufrin). Përkundrazi, për një njeri i cili përveç se nuk ka bërë vepra të mira, ka ofenduar myslimanët sigurisht që nuk mund të mendojmë të njëjtën gjë.

Allahu i Madhëruar me anë të Profetit tonë (s.a.s) i ka dhuruar njerëzimit hartën në të cilën tregohet rruga që të shpie në begatinë, qetësinë dhe harmoninë e përhershme si në këtë botë ashtu dhe në tjetrën. Islami është emri i kësaj dhuratë të pashoqe dhe i këtij privilegji. Për ata që mendojnë drejt dhe me mendje të shëndoshë, ashtu si nuk është gjendur asnjëherë ndonjë boshllëk apo mos përgjigje ndaj kërkesave dhe pyetjeve të njerëzve në këtë fe, ashtu nuk bëhet fjalë as për ndonjë mospërputhje përsa i përket interpretimit të ligjeve hyjnore. Krahas këtyre, feja islame bashkë me premtimin e shikimit të Allahut (xh. sh), pëlqimit të Tij dhe lumturisë hyjnore, është një sistem hyjnor i veçantë planifikuar në bazë të aftësive, veprave dhe natyrës sonë të vërtetë.

Feja Islame është feja e fundit hyjnore dhe e vetmja që ka ruajtur identitetin e vërtetë. Profeti Muhamed (s.a.s) është hallka e fundit e profetësisë që transmeton dhe përfaqëson Islamin. Profeti ynë (s.a.s) ka thënë fjalën e fundit në emër të fesë. Profetësia e tij nuk është vetëm për një shoqëri apo popull, por i përket të gjithë njerëzimit. Profetët e mëparshëm janë drejtuar vetëm popullit të tyre me fjalët: "O populli im, o populli im!"Ndërsa Profeti ynë (s.a.s) në shumë vende në Kuran i është drejtuar gjithë njerëzve me fjalët: "O njerëz!".

Ka shumë ajete dhe hadithe që pasqyrojnë universalitetin e mesazhit dhe profetësisë së Profetit tonë. P.sh., në këto ajete shihet qartë se Profeti ynë (s.a.s) është dërguar për të gjithë kohërat dhe vendet: ***"Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed) veçse mëshirë për botët."*** (Enbija, 107) ***"Thuaj o Muhamed: O njerëz, unë jam***

i dërguari i Allahut për të gjithë ju.“ (Araf, 158)

Profeti (s.a.s) këto veçori të përshkruara në Kuran i ka deklaruar dhe në hadithet e tij: “*Çdo profet është dërguar për popullin e tij. Ndërsa unë jam dërguar për mbarë njerëzimin...*” Vendimet e transmetuara të fesë Islame janë mëse të pasura dhe të hapura për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e shoqërive njerëzore dhe të gjithë popujve në çdo vend dhe kohë. Feja Islame pranon të gjithë profetët e dërguar më parë dhe gjithë librat e shenjtë të shpallur atyre. Kurani famëlartë është mesazhi më i përkryer dhe i fundit që i jep përgjigje gjithë kërkesave të njerëzve deri në ditën e fundit. Ai është i vetmi libër hyjnor i ruajtur me origjinalitetin dhe freskinë e zbritjes. Shpresojmë që ata të cilët e besojnë Kuranin dhe kanë parasysh universalitetin e veçorive të tij, të mund ta transmetojnë atë brenda dimensioneve universale.

Pas një hyrjeje të tillë, do të kalojmë në pjesën e bazave të besimit të fesë Islame.

PJESA E PARË

BAZAT E BESIMIT

BAZAT E BESIMIT



Besimi e bën njeriun njeri, ndoshta edhe mbret, ndaj detyra e vërtetë e njeriut është besimi dhe lutja...

Said Nursi



Besim (iman) është pranimi dhe miratimi i tërësisë së çështjeve të urdhëruara nga Allahu i Madhëruar dhe të transmetuara nga Profeti ynë (s.a.s). Pra, besimi konsiston në këtë miratim. Por, për një njeri që e konsideron veten mysliman, është kusht shqiptimi me gojë i fjalës së dëshmisë: "*Eshhedu en la ilahe il'lallah ue eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluh - Dëshmoj se nuk ka tjetër zot veç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij*", si dhe besimi e pranimi i saj me zemër.

Imani (besimi) ndahet në dy grupe: *Ixhmali* dhe *Tafsili*.

1. ***Iman Ixhmali***: është të besosh Allahun dhe Muhamedin (s.a.s) si të dërguarin dhe robin e Allahut (xh.sh). Quhet Iman Ixhmali ngaqë konsiderohet si një përmbledhje e gjërave që duhen besuar ose ndryshe besim kolektiv (grup).

Bazat e besimit janë pasqyruar si bashkë ashtu dhe në veçanti në fjalën e Njësisë dhe në atë të Dëshmisë. Një person i cili i shqipton ato me gojë dhe i beson me zemër futet në fenë Islame. Por një mysliman duhet të mos mjaftohet me kaq dhe të mësojë bazat e besimit deri në detaje dhe t'i besojë të gjithave veç e veç.

2. ***Iman Tafsili***: quhet besimi veç e veç i bazave të besimit. Çështjet në të cilat duhet besuar janë gjashtë: besimi në Allah, engjëjt, librat, profetët, ahiretin dhe kaderin.

Pas kësaj hyrjeje të shkurtër në lidhje me termin e besimit, le t'i analizojmë një nga një këto baza.

1. BESIMI NË ALLAH

Pemët çelin lule dhe japin fruta. Deti mban mbi të anijet, lopët prodhojnë qumështin, dielli ngroh tokën në të cilën jetojmë... Rreth nesh nuk ekziston asgjë e pavlefshme. Çdo krijesë që nga më e vogla e deri tek hëna apo dielli ka shumë detyra që i dimë dhe nuk i dimë. Ndërsa njeriu është qenia më e përkryer. Mendon, flet, prodhon, hidhërohet, gëzohet... Po pse vallë u krijua një krijesë kaq e përkryer si njeriu? Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e tij?

Krijuesi e di më mirë shkakun dhe qëllimin e krijimit të njeriut. Krijuesi është Zoti i Madhëruar, Allahu (xh.sh). Prandaj ne qëllimin e ardhjes sonë në tokë e mësojmë nga Kurani.

Në Kuranin Famëlartë Allahu thotë: ***"Xhindët dhe njerëzit i krijova vetëm të më njohin e të më adhurojnë"*** (Dharijat, 56)

Mirë, po si do ta njohim Atë? Si të marrim informacion dhe njohuri rreth Tij?

Allahu na ka dhënë mundësi njohjeje që vijnë nga rrugë të ndryshme. Këto janë Kurani, Profeti Muhamed (s.a.s) dhe gjithësia. Në Kuran Allahu (xh.sh) na jep njohuri rreth cilësive të Tij. P.sh., në suren Ihlas mësojmë se Ai është një, se nuk ka nevojë për askënd, se çdo gjë ia ka nevojën Atij dhe se asgjë nuk është e njëjtë me Të.

Të lexosh Kuran në këtë mënyrë për të njohur Allahun është një adhurim më vete. Edhe krenaria e gjithësisë, robi dhe i Dërguari i Allahut, Profeti ynë (s.a.s) na jep njohuri rreth Allahut me anë të fjalëve dhe sjelljeve të tij.

Një tjetër rrugë që na prezanton Krijuesin është edhe gjithësia. Gjithësia është porsi një libër që na tregon për Allahun. Të gjitha krijesat, të gjalla apo jo të gjalla, që jetojnë në qiell apo në tokë, janë aq të përsosura saqë na bën të mendojmë se Krijuesi është i patëmeta. Ky krijues është Allahu.

Këtu na vjen në mendje një pyetje: A mund të krijohen rastësisht gjithçka shohim? Sepse ne nuk mund ta shohim atë që i hap lulet, lind diellin dhe sjell shiun.

GJITHËSIA U KRIJUA RASTËSISHT?

Mos vallë gjithçka gjë që ne shohim është krijuar rastësisht? Le të mendojmë... nëse mbi një fletë të bardhë shohim një shkronjë, atëherë themi se atë e ka shkruar dikush. Le të themi se lapsi na ra nga duart dhe u shkrua një shkronjë. Mirë, po shkronjat që vijnë më pas, a do të shkruhen në këtë mënyrë? Pastaj si formuan fjalë këto shkronja, fjalët si formuan fjali dhe fjalitë si e formuan librin? Fjalët fjalitë, fjalitë librin. Apo mos ndoshta shkronjat mendojnë dhe e dinë që më parë temën e librit dhe rreshtohen sipas saj? A është e mundur kjo gjë? Mund të jepen dhe shembuj të tjerë. Xhamia Selimije është ndërtuar me gurë. Mos vallë këta gurë kanë mendje që janë rreshtuar aq bukur dhe kanë bërë një nga xhamitë më të bukura? Asnjë prej këtyre që thamë nuk është e mundur, nëse ka një libër duhet të ketë dhe një shkrimtar. Nëse ka një xhami të bukur, padyshim që duhet të ketë një inxhinier që e ka bërë të tillë. Nëse një libër tregon shkrimtarin, një xhami tregon ndërtuesin, një pikturë piktorin, edhe gjithësia me mrekullitë në të tregojnë

Krijuesin, një fuqi të pashoq. Ja, pra, sunduesi i kësaj fuqie është Allahu.

Ky krijues në të njëjtën kohë duhet të jetë një. Pse? Sepse shohim që mes krijesave ka një ndihmë reciproke të përsosur. Vitamina D i bën mirë kockave të njeriut nëse rri nën rrezet e diellit. Të gjithë shijet e frutave u përshtaten shijeve tona. Ku e di dielli nevojën e kockave tona? Po pema e mollës ku i di shijet tona që prodhon mollë që na shijojnë? Kjo do të thotë që është një krijues i cili ka krijuar diellin, pemën dhe njeriun. Pastaj, nëse krijesat do kishin një krijues tjetër, a do mund të ekzistonte një përputhshmëri e tillë?

Thamë që leximi i Kuranit konsiderohet një adhurim; nëse gjithësia është një libër, atëherë a nuk konsiderohet adhurim dhe leximi i saj?

Sigurisht që po! Të mendosh rreth krijesave dhe ngjarjeve, të shohësh në to cilësitë dhe emrat e Allahut e t'i lexosh ato është një adhurim. Kjo quhet meditim (tefekur). Allahu i Madhëruar në shumë ajete kërkon nga ne të mendohemi. Edhe Profeti ynë në një hadith të tij i jep rëndësi të njëjtës çështje: *"Një orë meditim është më e vlefshme se adhurimi nafile i bërë gjatë një viti."*

Detyra e parë e njeriut duhet të jetë njohja e krijuesit, e Atij i cili i ka dhënë jetën dhe mirësitë, t'i besojë dhe ta dojë. Për ta besuar drejt Allahun dhe për të njohur qenien e Tij të madhëruar, duhet të mësojmë atributet e Tij.

ATRIBUTET E ALLAHUT

Atributet e Allahut ndahen në dy grupe: individuale dhe qenësore.

A. Atributet individuale (dhati)

Janë cilësi të cilat i përkasin vetëm qenies së Tij e që

nuk i ka asnjë qenie tjetër. Janë gjashtë:

1. ***Vuxhud*** *(ekzistencë)*: Allahu ekziston dhe është i gjallë. Nuk mund të mendohet inekzistenca e Tij.

2. ***Kidem*** *(paraqenie)*: Ai nuk është krijuar më vonë. Ai ekzistonte para çdo gjëje. Është i pafillim.

3. ***Beka*** *(pasqenie)*: Nuk ka fund, Ai nuk mund të zhduket asnjëherë. Është i pambarim. Edhe pasi gjithçka të zhduket, Allahu do të ekzistojë.

4. ***Muhalefetun lil hauadith*** *(kundërqënie ndaj krijesave)*: Nuk i ngjason asnjë prej krijesave.

5. ***Kijam bi nefsihi*** *(ekziston në vetvete)*: Ekzistenca e Tij nuk varet nga kushte të tjera.

6. ***Vahdanijet*** *(njësi)*: Ai është një, nuk ka të ngjashëm me Të. Çdo gjë përveç Allahut janë krijesa të Tij.

B. **Atributet qenësore (thubuti)**

Këto atribute ndodhen në mënyrë të kufizuar edhe tek krijesat. Megjithatë këto cilësi nuk mund të ngjasojnë me ato të Allahut sepse atributet e Allahut janë të pakufizuara. Ato janë tetë:

1. ***Hajat*** *(jetë)*: Allahu është i gjallë.
2. ***Ilm*** *(dituri)*: Ai di gjithçka.
3. ***Irade*** *(vullnet)*: Ai bën ç'të dëshirojë.
4. ***Kudret*** *(fuqi)*: Ai është i plotfuqishëm.
5. ***Semi'*** *(dëgjim)*: Ai dëgjon gjithçka.
6. ***Basar*** *(shikim)*: Ai sheh gjithçka.
7. ***Kelam*** *(fjalë)*: Ai flet, por nuk ka nevojë për fjalë dhe zë.
8. ***Tekuin*** *(krijim)*: Ai krijon dhe i jep formë diçkaje nga hiçi.

NJERIU QË BESON ALLAHUN

• E do Allahun, e di që edhe Allahu e do atë.

• Me mendimin se Allahu sheh dhe dëgjon çdo gjë, sillet me ndershmëri dhe tregohet i sinqertë si me të tjerët, ashtu dhe kur është vetëm.

• E di që Allahu është i drejtë dhe i do të drejtën, nuk i bën padrejtësi askujt dhe nuk e ul kokën para padrejtësisë.

• Sillet me dashuri dhe mëshiron gjithë krijesat për arsye se e di që çdo gjë në botë është krijuar nga Allahu (xh.sh).

• E di që Allahu (xh.sh) e dëgjon lutjen e tij, prandaj gjithnjë i drejtohet dhe i beson Atij. Në këtë mënyrë merr forcë për të përballuar çdo vështirësi.

• E di qëllimin e krijimit, nga ka ardhur dhe ku do të shkojë dhe ndihet i sigurt në vetvete.

1. BESIMI NË ENGJËJT

Edhe engjëjt (melekët) janë krijesa të Allahut. Me aq sa kemi mësuar nga Kurani dhe hadithet e Profetit, engjëjt nuk hanë, nuk pinë, nuk kanë gjini, i binden urdhrave të Allahut dhe kryejnë detyrën e tyre me përpikëri.

Numrin e engjëjve e di vetëm Allahu. Ka katër engjëj të mëdhenj të cilët janë:

1. ***Xhebraili*** (a.s): transmeton shpalljen hyjnore dhe urdhrat e Allahut tek profetët (engjëlli i shpalljes).
2. ***Mikalili*** (a.s): organizon dukuritë natyrore.
3. ***Israfili*** (a.s): është i ngarkuar me detyrën e fryrjes së surit në ditën e kiametit dhe me ringjalljen e njerëzve.
4. ***Azraili*** (a.s): është i ngarkuar me marrjen e shpirtit

nga njerëzit në kohën kur u afrohet vdekja.

Përveç tyre janë dhe ***Kiramen Katibin***, engjëjt që ndodhen në të djathtë dhe në të majtë të njeriut për të shkruar të mirat dhe mëkatet; engjëjt ***Munker*** dhe ***Nekir***, të cilët do t'i bëjnë pyetjet e para njeriut në varr.

Përveç engjëjve ka dhe disa krijesa të tjera jolëndore të cilat nuk mund të shihen me sy.

KRIJESAT E TJERA JOLËNDORE

Ashtu si engjëjt ka dhe dy krijesa të tjera, xhindët dhe shejtanët, të cilët nuk mund të shihen me anë të shqisave të njeriut dhe për të cilat flitet si në Kuran ashtu dhe në hadith. Prandaj të mohosh ekzistencën e tyre do të thotë të mohosh ajetet dhe hadithet e sakta e të qarta.

XHINDI

Xhindët janë krijesa përtej materiales dhe fizikes. Ata janë krijesa delikate të krijuara nga zjarri inkandeshent pa tym dhe mund të marrin forma të ndryshme, mund të kryejnë veprime të çuditshme (por që njerëzit i konsiderojnë të jashtëzakonshme). Ashtu si te njerëzit, ka prej tyre që janë besimtarë dhe jobesimtarë.

Përsa i përket përgjegjësisë, xhindët i ngjasojnë njerëzve. Ashtu si ne, ato janë krijuar për të adhuruar. Ato janë krijesa me vullnet të plotë. Edhe atyre u janë zbritur mesazhe hyjnore që përfshijnë urdhra dhe ndalesa prandaj dhe ato quhen përgjegjës për shpalljet.

Xhindët nuk e dinë të fshehtën, gajbin.

Duhet të theksojmë një specifikë shumë të rëndësishme në lidhje me xhindët: ata nuk janë krijesa që mund të shihen nga ne. Prandaj ne nuk mund t'i shohim në gjendjen e

tyre të vërtetë. Ajo që shohim ne është një përngjasim (ato marrin një formë të cilën ne mund ta shohim) i formës së vërtetë. Xhindët ashtu siç mund të marrin formën e njerëzve, kanë fuqi t'i përngjasojnë dhe krijesave të tjera. Në fakt, Profeti (a.s) në hadithe të ndryshme na këshillon që nëse na hyn një gjarpër në shtëpi t'i drejtohemi me fjalët: *"Dil jashtë nëse je xhind!"*, e nëse nuk del, atëherë na urdhëron ta mbysim. Këto hadithe shpjegojnë edhe njëherë cilësitë e xhindëve. Si përfundim, mund të themi që nëse xhindët do të kishin trup, atëherë do ishin si ne.

SHEJTANI

Shejtanët janë krijesa të tërbuara dhe mendjemëdhenj, të krijuar nga zjarri dhe që vazhdimisht përpiqen me anë të dyshimeve t'i shmangin njerëzit nga e drejta.

Në Kuran flitet për shejtanin e parë të quajtur Iblis. Kohë më parë i njohur si i pari dhe më i madhi ndër engjëj, Iblisi, i mbushur me urrejtje kthehet në mohuesin më të madh të Allahut. Me një teori të palogjikshme kur Allahu i Madhëruar e pyeti: "***Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe kur të urdhërova?"***, shejtani i përgjigjet ***"Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri kurse atë e krijove nga balta."*** (Araf, 12). Megjithëse krijimi i shejtanit ishte jashtë vullnetit të tij, kundërvënia dhe mohimi ishte realizuar me vullnetin e tij të plotë.

Kjo krijesë e mallkuar pa asnjë vlerë individuale, pa dyshim që është krijuar nëpërmjet shumë të fshehtave përsa i përket aspekteve të tij si individ. Një nga këto të fshehta, ndoshta edhe e para është roli që luan në lartësimin dhe uljen e xhindëve dhe njerëzve.

Krijuesi i Lartësuar e ka bërë shejtanin një mjet në botën e shkaqeve për lartësimin dhe avancimin shpirtëror, për kthimin e tij në një njeri të matur dhe të pjekur. Zbulimi

i shumë ndjenjave të natyrës njerëzore lidhen me luftën e bërë ndaj shejtanit. E vërteta është që aty ku nuk ka përpjekje nuk ka as zhvillim, as përparim. Për engjëjt të cilët nuk mashtrohen nga shejtani nuk bëhet fjalë për një lartësim shpirtëror.

Ashtu siç bëhet shkak një llastik për fluturimin sa më lart të një trumcaku ashtu dhe shejtani, pa dashur, bëhet shkak për lartësimin shpirtëror të njerëzve.

Për ata njerëz që një pjesë të aftësive të tyre në këtë botë provimi i kanë harxhuar në luftën me shejtanin do të ketë një shpërblim të merituar në Xhenet ndërsa për ata të cilët aftësitë e dhuruara nga Allahu i kanë harxhuar për të përmbushur dëshirat e shejtanit, do të ketë një dënim të merituar në Xhehenem.

Xhindët e tjerë mohues që përpiqen ta devijojnë njeriun nga rruga e drejtë si Iblisi quhen shejtanë. Madje Kurani fisnik i ndan në dy pjesë shejtanët (njerëz dhe xhind) përsa i përket mashtrimit të njerëzve apo frymëzimit të ndonjë mendimi të rremë që përmban mohim. Ndërkohë që shejtanët njerëz përpiqen haptazi t'i largojnë njerëzit nga Allahu dhe nga vlerat dhe çështjet e urdhëruara nga Ai, shejtanët xhind i frymëzojnë ato me dyshime nga një kënd të cilin nuk mund ta shohim.

Njeriu i cili lufton dhe përballet me shejtanin pranohet tek Allahu si i suksesshëm. Por realizimi i këtij suksesi është i lidhur me forcimin e vullnetit dhe mbështetjen tek Allahu, Ai i cili sheh dhe kontrollon çdo gjë.

NJERIU QË BESON NË ENGJËJT

• Nuk ndihet asnjëherë i vetmuar, e ndjen se Allahu e mbron atë me anë të engjëjve mbrojtës.

• Di se engjëjt Kiramen Katibin shkruajnë veprat e

mira dhe ato të këqija, ndaj tregohet më i kujdesshëm në veprimet e tij.

• Beson që engjëjt luten për të, ndaj dhe ai lutet për veten dhe për të gjithë myslimanët.

2. BESIMI NË LIBRAT

Allahu i Madhëruar nëpërmjet engjëllit Xhebrail u ka zbritur një pjesë të profetëve libra dhe fletë që përmbajnë urdhra, ndalesa dhe të fshehta përkatëse.

SHPALLJA

Vahj (shpallje) quhen njohuritë e prera të transmetuara tek profetët në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e Allahut ose nëpërmjet një ndërmjetësi.

Allahu i Madhëruar ia transmeton njohuritë e dëshiruara njerëzve të veçantë të zgjedhur mes robërve nëpërmjet një rruge të veçantë. Allahu ua ka transmetuar dëshirën e Tij profetëve në rrugë të ndryshme shpalljeje (vahj).

LLOJET E SHPALLJES

1. Ëndërr e besueshme: Allahu i transmeton njohuritë e dëshiruara tek profetët nëpërmjet një ëndrre të vërtetë. Edhe Profetit tonë (s.a.s) kështu i ka ardhur shpallja e parë. Të gjitha ato që kishte parë në ëndërr ishin realizuar njësoj në të vërtetë.

2. Shpallja me anë të frymëzimit: Allahu i transmeton shpalljen direkt profetëve duke ia vendosur në zemrën e tyre pa asnjë ndërmjetës.

3. Fjala pas perdes: është dëgjimi i fjalës së Allahut pa pasur asnjë ndërmjetës dhe pa e parë Atë.

4. Shpallja nëpërmjet engjëllit: Është transmetimi i fjalës së Allahut të Madhëruar te profetët nëpërmjet engjëllit.

Engjëlli i cili transmeton fjalët e Allahut tek profetët ndonjëherë është paraqitur në formën e tij, e ndonjëherë në formën e një njeriu. Njerëzit që kanë qenë të pranishëm aty e kanë parë dhe dëgjuar fjalët e tij. Ndonjëherë engjëlli ka transmetuar shpalljen tek profetët pa u dukur vetë.

Kurani fisnik i është dërguar Profetit tonë (s.a.s) nëpërmjet formës së katërt, pra nëpërmjet engjëllit.

Një pjesë e librave të shpallur profetëve nga ana e Allahut janë libra të vegjël të përbërë nga disa fletë. Këta fletë janë quajtur *'sahife'* ose në shumës *'suhuf'*.

FLETËT (SUHUF)

Ademit (a.s) 10 fletë

Shitit (a.s) 50 fletë

Idrizit (a.s) 30 fletë

Ibrahimit (a.s) i janë dërguar 10 fletë.

LIBRAT

"Teurati" i është dërguar Musait (a.s).

"Zeburi" i është dërguar Davudit (a.s).

"Ungjilli" i është dërguar Isait (a.s).

"Kurani" i është dërguar Profetit tonë, Muhamedit (s.a.s).

Libri ynë është libri i fundit dhe Profeti ynë është

profeti i fundit. Kurani fisnik është i vetmi libër që ka ruajtur formën origjinale të zbritjes. Nuk do të ndryshohet asnjëherë deri në fund as dhe një shkronjë apo një fjalë e tij. Sepse Allahu (xh.sh) na ka siguruar për këtë në Kuran: ***"Vërtet ne e kemi shpallur Kuranin dhe Ne do ta ruajmë atë me siguri".*** (Hixhr, 9)

NJERIU QË BESON LIBRAT

• Beson se Allahu nuk i ka lënë njerëzit pa një udhërrëfyes dhe se do t'ua tregojë rrugën, duke forcuar kështu besimin tek Allahu.

• Përpiqet të kuptojë dhe ta praktikojë mesazhin e Allahut.

• Lexon librin e Allahut dhe freskon shpirtin me të, beson në gjetjen e qetësisë dhe të shërimit.

Gjatë leximit të Kuranit mendon për miliona myslimanë nëpër botë të cilët lexojnë të njëjtin libër dhe kështu lind dhe zhvillohet ndjenja e vëllazërisë.

4. BESIMI NË PROFETËT

Profetët janë njerëz të zgjedhur nga Allahu. Janë ndërmjetës, të dërguar mes njerëzve dhe Allahut. Çfarë dëshiron nga ne Krijuesi i Lartësuar i cili na ka sjellë në këtë botë si mysafir për një kohë të caktuar? Ku do të shkojmë pasi të na mbarojë koha? Për të gjitha këto Allahu na ka dërguar mesazhe nëpërmjet profetëve.

Profetët janë njerëz fjalëdrejtë. Njohuritë, urdhrat e marra nga Allahu ua transmetojnë njerëzve në mënyrën më perfekte.

Nga ana individuale edhe ata janë njerëz si ne. Hanë, pinë, gëzohen, hidhërohen... Njëherazi ata janë krijuar

me një natyrë të vyer dhe janë të pajisur me cilësi të rralla. Cilësitë kryesore të profetëve janë këto:

1. ***Ismet*** *(pafajësia)*: Allahu i ka mbrojtur ata nga çdo lloj mëkati, i vogël apo i madh qoftë. Nuk bëjnë mëkate, janë të pafajshëm.

2. ***Emanet*** *(besueshmëria)*: Ata janë njerëz të besueshëm dhe njihen si të tillë nga të gjithë.

3. ***Sidk*** *(drejtësia)*: Janë të drejtë, qëndrojnë aq larg nga gënjeshtra saqë nuk gënjejnë as për shaka. Madje edhe shakatë e tyre ishin për të dhënë mësim.

4. ***Fetanet*** *(zgjuarsia)*: Janë njerëz shumë të zgjuar dhe me botëkuptim të gjerë. Ata arrijnë në shkallën më të lartë të mençurisë dhe zgjuarsisë.

5. ***Teblig*** *(kumti)*: Shpalljen hyjnore të marrë nga Allahu ua transmetojnë njerëzve pa e ndryshuar.

Ata duhen të jenë të tillë sepse detyra që kanë kërkon të jenë njerëz jo të zakonshëm.

Islami është feja e fundit dhe e përkryera, ndërsa profeti Muhamed (a.s) është profeti i fundit. Ai ka bërë një jetë për t'u marrë shembull dhe e ka realizuar pa asnjë të metë detyrën e tij si i dërguar.

Ne si myslimanë e duam shumë profetin tonë. Përpiqemi të veprojmë si ai kur hamë, pimë, ulemi, ngrihemi, flasim. Sepse Ai na ka transmetuar një fe kaq të përsosur si Islami, na ka treguar rrugët e të mirës dhe të bukurës.

Nga ky aspekt, Profeti Muhamed (s.a.s) ka edhe pesë veçori të tjera të ndara nga profetët e tjerë:

1. Nga ana e virtytit është më i lartësuari nga të gjithë profetët.

2. Është dërguar për gjithë njerëzit dhe xhindët.

3. Është profeti i fundit. Pas tij nuk do të ketë më të profetë.

4. Është dërguar si mëshirë për botët.

5. Feja që ka sjellë do të vazhdojë deri në ditën e kiametit.

PROFETËT E PËRMENDUR NË KURAN

Sipas një transmetimi thuhet se nga Ademi (a.s) e deri te Muhamedi (s.a.s) janë dërguar 124 mijë profetë, sipas një transmetimi tjetër 224 mijë profetë. Nga këto në Kuran përmenden vetëm 28 prej tyre. Profetët që përmenden në Kuran janë këta:

Adem - Idris - Nuh - Hud - Salih - Ibrahim - Lut - Ismail - Is'hak - Jakub - Jusuf - Ejub - Shuajb - Musa- Harun - Davud - Sulejman - Junus - Iljas - Eljesa - Dhulkifl - Zekerija - Jahja - Isa - Uzejr - Lukman - Dhul Karnejn - Muhamed.

Zoti im, mëshira dhe paqja jote qofshin mbi profetin tonë Muhamedin dhe gjithë profetët e tjerë, të afërmit dhe shokët e tyre! Amin!

NJERIU QË BESON PROFETËT

• Merr shembull nga ata në çdo hap të jetës.

• Përpiqet të jetë i ndershëm dhe i drejtë duke pasqyruar drejtësinë dhe ndershmërinë e tyre.

• Mëson sjelljet dhe veprimet e profetëve dhe përpiqet t'i praktikojë në jetën e tij.

• Përpiqet të jetë i drejtë me të tjerët ashtu siç kanë qenë profetët.

5. **BESIMI NË AHIRET**

Ne besojmë në ringjalljen pas vdekjes. Një gjë e tillë nuk është aspak e vështirë për Krijuesin tonë i cili na ka krijuar një herë. Dhe tani, në këtë çast, a nuk realizohen ringjallje para syve tanë! A nuk gjelbërojnë në pranverë pemët të cilat dimrit zhvishen nga gjethet dhe mbeten të thata? Nëse edhe pemët ringjallen çdo pranverë, atëherë si mos të ringjallemi ne, krijesa më e përkryer e Allahut? Pastaj, ka njerëz që gjatë gjithë jetës së tyre bëjnë padrejtësi. I dëmtojnë dhe ofendojnë të tjerët. Dhe vërejmë që këtyre njerëzve nuk u ndodh asgjë. Kjo do të thotë që Allahu, Ai që nuk mbyll sytë ndaj padrejtësisë, e ka lënë shpërblimin për të mirat dhe dënimin për të këqijat në një vend tjetër.

Ky vend quhet ahiret dhe përmendet si në Kuran ashtu dhe në hadithet e Profetit (a.s). Një mysliman i mirë vepron duke menduar se do ballafaqohet me veprat e tij. Largohet nga të këqijat dhe bën vepra të mira.

NJERIU QË BESON AHIRETIN

• Beson në shpërblimin dhe dënimin e çdo vepre, e mirë apo e keqe qoftë ajo. Asgjë nuk mbetet pa u shpërblyer.

• Përpiqet të zbatojë gjithë urdhrat dhe ndalesat e Allahut që të fitojë xhenetin e premtuar.

• Kjo botë është si një arë, ndërsa bota tjetër si një korrje e të mbjellave, ndaj përpiqet ta vlerësojë këtë botë në mënyrën më të mirë.

• Beson se një ditë i dobëti do të marrë të drejtën e tij ndaj të fortit dhe nuk i bëhet padrejtësi askujt.

BESIMI NË KADER (CAKTIMIN E ALLAHUT)

Më parë përmendem se dy nga cilësitë individuale të Allahut ishin Paraqenie (kidem) dhe Pasqenie (beka). Pra, Allahu nuk është krijuar më vonë. Ai ekzistonte para çdo gjëje. Është i pafillim. Përveç kësaj, nuk ka as fund, as nuk do zhduket asnjëherë. Është i pafund.

Kader është njohja dhe përcaktimi nga ana e Allahut e të gjitha gjërave, të mira apo të këqija, veçorive të tyre, kohës dhe mënyrës së ndodhjes, që kanë ndodhur dhe do të ndodhin nga fillimi deri në fund.

Kada është realizimi i gjërave të cilat janë të shkruara në kader në kohën dhe vendin e duhur.

Ne si myslimanë besojmë në kadanë dhe kaderin (caktimin e Allahut). Gjërat që na ndodhin i përballojmë me durim dhe i pranojmë si një caktim i Allahut.

NJERIU QË BESON NË KADER

• Është në dijeni se Allahu di çdo gjë dhe beson se as edhe një gjethe nuk bie pa lejen e tij.

• Tregohet i kujdesshëm për të mos prishur ekuilibrin që ka vendosur Allahu në gjithësi.

• Allahu ka krijuar gjithçka brenda një rregulli dhe si një pjesë e këtij rregulli i beson Allahut kur lufton dhe përballet me vështirësi.

DISA ÇËSHTJE LIDHUR ME BAZAT E BESIMIT

Piktura është dëshmi e piktorit, arti dëshmi e artistit, gjithësia është dëshmi e Allahut (xh.sh). Ai ka krijuar çdo gjë. Ai është shkaku i çdo gjëje, po cili është shkaku i Tij?

Kësaj pyetjeje mund t'i japim përgjigje nga disa aspekte.

1. Logjikisht, zinxhiri i shkaqeve është e pamundur të shkojë deri në fund. Shkaqet ndalen në një pikë. P.sh., ai që tërheq vagonin e fundit të trenit është vagoni para tij, ai që tërheq atë është një para tij... Lokomotiva i tërheq të gjithë vagonët. Ajo vetë është në lëvizje. Tërheqja e vagonëve përfundon tek ajo.

2. Një qenie e krijuar nuk mund të jetë krijues. Ai që ekziston si pasojë e krijimit nga dikush tjetër, si mund të krijojë gjithçka nga asgjëja?

3. Fuqia e vërtetë nuk i ngjason fuqisë së fituar. P.sh., në krahasim me lapsin, tek njeriu ekziston një forcë, fuqi. Lapsi mund të transportohet nga një vend në tjetrin. Por një njeriu i cili ngrihet dhe shkon në një vend tjetër nuk mund t'i thuhet: "Kush të solli këtu? Është e pamundur të vish vetë." Ose pyetjes se "Ku është koka e njeriut?", i përgjigjemi se është mbi trupin e tij. Pyetjes se ku është trupi i përgjigjemi se është mbi këmbët e tij. Pyetjes se ku janë këmbët i përgjigjemi thjesht se janë mbi tokë. Po pyetja se ku është toka, ku mbështetet ajo, nuk mund të bëhet. Sepse toka nuk ka një domosdoshmëri të mbështetet diku. Ekzistenca e Zotit qëndron në qenien e tij. Ai ekziston në vetvete. Nuk mund të pyesim se kush e krijoi.

4. Ai i cili bën këtë pyetje pikë së pari e pranon Allahun si një krijues dhe pastaj pyet se kush e krijoi Atë. Kështu brenda një fjalie kemi dhe Krijuesin (Halik) dhe krijesën (mahluk). Këtu ka një kontradiktë të hapur.

Një kontradiktë tjetër në këtë pyetje është edhe përfytyrimi i krijuesit të përulur para ligjeve me të cilat janë të lidhura me vetë krijesat. Veprimi ynë brenda shkaqeve është një ligj me të cilin jemi të lidhur. Ne

jetojmë në një vend dhe në një kohë të caktuar. Në të kundërt, Allahu është krijuesi i kohës dhe i hapësirës. Është e domosdoshme të pranohet se Ai ndodhet mbi kohën dhe hapësirën.

A përkulet para ligjeve dhe shkaqeve Ai i cili i ka krijuar vetë ato? P.sh., nëse marrim si shembull një kukull e cila punon me bateri dhe që gjithçka e krahason me gjendjen e saj. A nuk gabon nëse thotë: "Unë shoh se çdo gjë rreth meje punon me bateri, atëherë edhe ai që më ka bërë mua është një njeri i cili punon me bateri".

Nga përgjigjet kuptohet se Allahu ka krijuar çdo gjë. Ekzistenca qëndron në qenien e Tij. Ai ekziston në vetvete. Të gjithë kanë nevojë për të, Ai nuk ka nevojë për askënd.

Pse nuk mund ta shohim Allahun?

Shikimi është i lidhur me kuptimin dhe arsyen. P.sh., në trupin e njeriut ka mikrobe, madje në një dhëmb të tij gjenden me miliona baktere. Këto baktere përpiqen vazhdimisht ta prishin e shkatërrojnë dhëmbin. Megjithatë njeriu nuk mund të dëgjojë as zhurmën e tyre dhe as nuk e di që ekzistojnë. Edhe ato nuk mund ta shohin njeriun dhe as ta mendojnë. Në fakt, për ta parë mirë njeriun, duhet të jenë jashtë tij dhe në të njëjtën kohë duhet të kenë sytë e një teleskopi. Domethënë mungesa e kuptimit i pengon shikimin. Ndërsa ato shohin vetëm atë që gjendet përballë tyre.

Kuptimi dhe konceptimi i botës makro

Një shembull të ngjashëm me botën mikro le ta japim në botën makro. P.sh., le ta zëmë se jemi ulur para një teleskopi të madh. Ky teleskop mund të tregojë katër miliard vjet përpara. Përsëri njohuritë tona janë si një

pikë uji në det. Ndoshta mbi atë që kemi parë mund të përfitojmë ca njohuri nga teori të turbullta. Me këto teori arrijmë në teori të reja dhe përpiqemi të përfitojmë njohuri të tjera.

Ne këtu nuk do të mund të kuptojmë dhe të shohim drejtimin e gjithësisë, formën e përgjithshme, përmbajtjen dhe brendinë e saj. Sepse ashtu siç ndodh në botën mikro, ne nuk jemi të aftë të kuptojmë tamam botën makro.

Jemi të kufizuar edhe në botën makro edhe në atë mikro

Shihet se me mikroskopin që mbajmë në duar jemi të kufizuar përballë mikrogjallesave, edhe në botën makro kemi të njëjtin kufizim. Tani le të mendojmë Allahun (xh.sh); Profeti ynë (s.a.s) thotë: *"Krahasuar me kursinë e Allahut, gjithësia është si një unazë e hedhur në shkretëtirë."*

"Krahasuar me arshin, edhe kursija e Tij është si një unazë e hedhur në shkretëtirë." Brenda kritereve të sasisë dhe cilësisë kur marrim në dorë raportin mes arshit dhe kursisë shohim diçka madhështore.

Ashtu siç është absurde ideja se një krijesë mikroskopike krahasuar me gjithësinë pohon se mund të kuptojë vendet e gjithësisë, aq absurde është dhe ideja se të gjitha vendet e gjithësisë (të cilat konsiderohen mikroskopike nga Ai) krahasuar me Arshin e Allahut të pohojnë se e kuptojnë atë. Nga kjo kuptojmë që Arshi është vendi i zbatimit të urdhrave të Allahut. Atëherë, si do ketë mundësi njeriu ta perceptojë dhe kuptojë Allahun?

Prandaj në Kuran thuhet: ***"Shikimet njerëzore nuk mund ta përfshijnë Atë, ndërkohë që Ai i përfshin shikimet e të gjithëve."*** (Enam, 103)

Po sytë nuk mund ta shohin dhe arrijnë Atë. Për ta

parë duhet të arrijmë ta kuptojmë. Ai përfshin dhe arrin të gjitha shikimet, por sytë nuk mund ta shohin Atë.

Drita është perdja e Allahut

Ndryshe mund të themi që drita është mbulesa e Allahut (xh.sh). Ne nuk mund të perceptojmë as dritën. Kur Profeti ynë (s.a.s) u kthye nga Miraxhi, njëri nga sahabet e pyeti: "A e pe Allahun ? Transmetohet nga Ebu Dheri se ai iu përgjigj: *"Ai është dritë, si ta shoh."* Në një transmetim tjetër: *"Unë pashë një dritë."* Megjithëse drita është një krijesë. Allahu (xh.sh) është Ai i cili i jep formë dhe trajtë dritës. Drita nuk është Allahu, ajo është krijuar nga Ai.

Si përfundim, mund të themi që Allahu (xh.sh) nuk mund të shihet. Drita është mbulesa e Tij.

Çdo gjë njihet me të kundërtën përkatëse

Pikë së pari, Allahu nuk ka të kundërt. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Duhet të ekzistojë e kundërta që ajo gjë të shihet. Ne shohim dritën sepse kemi të kundërtën e saj, errësirën.

Allahu (xh.sh) nuk ka as të kundërt e as të ngjashëm që të shihet ashtu siç errësira tregon dritën.

Le ta analizojmë çështjen nga ana fizike. Sa përqind sheh njeriu vallë tek gjithësia e shfaqur para tij? Po, a mund të jepni një lloj shifre rreth asaj që shihni? P.sh., le të mendojmë se para nesh janë hapur miliarda gjëra të gjithësisë miliarda herë dhe na thuhet: "urdhëroni, shikoni, nxirrni mësim. Duartrokisni Krijuesin!" Megjithatë, ne mund të shikojmë vetëm pesë gjëra në një milion, pjesën tjetër as që e njohim. Ne shohim vetëm ato gjëra që janë në gjatësi dhe valë drite të caktuara. Atëherë

bëni kujdes; njeriu i cili pyet "pse nuk e shoh Allahun?, kërkon ta përshijë Allahun i cili mban në dorë gjithësinë brenda asaj *pesë të milionat* (5/1.000.000) të gjithësisë së vockël që arrin të shohë.

Si do veprohet me njerëzit të cilëve nuk u ka zbritur i dërguar dhe Kurani? Çfarë faji kanë ato?

Allahu (xh.sh) nuk ka lënë asnjë njeri larg mëshirës, shpalljes dhe argumenteve të Tij. ***"Nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues."*** (Fatir, 24); ***"Ne u kemi çuar të dërguar popujve të tjerë.."*** (Nahl, 63)

Kurani fisnik na ka treguar historitë e gjithë profetëve: ***"Edhe para teje (o Muhamed) Ne kemi nisur të dërguar, për disa prej të cilëve të kemi treguar e për disa të tjerë nuk të kemi treguar."*** (Gafir, 78)

Allahu ka frymëzuar çdo gjë, edhe bletën madje: ***"Zoti yt e frymëzoi bletën (duke thënë): Ndërto shtëpi në male dhe në drurë dhe në atë (kosheret) që kanë ngritur njerëzit."*** (Nahl, 68)

Ndonjëherë, shpallja, frymëzimi është në trajtën e një libri të zbritur nga Xhebraili. Ndonjëherë, ajo është një dritë e hedhur nga Allahu në zemrën e robit. Ndonjëherë, ndjejmë një lehtësim dhe zgjerim në kraharor. Herë është një e fshehtë, herë një e vërtetë, ndonjëherë një dorëzim, një frikë dhe devotshmëri...

Nuk është parë të mos mëshirohet dhe përkëdhelet nga Allahu ai i cili ia ka hapur zemrën dhe e dëgjon fjalën e Tij.

Në fytyrën e një zezaku të vetmuar në shkretëtirë ka vetëm një shikim të frikësuar të ngritur lart nga qielli, një shikim i cili pranohet nga Allahu (xh.sh). Nëse kërkojmë, do të shohim se edhe atyre u janë zbritur profetë për t'u treguar të vërtetat.

P.sh., një fis në Afrikë besojnë në një zot i cili nuk ka lindur, nuk lind, dhe nuk ka të ngjashëm. Ai nuk shihet, por njihet me veprimet dhe shfaqjet e tij. Ai është krijues. I jep mirësi, dëgjon lutjen, vetëtima është hanxhari i tij ndërsa bubullima është ecja.

A nuk janë këta fjalë të ngjashme me fjalët e sures Ihlas? Nga i kanë marrë këto njohuri ndërkohë që nuk i ka zbritur asnjë profet apo shpallje? Pasi janë treguar të vërtetat e pastra, koha ka kaluar dhe ashtu siç ndodh përherë, besimet e kota janë përzier me të vërtetat dhe kanë prishur pastërtinë e kësaj feje.

"Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka..." (Bekare, 286)

Ashtu siç thuhet dhe në ajetin 15 të sures Isra, nuk do të mbajnë përgjegjësi ata të cilët nuk kanë pasur të dërguar. Përgjegjësia lidhet me mundësinë.

Cili është qëllimi i zbritjes së Kuranit brenda 23 vjetëve?

Nëse Kurani nuk do të kishte zbritur për 23 vjet dhe të zbriste menjëherë, atëherë do të pyesnin: "Pse Kurani zbriti menjëherë dhe nuk zbriti pjesë-pjesë?

E rëndësishme në çështje të tilla është t'i dorëzohemi caktimit të Allahut të Madhëruar. Përndryshe, pyetjet do të dalin për çdo çështje si p.sh.: "Pse namazi i drekës është dhjetë rekatë? Pse namazi i xhumasë falet ditën e premte, pse zekati është një në të dyzetat dhe nuk është një në dyzet e një?" e kështu me radhë. Prandaj është e rëndësishme të dimë që këto përmbajnë një të fshehtë përuljeje dhe dorëzimi. Po, të falurit pesë herë në ditë ka dobitë përkatëse për individin i cili del para Allahut për të kërkuar mëshirën dhe faljen e Tij. Por nëse ndalemi tek numri i rekatëve, vitri ka tre rekatë, farzi i akshamit tre,

ikindia katër. Këto numra janë përcaktuar nga Allahu (xh.sh). Nëse ne do të na thuhej se do të faleni pesë herë në ditë, por mënyrën e të falurit përcaktojeni vetë, ne do të jepnim mendime të ndryshme në lidhje me numrin e rekatëve. Dhe sigurisht që do të përcaktonim një program në bazë të punëve dhe kushteve të jetës sonë. Tjetër është çështja e rekateve dhe tjetër namazi. Prandaj ne këtu po analizojmë urtësitë e namazit dhe jo numrin e rekatëve.

Gjatë periudhës 23 vjeçare të zbritjes Kurani ka pasur urtësi të tilla. Krahas kësaj, Kurani ka zbritur në një periudhë ku njerëzit nuk pranonin urtësinë. Prandaj zbriti profeti i urtësisë dhe i maturisë. Po, zbriti ai për të cilin ishte krijuar gjithësia, Profeti Muhamed (s.a.s). Ajo që i takonte popullit të tij tashmë ishte të ndiqnin rrugën e përsosmërisë, të ngjisnin shkallët e urtësisë dhe të mësonin popujt e tjerë. Deri atë ditë zemrat e tyre kishin qenë të dobëta dhe të veshura me vese të këqija, dihej që heqja një nga një e tyre dhe zëvendësimi me cilësi të larta morale do të ishte mjaft e vështirë. Nëse Kurani me urdhrat dhe ndalesat e tij do zbriste menjëherë përballë tyre atëherë nuk do të mund ta përballonin. Në të vërtetë një rrugë e tillë do ishte kundër rrjedhës së përmirësimit të njerëzimit.

Nëse do të jepnim një shembull nga jeta jonë e përditshme, le të mendojmë për atë njerëz të cilët mund të jenë alkoolistë, të varur nga duhani, që qëndrojnë gjithë ditën në kafene. Nëse një personi të tillë do t'i drejtoheshim me fjalët "Vëlla, nëse shkon përsëri në pijetore do të vdesësh", atëherë ai do të nxjerrë me mijëra shkaqe për të shkuar përsëri. Nëse një ditë do të rrinte në shtëpi, atëherë do të nevrikosej dhe mërzitej shumë dhe sapo t'i jepej rasti do të shkonte përsëri në pijetore. Sepse ky do ishte një lloj ndryshimi në mënyrën e të jetuarit të tij. Në të vërtetë ai do të humbiste dhe të shpëtonte nga një ves i panevojshëm.

Tani le të analizojmë një konsumues duhani të cilit i drejtoheni me këto fjalë: "Lëre duhanin sepse të dëmton shëndetin. Duhani është si një lloj vetëvrasje e ngadaltë. Është si një sëpatë të cilën e mban në dorë, ajo nuk të vret menjëherë, por plotëson vrasjen tënde ngadalë-ngadalë." Nëse këtë do t'ia shpjegonit një doktori dhe nëse doktori do shprehej me këto fjalë: "Pirja e duhanit nuk të sjell asnjë dobi, por të dëmton këtë, këtë...", atëherë ky njeri përsëri do të jetë i pavendosur për lënien e tij.

Duke u bazuar tek shembujt e mësipërm, tani mendoni për heqjen e veseve të cilat u kanë hyrë në gjak këtyre njerëzve dhe pastaj për shkallët e zbritjes së Kuranit.

Po, në fillim ai heq gjembat dhe pastron gjërat e këqija. Ai heq nga shpirtrat e tyre veset e këqija dhe i zëvendëson me cilësi të larta morale dhe brenda një kohe të shkurtër kryen me mijëra punë. Ne na duket sikur 23 vjet kanë qenë shumë të shpejtë në zbritjen e Kuranit.

Ashtu siç thotë dhe Said Nursi: "Sikur filozofët e këtij shekulli të ktheheshin në periudhën e Muhamedit (s.a.s) e të punonin për njëqind vjet, a do të mund të realizonin një përqind të asaj që ai njeri e ka bërë për një vit? E pamundur! Çdo ditë shohim sesi me mijëra familja shkatërrohen nga alkooli. Organizata të ndryshme çdo vit mbajnë konferenca dhe organizojnë aktivitete. Përballë kësaj, sa njerëz e kanë lënë alkoolin? Ja, le të urdhërojnë profesorët e universiteteve, nëse do të punonin një vit për këtë, sa njerëz do të bindnin të hiqnin dorë nga alkooli?

23 vjet është një kohë e shkurtër, prandaj themi se Kurani është një mrekulli. Atë që ka arritur profeti për 23vjet, njeriu nuk mund ta arrijë për njëmijë vjet.

Nga njëra anë Kurani ka pasur qëllim zhdukjen e veseve të këqija dhe në vend të tyre zbukurimin e shpirtrave me moralin e lartë të tij dhe të gjitha këto i ka realizuar

pa i tronditur, frikësuar e ofenduar zemrat e njerëzve. Kurani ka ndikuar në ndryshimin dhe zgjidhjen e shumë çështjeve. Por edhe sa 23 vjeçarë të tjerë do të duhen për t'i sjellë këto çështje në jetën tonë të përditshme.

Këta 23 vjet ishin kohë e mjaftueshme për pranimin e urdhrave dhe ndalesave dhe kjo ishte e nevojshme për heqjen graduale të disa gjërave, për vendosjen e disa gjërave të tjera. P.sh., në tre-katër etapa është ndaluar pirja e alkoolit, për dy etapa u hoq zakoni i varrosjes për së gjalli të foshnjave. Ishte organizuar dhe sistemuar jeta e çrregullt e fiseve, duke u bashkuar fituan aftësinë e krijimit të një shoqërie në të cilën do të ishte e mundur zhdukja e veseve të këqija dhe zëvendësimi me vlera të larta morale. Për këtë arsye ka qenë e nevojshme një periudhë e caktuar kohore.

Nëse kjo gjë nuk do të realizohej për 23 vjet, por brenda një dite, atëherë ato fise nomade nuk do ta përballonin dhe do të vdisnin. Mund të japim një shembull të ngjashëm. P.sh., një njeri i cili qëndron për një kohë të gjatë në diell pëson dëmtime në lëkurë. Nëse të njëjtin njeri do ta çonim në vende të ftohta edhe këtu do të pësonte çrregullime të vogla. Nëse një njeri i cili qëndron nën një presion atmosferik ngrihet në një lartësi prej 20 mijë metrash, atëherë sigurisht që do të vdiste.

Ashtu siç mund ta vrasë njeriun ngritja e menjëhershme në një lartësi prej 20 mijë metrash, po ashtu, edhe nëse një shoqërie ku botëkuptimi për jetën, familjen dhe individin ishte zero do t'i thuhej: "Ja ku janë vendimet, binduni dhe praktikojini pa asnjë mangësi", atëherë asnjë anëtar i shoqërisë nuk do mund ta pranonte. Sepse kjo do të ishte një ngritje prej njëzet mijë metrash nga zeroja për të dhe një gjë të tillë nuk do të mund ta përballonte. Kështu që zbritja e vendimeve të Kuranit brenda një periudhe 23 vjeçare, mësimi i tyre në mënyrë graduale ishte një

kërkesë e natyrës njerëzore dhe ai është më i përshtatshmi për karakterin e njeriut.

Meqë njeriun nuk mund ta ndajmë nga gjithësia, atëherë ndihemi të detyruar ta analizojmë sipas rrjedhës së ngjarjeve brenda gjithësisë dhe duhet ta pranojmë se nuk mund ta mendojmë atë jashtë zhvillimit të rrjedhës së gjithësisë. Nëse në gjithësi zhvillimet ndodhin ngadalë dhe ligjet brenda saj lëvizin në atë drejtim, edhe zhvillimi dhe maturimi i njeriut duhet të realizohet në të njëjtën mënyrë. Kurani fisnik i cili është tërësia e parimeve dhe bazave të atij zhvillimi, ka zbritur brenda 23 vjetëve bazuar mbi këtë parim.

Allahu i Madhëruar ka caktuar periudhën 23 vjeçare... Kjo periudhë mund të ishte edhe 24 ose 25 vjet. Jeta e Profetit tonë (s.a.s) do vazhdonte deri në moshën 63 vjeçare. Pas 23 viteve zbritje, shpallja do të përfundonte bashkë me jetën e tij.

Çfarë duhet të bëjmë për t'u mbrojtur nga e keqja e shpirtrave të pisët dhe xhindëve dhe çfarë duhet lexuar?

a. Pikë së pari duhet të krijojmë një lidhje të fortë me Allahun dhe Profetin e tij, duhet të zbatojmë parimet e Islamit.

Rruga më e drejtë dhe e para në këtë çështje është lidhja me Allahun (xh.sh) dhe Profetin (s.a.s), praktikimi i parimeve të Islamit, pasurimi shpirtëror dhe jetesa brenda një klime të pastër. Ndërsa realizojmë këto qëllime njëkohësisht nuk duhet të lëmë asnjë hapësirë për hyrjen e shpirtrave të papastër. Një boshllëk në shpirt do t'i hapte rrugë rrjedhës së tyre.

b. Duhet t'i lutemi Allahut (xh.sh) me gojë dhe me vepra.

Komponenti i dytë i rëndësishëm në mbrojtjen nga shpirtrat e këqij dhe xhindët është lutja e cila është si një armë e fortë në adhurimet tona. Mbrojtja duhet të bëhet brenda tërësisë së veprave dhe fjalëve, botës së brendshme dhe asaj të jashtme.

Lutja bëhet në dy mënyra, me fjalë dhe me vepra. Punimi i tokës, mbjellja, vaditja është lutja me vepra e bujkut, ndërsa ngritja e duarve dhe lutja me fjalët "O Zot, na i shto mirësitë dhe na dhuro begati!", është lutja me fjalë. Bërja e lutjes së dytë pa realizuar të parën nuk do t'i sillte asnjë të mirë njeriut. Përballë kësaj edhe mjaftimi vetëm me lutjen e parë do të sillte mangësi në mirësitë dhe bereqetin e punës, në adhurimet e atij personi dhe e gjithë puna do ishte e barazuar me një zero të madhe.

Le të themi që një besimtar i lutet Allahut me këta fjalë: "O Allah! Sillu fitore myslimanëve!". Kjo është një lutje e bukur por jo e mjaftueshme. Sepse zogu nuk mund të fluturojë me një krah. Përgatitja e plotë për luftë e Profetit (a.s) në luftën e Bedrit dhe më pas mbështetja dhe lutja me shpirt tek Allahu (xh.sh) tregon që në fillim duhet të punohet, do të thotë që brenda rrethit të shkaqeve të bëhet çka është e nevojshme pastaj brenda këtij rrethi të ngrihen duart për të bërë lutjen me fjalë.

Kështu si kjo ,shkuarja tek doktori kur ndjejmë ndonjë dhimbje apo kur jemi të sëmurë dhe përdorimi i ilaçeve është një lloj lutjeje me vepra. Lutja që bëhet më vonë duke i kërkuar shërim Allahut është lutja me fjalë. Ndonjëherë sëmundjet apo dhimbjen e kokës, dhëmbit mund ta kalojmë duke iu lutur Allahut dhe duke kërkuar shërim prej Tij, por në disa raste është e domosdoshme vizita e doktorit. Me fjalët *"Allahu ka dhënë shërim për çdo sëmundje"*, Profeti (s.a.s) na këshillon për lutjen me vepra. Ashtu siç e theksuam më sipër, njeriu duhet të kryejë detyrën e tij në fillim pastaj të plotësojë lutjen dhe të kërkojë shërim

nga Allahu (xh.sh). Ndonjëherë, ashtu siç nuk është e mjaftueshme lutja me fjalë, ashtu nuk është e mjaftueshme edhe lutja vetëm me vepra. Allahu (xh.sh) mund ta japë shërimin kur bëhen të dyja lutjet ose vetëm njëra. Çdo gjë është në dorën e Tij. Ka njerëz të cilët nuk e njohin lutjen me fjalë dhe bëjnë një jetë të shëndetshme duke u argëtuar e dëfryer, por ka edhe të tjerë të cilët përdorin ilaçe dhe pavarësisht se nuk pushojnë së luturi Allahut, shihet se e kalojnë jetën duke vuajtur dhe në mundime. Në këta raste mendojmë se lutja nuk na është pranuar. Megjithëse pranimi i lutjes është tjetër dhe përgjigja e saj është krejt tjetër gjë. Çdo lutje dëgjohet dhe ka një përgjigje, por kjo përgjigje ashtu siç mund të jepet menjëherë, mund edhe të vonojë ose ndoshta nuk do të jepet në këtë botë, por në botën tjetër. Kjo është krejtësisht e lidhur me urtësinë dhe diturinë e Allahut (xh.sh). Kur ju e thërrisni doktorin ai vjen menjëherë, por nëse do t'i drejtoheshit "M'i jep këta ilaçe", doktori mund të mos jua japë të njëjtat, ai e di cilat janë të përshtatshmet për sëmundjen tuaj ose jep atë më të mirën, më të dobishmen. Allahu i Madhëruar i dëgjon gjithmonë lutjet e robit, i jep atij qetësi në shpirt sepse Ai ndodhet më afër tij se damari i qafës. Por si një kërkesë e diturisë mund të mos na japë gjithçka dëshirojmë, kjo ndonjëherë mund të jetë në dobinë e robit ose mund të jetë një vonesë për t'iu përgjigjur më vonë në mënyrë më të dobishme për të. Ai është zotëruesi i pasurisë dhe e shpërndan atë ashtu siç dëshiron vetë; robi mirëpret si mjerimin ashtu dhe mirësinë. Ai nuk bën asnjëherë diçka të pakëndshme, në çdo punë të Tij ka jo një, por një mijë urtësi.

Përveç kësaj duhet ta dimë se edhe lutja, ashtu si namazi, është një adhurim i pastër dhe duhet të kryhet gjithmonë në mënyrë të sinqertë. Njeriu duhet t'i drejtohet Allahut i pastër shpirtërisht dhe të kërkojë kënaqësinë e Tij. Ndonjëherë Ai mund ta kënaqë robin me mirësinë dhe

bujarinë e Tij. Prandaj lutjet të cilat bëhen me qëllimin që të pranohen menjëherë, të arrijnë përfundimin e kërkuar, ndoshta nuk mund të pranohen, nuk mund të arrijnë të lartësohen deri në pikën e pranimit për arsye se nuk janë të sinqerta dhe të pastra.

Nuk duhet të lutemi për t'u shpërblyer menjëherë, por lutja duhet të jetë këmbëngulëse dhe e vazhdueshme në derën e Krijuesit. Të kërkosh strehë tek Zoti yt, të kërkosh gjithmonë më të mirën, të jesh besnik në derën ku lartësohen vlerat dhe virtytet njerëzore, ku mëkatet bien porsi gjethe, të jesh i devotshëm dhe duke mos harruar që jemi brenda një provimi të presësh me mendimin se rezultati përfundimtar do shihet në ahiret, është domosdoshmëri e sinqeritetit të një robi.

c. Duhet të marrim lutjet e atyre që besohen se janë njerëz të afërt të Allahut.

Është shumë e rëndësishme të kërkosh dobi nga lutjet (duatë) e atyre personave të afërt me Allahun, të cilëve mund t'u pranohet lutja. Pikërisht edhe Profetit tonë i kanë kërkuar gjëra të tilla. Sipas transmetimeve të Ahmed ibn Hanbelit, Ebu Davudit dhe Taberanit, Ummu Hani ka thënë: "Profetit i sollën një fëmijë me probleme mendore. Profeti (s.a.s) e preku dhe tha: *"Dil o armik i Allahut"*, pastaj lau fytyrën e fëmijës, bëri lutje dhe fëmija u shërua." Dhe ne kërkojmë lutjen e personave të tillë të afërt me Allahun, shpresojmë nga Allahu të na japë shërim.

Nëse kur dëmtohemi nga xhindët do shkonim menjëherë tek ata që merren me xhindë atëherë kjo gjë do sillte shumë dyshime dhe thyerje të botës shpirtërore, pastaj mund të shfrytëzohemi nga të tjerët. Kur shkon tek njëri merr një hajmali, tek tjetri dy dhe i sëmuri i shkretë bëhet si një hamall hajmalish. Nëse humbet një nga këta hajmali atëherë i sëmuri fillon të dridhet, ka frikë dhe e humb shpresën. Duke kërkuar shërim bëhet

shkas për shqetësime edhe më të mëdha. Prandaj, më e mira është të kërkojmë lutjen e të tjerëve. Abdullah b. Amr (r.a) i mësonte dua fëmijëve dhe atyre që nuk dinin ia shkruante. Nga njëra anë nuk duhet të lidhesh shumë më këtë punë. Sepse sipas transmetimeve të haditheve sahih (të sakta) Profeti (s.a.s) ndërsa lajmëron për hyrjen në xhenet të 70 mijë personave pa u pyetur dhe pa dhënë llogari, në mes të tyre numëron edhe ata të cilët i janë mbështetur Allahut duke mos respektuar hajmalitë. Prandaj gjëja më e mirë është të lutemi vazhdimisht dhe të mbështetemi tek Allahu (xh.sh).

d. Duhet shkuar tek mjekë dhe psikiatër besimtarë.

Një këshillë tjetër rreth kësaj teme është edhe vajtja tek mjekë psikiatër të cilët nuk janë ateistë, materialistë, që nuk besojnë tek xhindët dhe efektet e tyre. Mjekët jobesimtarë të cilët vuajnë nga varfëria shpirtërore dhe jetojnë brenda një dileme përsa i përket ndërgjegjes dhe ndjenjave, i këshillojnë njerëzit e stresuar të shkojnë të dëfrehen e të pinë, në mënyrë që të heqin nga mendja mendimet e këqija. Me një këshillë të tillë është sikur t'i japësh ujë të kripur ose t'i thuash "digju dhe pak" një njeriu i cili digjet nga etja për ujë. Ajo që e bën njeriun të sëmurë është shuarja dhe zhdukja e mendimit dhe shoqërimi me njerëz të këqij orë e çast. Po ai mjek dhe ajo mjekësi që mendon kështu mund të quhet me një sy, kur ta gjejë dhe syrin e humbur do fillojë të shohë rrugën e drejtë.

e. Duhet të lexojmë Ajetul Kursinë, Muavvidhetejn dhe lutje të tjera.

Pikë së pari, strehimi dhe mbështetja tek Allahu (xh. sh) është pika që zë vendin më të rëndësishëm. Allahu i Madhëruar i urdhëron robërit e tij në Kuran kështu: ***"Nëse djalli fillon të të joshë kërko mbështetje te Allahu."*** (Fussilet, 36) Domethënë, thuaj: "*Eudhu bil'lahi minesh shejtani*

rraxhim". Ndërkohë kështillojmë të lexohen dhe ajetet 97, 98 të sures Mu'minun.

Leximi i Ajetul Kursisë këshillohet nga vetë Profeti (s.a.s). Një nga sahabët kishte kapur një shpirt të rrezikshëm në trajtë njeriu që përpiqej të vidhte mallin e zekatit. Për të shpëtuar ai shpirt i poshtër ishte drejtuar me fjalët: "më lësho, a të mësoj se cila është lutja që të mbron nga ne: është Ajetul Kursi." Profeti ynë (s.a.s) është shprehur kështu: *"Ai është gënjeshtar por këtë radhë ka thënë të vërtetën."*

Kur Profetit (s.a.s) i kishin bërë magji çifutët, ajo magji ishte zhdukur nga leximi i sureve Felek dhe Nas. Përveç kësaj, sipas transmetimit të Hz. Aishes (r.a), Profeti (s.a.s) lexonte nga tre herë në mëngjes dhe darkë suret Felek dhe Nas, u frynte shuplakave të bashkuara për lutje dhe çdo herë me to fërkonte trupin deri ku t'i arrinin duart. Sërish Profeti ka thënë nga tre herë në mëngjes dhe darkë "*Bismil'lahil ledhi la jedurru mea ismihi shej'un fil erdi ue la fis semai ue huves Semiul Alim*" dhe kjo ishte një garanci për t'u mbrojtur nga paraliza. Edhe lutja "*Eudhu bi kelimatil'lahi tammeti min kul'li shejtanin ue hammetin ue min kul'li ajnin ue lammetin*", zë vend mes lutjeve të këshillueshme.

Ndërsa këshilla e Gazaliut në lidhje me këtë çështje është leximi një herë *Bismil'lah*, dhjetë herë *Allahu Ekber*, 19 herë "*La juflihus sahiru hajthu eta*" dhe "*min sherr'in neffathati fil ukad*" (Taha, 69; Nas, 4).

Sipas një këshille të një dijetari tjetër, para se të lexojmë duhet të pimë pak ujë, pastaj të lexojmë dy ajetet e mësipërm, më vonë leximi duhet të përsëritet 19 herë.

Në lidhje me këtë çështje në librat e haditheve ka shumë lutje.

Cili është qëllimi i krijimit të shejtanit dhe lejimi i devijimit të njerëzve nga e vërteta?

a. Nëse nuk do të krijohej shejtani atëherë edhe krijimi i njeriut nuk do të kishte vlerë. Ka shumë krijesa të panumërta të ngjashme me engjëjt të cilët i binden Allahut (xh.sh) dhe nuk bien pre e cytjeve të shejtanit. Allahu ashtu siç i ka krijuar bimët dhe kafshët të ndryshëm nga njeriu ashtu ka krijuar dhe njerëzit si pasqyra të engjëjve në tokë por të ndryshëm nga ta. Për të nxjerrë në pah aftësitë dhe cilësitë e pasqyruara në përmbajtjen e njeriut të krijuar, ka nxjerrë përballë tij shejtanin dhe shpirtrat e këqij si një element provokimi dhe ngacmimi. Shejtani i cili pasqyron mendjemadhësi dhe kryelartësinë është i vetëdijshëm në punën që bën. Shejtani është si një vrapues maratone që e shtyn njeriun nga mbrapa. Për të arritur qëllimin dhe për të shijuar fitoren, njeriu duhet ta kalojë rivalin i cili e ndjek, ta lërë mbrapa dhe të ecë gjithnjë para tij. Nëse nuk do të gjendej një rival i tillë si një element ngacmimi dhe nxitjeje, atëherë nuk do të ishte e mundur marrja me seriozitet e garës dhe zhvillimi i aftësive të tij. Nuk do të arrinte të gjente bazën për zhvillimin e aftësive të tij dhe kështu do të shuhej e zhdukej. Njeriu ka arritur vlerat më të larta njerëzore dhe shkallën e njeriut të përkryer nëpërmjet luftës me shejtanin dhe kështu janë formuar Ebu Bekrat... dhe është po i njëjti njeri ai i cili me paaftësinë dhe pavendosmërinë e tij ka formuar Ebu Xhehilë...

b. Nuk është diçka e keqe krijimi i shejtanit, por veprimi i kryer në përshtatje me të. Ashtu si në një krim gjatë të cilit është përdorur thikë apo ndonjë armë, ku shkaku i vërtetë është dora e cila ka qëlluar. Po ashtu dhe shejtani është një mjet për të bërë të keqen, fajtori i vërtetë është ai i cili e përdor këtë mjet. Shkaku i vërtetë i përfundimit keq të atyre veprave të cilat frymëzohen nga mësimet e

shejtanit, nga një vullnet i urdhëruar nga nefsi, dhe nga vetë nefsi i njeriut nuk është shejtani. Shejtani dhe të këqijat janë vetëm shkaqe të thjeshta, sëmundja e vërtetë është vullneti i njeriut. Njerëzit nuk bëjnë keq nga krijimi i shejtanit, por me vullnetin e tyre.

c. Njeriu çdo gjë e vlerëson brenda rrethit të tij të ngushtë dhe sipas përfundimeve të vogla që ka në dorë. Përkundrazi, të krijuarit e Allahut (xh.sh) sheh në një përfundim të përgjithshëm dhe tek dobitë. P.sh., kur ne fusim dorën në zjarr ajo digjet. Tani, a mund të themi që zjarri është i dëmshëm? Në të vërtetë ne jemi ata të cilët e bëmë të dëmshëm. Le të themi se i pranojmë pjesërisht këto dëme, atëherë ne mund të përcaktojmë dobitë dhe të mirat e zjarrit duke parë rezultatet e përgjithshme. Kështu qëndron çështja edhe me elektricitetin apo shiun. Allahu (xh.sh) kur krijon diçka shikon në përfundimet e përgjithshme. Edhe shejtani, në çështjen e krijimit, sheh në përfundimet e përgjithshme; shejtani ka rolin e tij në zvarritjen në xhehenem me dëshirën e tij të Ebu Xhehlit dhe në ngritjen shpirtërore dhe në xhenet të mijëra evlijave, besimtarëve dhe njerëzve me një shpirt thesari si Ebu Bekri (r.a).

d. Nëse lëmë mënjanë përfundimet e përgjithshme dhe të mëdha, a mund të themi se zjarri, elektriciteti e shiu janë të dëmshëm dhe të themi "ah sikur të mos ishin" vetëm se janë bërë shkak për disa dëme të pjesshme? Jo. Gjithashtu nuk mund të themi as "pse është krijuar shejtani". Ashtu si në emër të shëndetit të të gjithë trupit presim një pjesë të gangrenizuar, një këmbë apo një dorë, ashtu nuk duhet të flasim rreth shejtanit vetëm për disa të këqija në krahasim me rezultatin e madh dhe dobitë që sjell. A mund të heqim dorë nga ushtria dhe të mos shkojmë në luftë duke nxjerrë shkak vdekjen e ushtarëve?

Njerëz të tillë të mashtruar nga zbukurimet e shejtanit

janë një në njëmijë në krahasim me numrin e besimtarëve të përkushtuar në këtë fe. Nuk mund të themi "Si ka mundësi? A nuk hyjnë në xhehenem me mijëra njerëz të mashtruar nga lojërat e shejtanit?", sepse cilësia e besimtarit është më e rëndësishme dhe qëndron më lart se sasia e jobesimtarit. Cila është më e rëndësishme, jeta e një njeriu apo jeta e një insekti? Nëse kemi një mijë bërthamë hurme nga të cilat përfitohen 11 pemë, cila është më fitimprurëse, të kesh njëmijë bërthama apo të mbash 11 pemë megjithëse 989 të tjera janë të kalbura?

PJESA E DYTË

VEPRAT E TË OBLIGUARIT DHE PASTËRTIA

VEPRAT E TË OBLIGUARIT



"Pastërtia është gjysma e besimit."

hadith



Feja islame kërkon nga burrat dhe femrat myslimane që kanë arritur moshën e pjekurisë zbatimin e disa urdhrave dhe shmangien nga gjërat e ndaluara. Këta urdhra dhe ndalesa ndryshe quhen "*teklif*", ndërsa myslimani i cili i zbaton quhet "*mukelef*".

Kur fillon obligimi?

Që një njeri të quhet i përgjegjshëm për zbatimin e obligimeve fetare duhet:

a. të jetë i shëndoshë mendërisht

b.të arrijë moshën e pjekurisë

Feja u drejtohet atyre njerëzve që përdorin mendjen dhe arsyen dhe me anë të vullnetit dhe zgjedhjeve të tyre i drejton ata drejt së mirës të dy botëve, duke premtuar lumturi të përjetshme për ato që i përgjigjen thirrjes së saj.

Prandaj kushti i parë i të obliguarit është të jetë i shëndoshë mendërisht. Një person i shëndoshë

mendërisht është ai person i cili me anë të mendjes është i aftë të dallojë të mirën nga e keqja. Një kusht tjetër i të obliguarit është arritja e moshës së pjekurisë.

Ç'do të thotë mosha e pjekurisë?

Është mosha në të cilën njerëzit nuk quhen më fëmijë dhe fillojnë të përjetojnë zhvillimin e ndjenjave seksuale.

Kur fillon mosha e pjekurisë? Si mund ta dimë?

Sipas shumicës së dijetarëve myslimanë, mosha e pjekurisë tek vajzat është nga mosha 9-15 vjeç ndërsa tek djemtë 12-15 vjeç. Arritja e moshës së pjekurisë dallohet me ardhjen e menstruacioneve, periodave mujore tek vajzat, ndërsa tek djemtë me realizimin e orgazmës, ose ndryshe derdhjes. Ndonjëherë ndodh që një i ri të arrijë moshën e pjekurisë, por të mos shohë as menstruacione apo të ketë derdhje. Persona të tillë hyjnë në moshën e përgjegjësisë dhe obligimit. Edhe pse pavarësisht moshës nuk kanë patur zhvillimet e nevojshme, ata pranohen si të obliguar. Mosha e pjekurisë e përcaktuar për vajzat dhe për djemtë është 15 vjeç.

Me arritjen e moshës së pjekurisë nëse tek ai person nuk gjendet ndonjë provë që të tregojë zhvillimin e mangët mendor të tij, atëherë ai person konsiderohet i obliguar. Në termat fetare do të thotë të jetë 'i shëndoshë mendërisht dhe i pjekur'. Me këtë nënkuptojmë fitimin e të gjitha të drejtave, të fjalës, të veprimit; do të thotë që ai person tashmë mund të mbajë përgjegjësi për obligimet dhe ndalesat.

Cilat janë detyrat fetare të një të obliguari?

Myslimani i cili arrin moshën e pjekurisë ngarkohet me kryerjen e disa detyrave të cilat në librat e fikhut dhe ilmihale njihen si "detyrat e të obliguarit".

Këto detyra ndahen në tetë pjesë: farz, vaxhib, sunet, mustehab, mubah, mekruh, mufsid dhe haram.

1. *Farz*: janë vendime të cilat mbështeten në argumente të prera dhe ndahen në dy pjesë:

a) *Farz ajn*: Janë veprat të cilat duhet t'i kryejë çdo mysliman i obliguar. Si p.sh., namazi dhe agjërimi.

b) *Farz kifaje*: Janë detyrime të cilat nëse zbatohen nga një grup myslimanësh, bie përgjegjësia nga myslimanët e tjerë. Si p.sh., namazi i xhenazes dhe marrja e selamit. Nëse asnjë nga myslimanët nuk e zbaton një detyrim të tillë, atëherë të gjithë janë përgjegjës për këtë.

2. *Vaxhib*: Janë vendime të cilat mbështeten në argumente jo të prera. Si p.sh., namazi i vitrit dhe i bajramit.

3. *Sunet:* janë fjalët, veprat dhe çdo gjë të cilën e ka miratuar vetë Profeti. Suneti ndahet në dy pjesë:

a) *Sunet mueked*: Janë vepra të cilat Profeti i ka kryer vazhdimisht dhe nuk i ka lënë asnjëherë. Si p.sh., sunetet e namazeve të sabahut, të drekës dhe akshamit. Edhe ezani, ikameti, falja me xhemat, të njohura ndryshe si shenja të Islamit janë sunet mueked (sunet i fortë). Ndryshe quhen edhe suneti Huda.

b*) Sunet gajri mueked*: Janë vepra të cilat Profeti ndonjëherë i ka bërë e ndonjëherë i ka lënë. Si p.sh., sunetet e namazit të ikindisë dhe të jacisë. Edhe veprimet ditore si ngrënia pirja, veshja, ulja, ngritja e të tjera të cilat njihen si rregulla të mirësjelljes hyjnë në grupin e sunetit

gajri muekked. Këta ndryshe quhen dhe suneti zevaid.

4. *Mustehab*: janë veprat të pëlqyeshme të cilat janë kryer ndonjëherë nga Profeti. Si p.sh., të japësh sadaka (lëmoshë) dhe të mbash agjërim nafile.

5. *Mubah*: janë vepra nga të cilat përfiton sevape nëse i kryen, por nuk bën mëkat nëse nuk i kryen. Si p.sh të ulesh, të hash, të pish.

6. *Mekruh:* janë vepra të papëlqyeshme të cilat ulin sevapin e veprës së kryer. Si p.sh., të shohësh përreth gjatë faljes së namazit. Mekruhu ndahet në dy pjesë:

a) *Mekruh tahrimen*: quhen vepra të cilat janë më afër haramit. Si p.sh., harxhimi i tepërt i ujit gjatë marrjes së abdesit. Myslimani përfiton sevape nëse e lë mekruhun tahrimen. Nëse vazhdon ta kryejë, ekziston mundësia e dënimit në ahiret.

b) *Mekruh Tenzihen*: Është mekruhu më afër hallallit. Si p.sh., pastrimi i hundës me dorën e djathtë. Një veprim i tillë nuk dënohet, por fitohen sevape me braktisjen e tij. Lejimi i mekruheve edhe megjithëse është gabim, nuk e nxjerr njeriun nga feja.

7. *Mufsid:* janë ato vepra të cilat prishin aktet fetare Si p.sh., dalja e gjakut nga trupi kur je me abdes, qeshja në namaz dhe ngrënia kur je agjërueshëm.

8. *Haram*: janë vepra të cilat janë të ndaluara me argumente të prera. Si p.sh., të pish pije alkoolike, t'i kundërvihesh prindërve.

PËRGATITJA PËR NAMAZ

ABDESI

Feja Islame e vlerëson shumë pastërtinë. Të jesh i

pastër para se të kryesh adhurimet është një nga kushtet fillestare. Kur flasim për faljen e namazit, duhet të dimë që çdo mysliman duhet të ketë fillimisht abdes para se at kryejë atë. Mënyrën e marrjes së abdesit e dimë nga praktika e Profetit tonë (s.a.s).

Para se të marrim abdes mund të kemi nevoja personale. Në lidhje me këtë çështje do analizojmë dy terma: "istinxha" dhe "istibra".

Istinxha: është pastrimi i organit nga i cili kemi kryer nevojat tona personale.

Istibra: meshkujt duhet të jenë të kujdesshëm përsa i përket mosmbledhjes së urinës në organin e riprodhimit pas urinimit. Mënyra më e mirë për ta realizuar këtë është të kolliturit ose të ecurit pak.

Duhet të plotësojmë disa kushte që abdesi të na pranohet. Këta kushte quhen farzet e abdesit.

FARZET E ABDESIT

Larja e fytyrës një herë

Larja e duarve deri në bërryla një herë

Bërja mes'h e ¼ të kokës (fërkimi me dorë të lagët) një herë

Larja e këmbëve një herë

Këto kushte janë të domosdoshme për pranimin e abdesit. Por nëse marrim abdes duke praktikuar vetëm këto kushte, ky abdes nuk është i njëjtë me abdesin që ka marrë Profeti (a.s). Nëse praktikojmë dhe sunetet e abdesit, atëherë mund ta plotësojmë atë ashtu si vetë Profeti (a.s).

SUNETET E ABDESIT

1. Shqiptimi i Eudhu bismil'lahit para se të marrim abdes
2. Bërja e nijetit
3. Përdorimi i misvakut ose pastrimi i dhëmbëve me furçë
4. Shpëlarja e gojës dhe e hundës nga tri herë
5. Larja e çdo pjese nga tri herë
6. Vazhdimi i abdesit pa u ndërprerë
7. Të merret abdes sipas radhës së caktuar
8. Fërkimi i veshëve dhe qafës
9. Fërkimi i tërë kokës
10. Kur lajmë këmbët të fillojmë nga gishtërinjtë

MARRJA E ABDESIT

Larja e duarve

Duart lahen deri në kyçe. Veçanërisht lahen mirë pjesët mes gishtërinjve dhe tregohet kujdes të mos mbesë asnjë pjesë e palagur.





Larja e gojës

Me dorën e djathtë fusim ujin në gojë. Çdo herë e nxjerrim ujin pasi e shpërlajmë mirë gojën.

Larja e hundës

Me dorën e djathtë marrim ujin, e tërheqim pak me hundë. Me dorën e majtë pastrojmë hundën nga sekrecionet nëse ka.






Larja e fytyrës

Bashkojmë shuplakat e duarve, i mbushim me ujë dhe lajmë fytyrën tri herë. Fytyra lahet prej ku dalin flokët e deri nën mjekër dhe prej veshit në vesh.

Larja e duarve deri në bërryla

Lajmë tri herë dorën e djathtë e pastaj të majtën deri në bërryla.





Fërkimi (mes'hi) i kokës

Më dorë të lagur fërkojmë ¼ e kokës.



Fërkimi i veshëve

Me duart të lagëta prekim veshët, gishtin e vogël e vëmë në vesh, gishtin e madh pas veshit dhe me tre gishtat e tjerë fërkojmë qafën.

Fërkimi i qafës

Fërkimi i qafës siç e thamë bëhet me tre gishtërinjtë e tjerë nga ana e jashtme e tyre.





Larja e këmbëve

Në fillim lajmë këmbën e djathtë me ndihmën e dorës së majtë deri në kyçe. Pastaj të majtën. Duhet të tregohet kujdes në larjen e pjesës mes gishtërinjve.

GJËRAT QË PRISHIN ABDESIN

Abdesi prishet në rast se:

1. Kryejmë ndonjë nevojë.

2. Na rrjedh gjak, qelb ose limfë nga trupi.

3. Vjellim me gojë plot.

4. Na bie të fikët.

5. Flemë.

6. Dehemi.

7. Qeshim me zë në namaz aq sa ta dëgjojnë të tjerët pranë nesh.

8. Nga goja del gjak sa të ndryshojë edhe ngjyra e pështymës.

GJËRAT QË NUK E PRISHIN ABDESIN

Abdesi nuk prishet në rastet e mëposhtme:

1. Nëse nga dhëmbët na rrjedh pak gjak sa të mos ndryshojë ngjyrën e pështymës.

2. Nëse qajmë.

3. Nëse na del pak gjak nga trupi por që nuk rrjedh.

4. Nëse presim flokët apo thonjtë.

5. Nëse buzëqeshim në namaz.

ABDESI I PERSONIT TË JUSTIFIKUAR

Në fenë tonë është thelbësore paraqitja e lehtësimeve dhe heqja e çdo vështirësie në çdo çështje, përfshirë edhe

adhurimet. Për njerëzit të cilët kanë probleme në lidhje me abdesin, janë paraqitur vendime të përshtatshme me gjendjen e tyre. Ato shqetësime të cilat prishin abdesin në mënyrë të vazhdueshme i quajmë justifikim, ndërsa personi, person i justifikuar. Nëse kemi raste si rrjedhje të vazhdueshme gjaku, mosmbajtje e urinës, rrjedhje e plagës, apo sekrecione të vazhdueshme tek femrat, atëherë të gjitha konsiderohen justifikim. Edhe shqetësimet trupore të cilat zgjasin të paktën sa një kohë namazi quhen justifikim. Një person i tillë merr abdes për çdo kohë namazi dhe brenda asaj kohe mund të falë sa namaze të dëshirojë. Kur del koha e namazit abdesi i tij prishet, në kohën e namazit tjetër duhet të marrë përsëri abdes. Personi i justifikuar nuk mund të drejtojë (të jetë imam) në falje personat e tjerë normalë.

MES'HI MBI FASHË DHE MESTE

Në fenë Islame janë sjellë shumë lehtësime lidhur me kryerjen e obligimeve fetare. Një ndër këta është dhe fërkimi ose mes'hi mbi fashë ose mbi plagë.

Mes'h do të thotë të fërkosh diçka me dorë përsipër. Mes'h quhet dhe fërkimi me dorë të lagët i kokës, këmbëve apo mesteve të veshura, ose mbi fashë.

FËRKIMI MBI FASHË

Në rastet kur thyejmë, nxjerrim ose lëndojmë një pjesë të trupit, e nëse ajo pjesë mbështillet me fashë ose me allçi dhe nuk duhet të laget, fërkohet sipër me dorë të lagët. Madje nëse edhe fërkimi me dorë të lagët është i dëmshëm mund të hiqet dorë dhe prej tij. Një herë është i mjaftueshëm si mes'h mbi fashë. Nuk ka rëndësi nëse fasha mund të jetë vënë në kohën kur personi ka qenë i

papastër apo pa abdes dhe nuk ka një afat të caktuar. Për sa kohë do të vazhdojë të jetë i sëmurë do të vazhdojë të bëjë mes'h. Nuk është kusht të jesh me abdes para se të vësh fashën. Nëse pas mes'hit fasha bie ose thyhet, nuk është e nevojshme të bëhet dhe një herë mes'h.

MES'HI MBI MESTE

Në fenë Islame është e lejuar bërja mes'h, fërkimi me dorë të lagët mbi meste ose mbi çorape, këpucë apo të ngjashme me ato që plotësojnë kushtet e mestit. Profeti (a.s) e ka praktikuar mes'hin mbi meste.

Mestet duhet të plotësojnë disa kushte të cilat janë:

1. Mestet duhet të jenë aq të mëdha sa të përfshijnë këmbën deri në kyçe.

2. Mesti i veshur duhet të jetë i përshtatshëm për të ecur afërsisht 6 km rrugë.

3. Duhet të qëndrojnë në këmbë pa lidhëse.

4. Nuk duhet të depërtojë ujin.

5. Nuk duhet të jetë i shqepur ose i dëmtuar sa të duken tre gishtërinjtë e këmbës.

Kur marrim abdes duhet t'i fërkojmë këmbët me dorë të lagur një herë. Për këtë arsye duhet që të jemi me abdes kur mbathim mestet.

Koha e mesteve është 24 orë (një ditë) për vendasin dhe 72 orë (3 ditë) për udhëtarin. Koha e mestit fillon atëherë kur prishet abdesi. Për shembull, nëse një person ka marrë abdes dhe ka veshur mestet, i ka mbajtur ato pesë orë veshur dhe pastaj ka prishur abdesin, atëherë koha e mestit nis me prishjen e abdesit dhe zgjat 24 orë për atë që nuk është udhëtar dhe 72 orë për udhëtarin. Nuk merret parasysh koha kur ka veshur mestet.

GUSLI

Gusuli ka shumë dobi përsa i përket shëndetit shpirtëror, përgatitjes së besimtarit për adhurim, si dhe rregullon lëvizjen e gjakut duke vendos një ekuilibër në trup.

Gusul do të thotë larje e të gjithë trupit nga koka deri tek këmbët. Gusuli ndonjëherë është farz, ndonjëherë sunet dhe ndonjëherë mustehab.

KUR DUHET MARRË GUSUL

1. *Kur personi është i papastër (xhunub)*

Me të qenit i papastër ose ndryshe xhunub nënkuptohet gjendja e cila vjen pas kryerjes së marrëdhënieve seksuale apo pas ejakulimit të spermës. Nga organi i njeriut rrjedhin tre lloje lëngjesh: *medhi*, *vedi* dhe *meni*.

Medhi: është një lëng i hollë, pa ngjyrë dhe rrëshqitës i cili del si rrjedhojë e kënaqësisë që ndjen njeriu nga të luajturit me organin, nga ëndrrat apo imagjinata seksuale. Ndoshta dhe nuk ndihet kur rrjedh. Mund të ndodhë tek burrat dhe tek gratë.

Vedi: është një lëng i trashë, me ngjyrë të ngjashme me spermën që rrjedh për arsye të të ftohtit apo ngritjes së peshave të rënda dhe zakonisht rrjedh pjesë-pjesë pas urinimit.

Meni: sperma, rrjedh pas përjetimit epshor dhe del menjëherë, ka një ngjyrë dhe erë specifike të tijën.

Gusuli duhet marrë vetëm në rastin e derdhjes së menit, ejakulimit të spermës. Rrjedhja e medhit dhe vedit prish vetëm abdesin. Në këto raste pastrohet organi dhe pjesa ku ka rrjedhur dhe merret përsëri abdes.

Edhe nëse nuk ndodh derdhje e spermës në fund të marrëdhënieve seksuale, gruaja dhe burri quhen të papastër (*xhunub*). Edhe në rast se sperma rrjedh kur personi është i fjetur, i papërgjegjshëm apo kur nuk është i ndërgjegjshëm nuk ndryshon asgjë. Rrjedhja e spermës me epsh e bën personin të papastër. Nëse sperma rrjedh si pasojë e të ftohtit apo ngritjes së peshave të rënda atëherë, nuk kemi të bëjmë me papastërti.

Nëse një person zgjohet dhe vëren në rroba gjurmë sperme por nuk e mban mend derdhjen, ai person duhet të marrë gusul. Ndërsa personi i cili e mban mend ardhjen e orgazmës por nuk ka shenja sperme, nuk ka nevojë të marrë gusul.

A prishet gusuli nëse gjatë marrjes së tij prishet abdesi?

Nëse gjatë gusulit na rrjedh gjak nga ndonjë pjesë e trupit apo ndodh ndonjë nga situatat që prishin abdesin, kjo nuk e pengon gusulin. Por për të kryer adhurimet, duhet që të marrim dhe një herë abdes pas gusulit. Gjendjet të cilat kërkojnë marrjen e gusulit janë të qarta. Nëse nuk realizohen ndonjëra prej tyre, atëherë gusuli nuk prishet. Por nëse gjatë gusulit kemi rrjedhje të spermës apo *medhi,* më e përshtatshme është që gusulin ta fillojmë prej fillimit.

2. *Menstruacionet (hajdi) dhe Lehonia (nifasi)*

Pas përfundimit të menstruacioneve, ose të përmuajshmeve, dhe lehonisë, femrat duhet të marrin gusul. Nëse gjakderdhja vazhdon edhe pas përfundimit të afatit të caktuar, atëherë nuk quhet gjak menstruacionesh, por gjak i pastër që rrjedh për ndonjë arsye tjetër dhe pas rrjedhjes së tij nuk duhet marrë gusul.

Vendimi për femrat që janë me menstruacione dhe lehona është i njëjtë me personin që është *xhunub* (i papastër). Përveç kësaj, femrat e kanë të ndaluara të kryejnë marrëdhënie seksuale gjatë kësaj periudhe. Nuk u lejohet as agjërimi.

Gjithashtu marrja e gusulit është sunet para namazave të xhumasë dhe bajramit, kur veshim ihramin me nijetin për umre apo për haxh dhe për të qëndruar në Arafat.

Marrja e gusulit është mustehab në rastet kur lajmë një xhenaze, kur japim gjak, kur hyjmë në Mekë dhe Medine, në netët e Beraetit dhe të Kadrit, para se të hyjmë në mbledhje, kur veshim rroba të reja, kur pendohemi për një mëkat, etj.

FARZET E GUSULIT

1. Larja mirë e gojës dhe shpëlarja me ujë të bollshëm.
2. Larja mirë e hundës.
3. Larja e gjithë trupit pa lënë asnjë vend të thatë.

Gusuli merret kështu:

• Në fillim thuhet *bismil'lah* dhe bëhet nijeti për marrjen e gusulit.

• Lahen mirë vendet e turpshme, ndonjë pjesë tjetër e papastër në trup dhe duart.

• Merret abdes.

• Lahen mirë goja dhe hunda nga tri herë.

• Pastaj lahet i tërë trupi duke nisur nga koka, shpatulla e djathtë dhe ajo e majtë. Tregohet kujdes të mos mbetet

asnjë pjesë pa u larë dhe të mos shpërdorohet uji pa nevojë.

ÇFARË DUHET PASUR KUJDES GJATË MARRJES SË GUSULIT

• Duhet të lahen dhe fërkohen mirë vendet të cilat janë të vështira dhe nuk mund të arrijë uji si pjesa e brendshme e veshit, kërthiza, dhe pjesa e nënsqetullave.

• Kur marrim gusul nuk duhet të flasim dhe të lexojmë lutje.

• Nuk duhet të qëndrojmë në drejtim të kiblës të zhveshur dhe vendet e turpshme duhet t'i lajmë duke i mbuluar.

• Flokët duhet të lahen mirë në mënyrë që uji të shkojë deri tek rrënjët.

• Nëse në vendin ku marrim gusul mblidhet ujë, atëherë në fund duhet të lajmë këmbët.

• Nëse lahemi në dush, atëherë është e mjaftueshme që të qëndrojmë nën ujë aq sa duhet për të larë tre herë kokën dhe shpatullat dhe të fërkohemi.

• Kur marrim gusul kemi dhe abdes për t'u falur. Me këtë abdes mund të falim namaz dhe të bëjmë të gjitha adhurimet të cilat kryhen kur je me abdes.

• Nëse paraqitet ndonjë nga rastet që prishin abdesin ,atëherë prishet vetëm abdesi, gusuli nuk prishet.

GJËRAT E NDALUARA PËR PERSONAT QË DUHET TË MARRIN GUSUL

Gjërat të cilat janë ndaluara para marrjes së gusulit nga ata persona që e kanë farz marrjen e tij -përfshirë

këtu dhe femrat gjatë periudhës së menstruacioneve dhe lehonisë- janë:

1. Falja e namazit, bërja e sexhdes së tilavetit. Leximi i Kuranit qoftë edhe një ajet i vetëm. Lejohet vetëm leximi i ajeteve që përdoren si lutje dhe për të përkujtuar, falënderuar Allahun. Një grua me menstruacione apo e papastër mund të lexojë suren Fatiha vetëm për t'iu lutur Allahut.

2. Nuk lejohet të prekë dhe të marrë në dorë Kuranin. Por lejohet mbajtja e tij nëse është i mbështjellë me këllëf apo me ndonjë copë.

3. Bërja e tavafit në Qabe, hyrja në xhami apo kalimi nëpërmjet saj pa pasur ndonjë nevojë.

4. Mbajtja në dorë e një flete në të cilën janë të shkruara ajete të Kuranit.

GJËRAT MEKRUH PËR PERSONAT QË DUHEN TË MARRIN GUSUL

1. Mbajtja në dorë dhe leximi i ndonjë prej librave fetarë.

2. Ngrënia dhe pirja pa larë duart dhe gojën.

3. Shkrimi i ajeteve të Kuranit në një letër apo tabelë.

TEJEMUMI

Tejemumi merret në rastet e mungesës së ujit dhe zëvendëson abdesin apo gusulin për aq kohë sa të gjendet uji. Tejemum do të thotë të prekësh duart në dhé dy herë dhe të fërkosh njëherë fytyrën dhe pastaj duart deri në bërryla.

Tejemumi mund të merret me një gjë të pastër dhe me përbërje dheu. Tejemumi mund të marrim në vendet ku dheu, rëra, çaklli, allçia e të tjera si këta me përbërje dheu nuk janë prekur nga papastërtia. Mund të merret dhe në mermer, tjegull, tullë, gurë, smerald, zink, në tokë të lagur apo të djegur apo në vende ku kemi përzierje dheu si muret e suvatuara me llaç.

FARZET E TEJEMUMIT

Tejemumi ka dy farze:

1. Qëllimi (nijeti).

2. Fërkimi i duarve në dhé dhe fërkimi me to i fytyrës dhe duarve.

SI MERRET TEJEMUMI?

Nëse një mysliman nuk gjen ujë për të marrë abdes ose nuk mund ta përdorë për shkak të sëmundjes së rëndë, ekzistencës së armikut dhe nëse ekzistojnë pengesa të tjera, mund të marrë tejemum në materiale me përbërje dheu.

Në fillim bën nijetin dhe pasi thotë *Eudhu-Bismil'lah*, i vendos duart në dhé ose në një vend tjetër dhe i fërkon lart-poshtë. Pastaj fërkon fytyrën. Herën e dytë i vendos përsëri në dhé, i shkund dhe fërkon në fillim dorën e djathtë pastaj të majtën.

Gjatë marrjes së tejemumit është e domosdoshme heqja e unazës dhe fërkimi i vendit të saj si dhe fërkimi në mes të gishtërinjve.

RASTET QË PRISHIN TEJEMUMIN

Rastet që prishin abdesin dhe gusulin prishin dhe tejemumin. Nëse është marrë tejemum për shkak të sëmundjes, rrezikut, të ftohtit apo shkaqeve të tjera dhe këto shkaqe nuk ekzistojnë më, atëherë tejemumi quhet i prishur. Tejemumi prishet edhe në rastin kur një person është duke falur namazin dhe gjatë kësaj kohe gjendet ujë.

GJENDJET SPECIFIKE TË FEMRAVE

Një grua e pjekur mund të ketë tre lloje gjakderdhjeje. E para është ardhja e menstruacioneve në një moshë dhe periudhë të caktuar. E dyta është gjakderdhja për një afat të caktuar pas lindjes. Dhe e treta përveç këtyre dy rasteve është gjakderdhja (*istihade*) e cila lind nga ndonjë sëmundje.

Menstruacionet (hajdi)

Hajd quhet gjaku i cili rrjedh me ndërprerje rregullisht nga mitra e një femre të shëndetshme në moshën e adoleshencës. Këtë gjendje të femrave e cila fillon nga adoleshenca dhe mbaron me menopauzën e quajmë *hajd* (menstruacione, të përmuajshme).

Mosha e fillimit të menstruacioneve mund të ndryshojë nga një femër tek tjetra në varësi të vendit, kushteve klimaterike dhe zhvillimit fizik. Menstruacionet mund të fillojnë mesatarisht në moshën 11-13 vjeçare dhe të mbarojnë në moshën 45-50 vjeçare. Marrëdhëniet seksuale janë të ndaluara gjatë periudhës së menstruacioneve.

Menstruacionet mund të zgjasin më e pakta tri ditë e tri netë dhe më e shumta dhjetë ditë e dhjetë netë.

Gjendjen e pastër të femrës mes dy menstruacioneve e quajmë '*tuhur*' (pastërti). Kjo periudhë zgjat më e pakta 15 ditë.

Si femrat që kanë periudhë të shkurtër menstruacionesh, si ato me periudhë më të gjatë, nëse gjatë kësaj kohe nuk kanë rrjedhje gjaku, pra janë të pastra, kjo periudhë llogaritet nga menstruacionet. P.sh.: nëse një gruaje menstruacionet i zgjasin tri ditë, në ditën e parë dhe të tretë ka rrjedhje gjaku por në të dytën nuk ka, atëherë edhe kjo ditë konsiderohet ditë e menstruacioneve.

Përfundimi i menstruacioneve kuptohet nga ardhja e sekrecioneve me ngjyrë të bardhë. Ky lëng mund të jetë dhe në ngjyrë kaféje, jeshile, të verdhë dhe të zezë.

Kur mbaron periudha e menstruacioneve, femra duhet të marrë menjëherë gusul, të pastrohet dhe të fillojë adhurimet.

Namazet e pafalura gjatë periudhës së menstruacioneve nuk bëhen kaza, ndërsa ditët e paagjëruara kompensohen më vonë pas pastrimit.

Lehonia (nifasi)

Quhet gjaku që rrjedh nga mitra e gruas menjëherë pas lindjes. Ndryshe quhet dhe gjaku i lehonisë. Lehonia nuk ka një kufi të parë, por afati më i gjatë është 40 ditë. Pra gjakderdhja mbas lindjes së fëmijës mund të zgjasë më e shumta 40 ditë.

Me mbarimin e periudhës së lehonisë, femra mund të fillojë realizimin e adhurimeve si namazi, agjërimi e të tjera. Nëse gjakderdhja vazhdon edhe pas 40 ditëve, atëherë kjo periudhë nuk konsiderohet më lehoni, por hyn në grupin e gjakut që shkaktohet nga ndonjë arsye tjetër.

Istihadha

Nëse tek një femër me menstruacione periudha e tyre zgjat më pak se tri ditë apo më shumë se dhjetë ditë, atëherë gjaku që rrjedh quhet *istihadha*. Ndërsa tek lehona, gjaku i cili vazhdon të rrjedhë edhe pas dyzet ditëve quhet *istihadha*. Kjo lloj gjakderdhjeje nuk e pengon gruan në kryerjen e adhurimeve si namazi, agjërimi dhe gjithashtu nuk paraqet pengesë as për marrëdhëniet seksuale. Femra e cila ka një lloj gjakderdhjeje të tillë merr abdes për çdo kohë namazi. *Istihadha*, ashtu si dalja e gjakut nga hunda, bëhet shkak për prishjen e abdesit.

Gjërat e ndaluara kur femra është në periudhën e menstruacioneve dhe të lehonisë

1. Falja e namazit: Gjatë periudhës së menstruacioneve dhe të lehonisë femrat nuk mund të falin namaz. Dhe namazet e pafalura gjatë kësaj periudhe nuk kompensohen më pas. Nuk mund të bëhet as sexhdeja tilavetit dhe as ajo e falenderimit. Në kohët e namazeve mund të ulet dhe të përmendë Allahun duke bërë tesbih, si '*Estagfirullah, Subhanallah, Elhamdulil'lah*'.

2. Agjërimi: Gjatë këtyre periudhave femra nuk mund të agjërojë. Por agjërimin e muajit të ramazanit e kompenson më vonë.

3. Leximi i Kuranit. Lejohet vetëm leximi i atyre ajeteve që përdoren si lutje dhe për të përkujtuar Allahun. P.sh., mund të lexohet surja Fatiha për të bërë dua.

4. Prekja e Kuranit: Është e ndaluar prekja dhe mbajtja në dorë e Kuranit. Lejohet vetëm në rast se Kurani është i mbështjellë me ndonjë këllëf apo i futur në një kuti.

5. Hyrja në xhami kur nuk është e nevojshme.

6. Bërja e tavafit në Qabe.

7. Marrëdhëniet seksuale.

ÇFARË DUHET TË BËJNË FEMRAT NË GJENDJET SPECIFIKE?

Gjatë kësaj periudhe femrat nuk mund të kryejnë disa nga obligimet fetare. Kjo gjendje mund të sjellë ndikimin e krijesave të këqija tek ato. Ndikimi i këtyre krijesave ndodh zakonisht gjatë këtyre periudhave. Gjatë kësaj kohe këshillohet që të marrin abdes, të shtrojnë sexhaden dhe duke u ulur në drejtim të kiblës të përkujtojnë Allahun (*Allahu Ekber, La ilahe il'lallah*), të bëjnë dua dhe të lexojnë ato ajete nga Kurani që shërbejnë si lutje.

DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME ABDESTIN DHE GUSULIN

A e pengon manikyri abdesin?

Gjëja më e rëndësishme gjatë abdesit është depërtimi i ujit në lëkurë dhe thonj. Çdo që pengon kalimin e ujit është pengesë për abdesin. Prandaj edhe manikyri i cili pengon kalimin e ujit në thonj konsiderohet pengesë.

Kur duhet të marrë gusul personi xhunub (i papastër)?

Xhunubi mund të qëndrojë si i tillë sa të mos lërë asnjë kohë namazi pa falur. Ky është një limit. Sepse lënia e namazit është e ndaluar. E rëndësishme është të pastrohet sa më shpejt të mundet.

Njeriu i cili vdes i papastër shkon në ahiret si jobesimtar?

Nuk duhet t'i ngatërrojmë këta dy çështje. Sepse tjetër është besimi dhe tjetër gjë është të qenit i papastër apo të vdesësh kur je i papastër. Sipas Islamit gusuli nuk është një adhurim apo detyrim për të shpëtuar nga gjendja e papastërtisë. Ndoshta është kushti i parë i adhurimeve si namazi, agjërimi, leximi i Kuranit e të tjera. Këtë kusht

mund të quajmë ndryshe të domosdoshëm.

Nga ana tjetër, nxitimi për të marrë gusul nga personi i papastër tregon rëndësinë që i jep ai. Sepse ne nuk e dimë se ku dhe kur do të na vijë vdekja. Gjithsesi, besimtari, me pasurinë e tij shpirtërore e materiale, duhet të jetë gjithnjë i përgatitur për vdekjen. Megjithatë personi i cili vdes xhunub (i papastër) dhe ka besim në zemër sigurisht që do të hyjë si besimtar në ahiret. Nuk duhet të harrojmë Handhale b. Amirin i cili ra shehid në luftën e Uhudit dhe me urdhrin e profetit u la nga melekët duke u quajtur kështu "*gasiletul melaike*"- njeriu i larë nga melekët.

Çfarë mund të themi për larjen lakuriq?

Larja e trupit lakuriq në banjë nuk është e ndalur. Por sipas mendimit të përbashkët të dijetarëve të fikhut është mekruh.

Këtu nuk kanë vend fjalët "Allahu sheh çdo gjë". Kushti i parë për këtë është bindja dhe respekti ndaj etikës. Duhet të dimë se shikimi i vendeve të turpshme sjell harresë dhe as engjëjt *Kiramen Katibin* që janë pjesë e pandarë e jona nuk mund të jenë të kënaqur nga një gjendje e tillë.

A e prish gjumi abdesin?

Gjumi nuk e prish abdesin. Në të vërtetë ajo që prish abdesin është mos kontrollimi i vetes në gjumë. Meqë gjatë gjumit njeriu nuk mund të kontrollojë veten dhe mundësia e nxjerrjes së gazrave nga trupi është më e madhe, atëherë abdesi quhet i prishur. Këtu e rëndësishme është kuptimi i principit bazë. Ai është pozicioni të cilin mund ose nuk mund ta kontrollojë njeriu vetë.

A e prish abdesin qarja me dënesë?

Abdesi nuk prishet nga qarja, qoftë kjo për arsye të kësaj bote, qoftë për arsye shpirtërore. Sepse nuk ka asnjë vendim rreth prishjes së abdesit nga të qarit. Por nëse personi qan gjatë namazit, atëherë mund të hyjë në diskutim tema e pyetjes. Nëse njeriu qan në namaz për shkak të ndjenjave të tij ndaj Zotit, atëherë kjo nuk dëmton as namazin e as abdesin. Në fakt, kjo është diçka e dëshiruar me shpirt. Sipas transmetimeve të sahateve, Profeti (a.s) ishte si një kazan që përvëlohej gjatë namazit. Ai qante me dënesë dhe derdhte lotë. Hz. Omeri tregon se të qarit me dënesë dëgjohej deri në rreshtat e fundit.

Nga të gjitha këto nënkuptohet se të qarit për ndjenja hyjnore është një meritë e lavdërueshme. Ndërsa ajo që prish namazin është të qarit për një shqetësim, frikë apo në kujtesë të diçkaje që i përket kësaj bote.

A pranohet gusuli që marrin femrat pas mbushjes së dhëmbëve në ditët e menstruacioneve?

Në medhhebin Hanefi është farz larja mirë e gojës gjatë marrjes së gusulit. Por këtu duhet të analizojmë fjalën 'larja e gojës brenda'. Do të thotë që është farz larja e pjesës brenda gojës dhe jo brenda dhëmbit. Për këtë arsye themi që gjatë marrjes së gusulit është e detyrueshme larja e pjesës së jashtme të një dhëmbi të mbushur apo me këllëf. Kjo gjë sigurisht që ndodh, prandaj nuk ka vend për dyshime.

A është i lejuar tatuazhi? A është pengesë tatuazhi gjatë marrjes së abdesit dhe gusulit?

Këto dy çështje do t'i analizojmë të ndara. Të bësh tatuazh është tjetër gjë e të kryesh adhurimet me një trup me tatuazh është gjë tjetër.

Pikë së pari, duke u bazuar te bazat e Islamit, bërja e tatuazhit është kategorikisht e ndaluar.

Në një hadith të tij në lidhje me ndryshimin e formës sipas së cilës e ka krijuar Allahu njeriun, I Dërguari i Allahut (s.a.s) ka thënë: *"Allahu i ka mallkuar ata që bëjnë tatuazh dhe ata të cilët ua bëjnë të tjerëve."*


Një njeri i cili ka hyrë rishtazi në Islam dhe e ka marrë vesh më vonë të vërtetën, nëse mundet, duhet t'i heqë tatuazhet nga trupi. Nëse tatuazhi nuk përmban ndonjë simbol fetar si kryqi apo simbole të pamoralshme, atëherë nuk është e nevojshme që personi të vuajë për ta hequr atë. Ai duhet t'i kërkojë falje Allahut dhe të pendohet, të mbështetet tek Ai dhe të kërkojë mëshirën e Tij të pafund. Tatuazhet që mban në trup nuk duhet kurrsesi të bëhen pengesë për përmbushjen e adhurimeve. Tatuazhi bëhet duke vendosur nën lëkurë një substancë ngjyrosëse dhe për këtë arsye nuk bëhet pengesë për depërtimin e ujit mbi lëkurë. Prandaj mund të marrim dhe abdes dhe gusul me tatuazh. Nuk ka asnjë pengesë as për kryerjen e adhurimeve.

Gjithashtu këtu kanë vlerë edhe fjalët që Profeti (a.s) i ka thënë Amr b. Asit rreth kësaj teme: *"Me pranimin e Islamit fshihen dhe zhduken mëkatet e mëparshme."* Një person i cili në të kaluarën ka bërë gabime të tilla, le të pendohet dhe të përpiqet të kompensojë gjërat e humbura si një rob i bindur dhe i devotshëm.

PJESA E TRETË

NAMAZI

EZANI



Ezani i cili dëgjohet pesë herë në ditë nga minaret e xhamive do të thotë 'njoftim, lajmërim, thirrje'. Ndërsa kuptimi në ilmihal është: "fjalë specifike të caktuara"të cilat këndohen në kohë të caktuara për namazet farz.

Me anë të ezanit njerëzit lajmërohen për hyrjen e kohës së namazit, për faljen e namazit me xhemat si dhe shpallet madhështia e Allahut, Profeti Muhamed (s.a.s) si i Dërguari i Allahut dhe namazi si dera e rrugës së shpëtimit.

Para se ezani të pranohej si thirrje për namaz, Profetit i janë ofruar edhe mundësi të tjera si rënia e borisë apo e kambanës, por që nuk u pranuan. Meqë njerëzit do thirreshin për namaz, atëherë kjo thirrje duhet të bëhej me ca fjalë që pasqyrojnë shpirtin dhe esencën e namazit.

Ezani të cilin e ka pranuar Profeti (s.a.s) dhe që është kënduar për herë të parë nga Bilal Habeshiu, ai i cili vazhdon të këndohet edhe në ditët tona është ky:

Allahu Ekber, Allahu Ekber,
Allahu Ekber, Allahu Ekber,
Eshhedu en la ilahe il'lallah,
Eshhedu en la ilahe il'lallah,
Eshhedu enne Muhammeden Resulullah,
Eshhedu enne Muhammeden Resulullah,
Hajje ales salah,
Hajje ales salah,
Hajje alel felah,
Hajje alel felah,
Allahu Ekber, Allahu Ekber,
La ilahe il'lallah.

Ezani i sabahut ndryshon nga ezanet e katër kohëve të tjera. Pas pjesës '*Hajje alel felah*", këndohet dy herë '*es salatu hajrun minen neum*"që do të thotë "namazi është më i dobishëm se gjumi."

IKAMETI

Ikameti këndohet para faljes së namazeve farze. Ikameti është si ezani. I vetmi ndryshim është se pas pjesës '*hajje alel felah*", këndohet "*kad kameti salah'*.

NAMAZI

Namazi është kushti i dytë dhe më i rëndësishëm i fesë Islame pas fjalës së dëshmisë (shehadet) dhe falja e tij në pesë kohë të caktuara të ditës është farz për çdo mysliman, burrë apo grua. Namazi është një shtyllë e rëndësishme përsa i përket adhurimit. Madje atë mund ta

quajmë dhe thelbi i adhurimeve. Namazi është pretekst më i madh i të kujtuarit vazhdimisht të Allahut. Prandaj dhe në Kuranin fisnik thuhet: ***"Fal namaz për të më përkujtuar Mua."*** (Taha, 14).

Namazi i falur pesë herë në ditë luan një rol të rëndësishëm në sistemimin e jetës së besimtarit. Falja e vazhdueshme në kohë të caktuara e disiplinon atë nga ana shpirtërore dhe fizike, materiale dhe jomateriale.

Namazi është një urdhër i Allahut (xh.sh) për ne. Çdo fëmijë duhet të mësojë faljen e namazit kur mbush shtatë vjeç dhe duke filluar nga mosha 10 vjeçare duhet të vazhdojë faljen e namazit pa e lënë asnjëherë. Në një ditë ka pesë namaze farz. Këta janë: sabahu, dreka, ikindia, akshami dhe jacia. Çdo namaz ka kohën e caktuar dhe falet pasi të ketë hyrë koha e tij.

Namazet ndahen në farz, vaxhib dhe sunet.

Namazet farz

Janë namazet të cilat duhet të falen detyrimisht dhe nuk mund të lihen pa asnjë pretekst.

Namazet vaxhib

Shumica e dijetarëve myslimanë e kanë vlerësuar vaxhibin njësoj si farzin. Braktisja e vaxhibit edhe pse nuk mund të jetë në vlerën e braktisjes së farzit është gjynah dhe për të mbahet përgjegjësi.

Namazet sunet

Namazet sunet janë pjesa përveç farzit dhe vaxhibit, për braktisjen e të cilëve nuk mbahet përgjegjësi, por janë namaze që janë falur nga Profeti (a.s) dhe kur falen nga myslimanët i ndihmon ata të ndihen më afër tij.

KOHËT E NAMAZEVE

Tani le të mësojmë pak rreth pesë kohëve të namazit.

Namazi i sabahut: koha e namazit të sabahut fillon prej agimit e deri në lindjen e diellit. Me agim kuptojmë atë çast kur errësira fillon të venitet nga një dritë e hollë në horizont. Me shfaqjen e kësaj drite fillon dhe koha e namazit të sabahut. Namazi i sabahut përbëhet nga katër rekatë, dy sunet dhe dy farz.

Namazi i drekës: koha e namazit të drekës fillon kur dielli arrin pikën më të lartë dhe fillon të drejtohet nga perëndimi. Ky namaz ka 10 rekatë, katër sunet, katër farz dhe dy sunet të fundit.

Namazi i ikindisë: koha e namazit të ikindisë fillon atëherë kur mbaron koha e namazit të drekës dhe vazhdon deri në perëndim të diellit. Ka tetë rekatë, katër sunet dhe katër farz.

Namazi i akshamit: koha e namazit të akshamit fillon sapo perëndon dielli dhe përfundon kur zhduket krejtësisht drita. Ka pesë rekatë, tre farz dhe dy sunet.

Namazi i jacisë: koha e tij fillon kur errësohet plotësisht dhe vazhdon deri në agim. Ka dhjetë rekatë, katër sunet, katër farz dhe dy sunete të fundit.

Namazi i vitrit: është namaz vaxhib dhe falet pas namazit të jacisë. Ka tre rekatë.

KUSHTET E NAMAZIT

Për të falur namaz duhet të plotësojmë disa kushte. Disa prej tyre duhet të plotësohen para fillimit të namazit. Këta quhen ndryshe kushtet e jashtme të namazit dhe janë gjashtë:

1. Pastrimi nga papastërtia: personi i cili nuk ka abdes duhet të marrë abdes dhe ai cili është xhunub duhet të marrë gusul. Kjo lloj pastërtie ashtu siç ka dobitë e saj në pastrimin e trupit nga papastërtitë, ka njëherazi dobitë e saj edhe në pastrimin shpirtëror dhe bëhet me qëllimin për të kryer adhurimet.

Përveç rasteve të cilat prishin abdesin të cilat njihen si papastërti të vogla, rastet si *xhenabeti*, menstruacionet, lehonia dhe gjendje të cilat kërkojnë marrjen e gusulit njihen si papastërti të mëdha.

2. Pastrimi nga *nexhaseti*: do të thotë të pastrosh veshjen dhe vendin ku falesh nga gjëra të cilat njihen si të pista si urina apo gjaku i një njeriu, urina apo jashtëqitja e kafshëve si kali, delja etj. *Nexhaseti* (pisllëku) është dy llojesh:

a. Nexhaset i rëndë: është urina dhe jashtëqitja e njeriut, urina, jashtëqitja e kafshëve mishi i të cilave është i ndaluar, jashtëqitja e kafshëve si pula, pata dhe rosat, gjaku, meni, medhi, vedi, vjellja me gojë të plotë dhe pijet e tjera të ndaluara. Nëse nga papastërtitë e ngurta ka më shumë se 3,2 gram dhe nga ato të lëngshmet më shumë se shuplaka e dorës atëherë nuk mund të falet namaz.

b. Nexhaset i lehtë: konsiderohet urina e kalit, jashtëqitja e kafshëve shtëpiake dhe të atyre mishi i të cilave është i lejuar, jashtëqitja e zogjve mishi i të cilëve nuk hahet. Nëse këto papastërti përhapen në më shumë se në ¼ e rrobës, atëherë kjo përbën një pengesë për faljen e namazit.

3. Mbulimi i pjesëve të trupit (tek burrat mes kërthizës dhe gjurit, ndërsa gratë duhet të mbulojnë gjithë trupin përveç fytyrës, duarve dhe këmbëve).

4. Hyrja e kohës së namazit.

5. Drejtimi nga kibla.
6. Bërja e nijetit për namazin përkatës.

Kemi edhe kushtet e brendshme të namazit që ndryshe quhen shtyllat e namazit. Edhe këto janë gjashtë:

SHTYLLAT E NAMAZIT

1. *Tekbiri iftitah*: Tekbiri fillestar. Kur fillojmë namazin ngremë duart lart dhe themi *'Allahu ekber'*.

2. *Kijam*: qëndrimi në këmbë për sa kohë lexohen pjesë nga kurani për çdo rekat.

3. *Kiraat*: leximi i Kuranit. Në namaz Kurani lexohet në gjendjen e kijamit, pra kur qëndrojmë në këmbë. Në namaz duhet të lexohen e pakta tre ajete ose një ajet i gjatë.

4. *Ruku*: pas qëndrimit në këmbë përkulemi përpara duke vendosur duart në gjunjë. Përkuljen më të rregullt e ka praktikuar vetë I Dërguari i Allahut (s.a.s) duke mbajtur kokën drejt me shpinën në një nivel.

5. *Suxhud:* do të thotë rënia në tokë dhe vendosja e disa pjesëve të trupit në tokë. Sexhdeja më e rregullt është ajo që ka bërë vetë i Dërguari i Allahut (s.a.s), duke vendosur në tokë shtatë gjymtyrë: fytyrën, duart, gjunjët dhe gishtërinjtë e këmbëve.

6. *Ka'de Ahir*: do të thotë ulje e fundit, në fund të namazit ulemi dhe presim aq kohë sa të themi teshehudin. Tek namazet me dy rekatë ka vetëm një ulje të fundit.

Në uljen e fundit duhet të qëndrojmë aq kohë sa të lexohet *ettehijatu*. Përveç pjesëve të namazit ka dhe kushte të tjera që duhet të zbatohen. Këta quhen vaxhibet e namazit.

VAXHIBET E NAMAZIT

1. Fillimi i namazit duke thënë *'Allahu Ekber'*.
2. Leximi i sures Fatiha.
3. Leximi i një sure të dytë pas Fatihas në 2 rekatet e para të namazeve farz dhe në çdo rekat të namazeve vaxhib, sunet e nafile.
4. Vendosja e hundës bashkë me ballin në sexhde.
5. Leximi i *Ettehijatu* në uljen e parë dhe të fundit.
6. Dhënia e selamit në fund të namazit.
7. Respektimi i *ta'dili erkanit (kryerja e rregullt e shtyllave të namazit)* në namaz.

Sunetet plotësojnë vaxhibet dhe vlejnë për të shtuar sevapet. Zbatimi i suneteve shpreh dashurinë dhe lidhjen tonë me Profetin (s.a.s).

SUNETET E NAMAZIT

1. Këndimi i ezanit dhe i ikametit për pesë kohët e namazit dhe namazin e xhumasë.
2. Ngritja e duarve lart kur marrim tekbirin fillestar.
3. Leximi pa zë i *Subhanekes* dhe *Eudhu Bismilahit*.
4. Shqiptimi *Amin* në fund të Fatihas.
5. Mbajtja drejt e gjunjëve kur jemi në ruku.
6. Leximi pa zë i *Ettehijatut*.
7. Nëse falim namaz në një vend të hapur, atëherë duhet të vendosim *sutre* (pengesë) përpara.

MEKRUHET E NAMAZIT

Mekruh janë ato vepra të cilat nuk janë të pëlqyeshme të bëhen. Mekruhet e namazit janë këto:

1. Të falësh namaz në kushtet e shtrëngesës për të kryer nevojën.

2. Të luash në namaz me rrobat apo me ndonjë gjë tjetër.

3. Mbështetja diku gjatë namazit.

4. Të shtriqesh apo të hapësh gojën.

5. Kërcitja e gishtërinjve.

Këto gjëra nuk e prishin namazin por pakësojnë sevapin. Kemi dhe gjendje të tjera të cilat e prishin namazin.

RASTET QË PRISHIN NAMAZIN

1. Të folurit apo të qeshurit gjatë namazit.

2. Drejtimi i kraharorit në drejtim tjetër përveç kibles.


3. Nëse njeriu që falet merret me diçka tjetër gjatë namazit saqë të tjerët mendojnë se ai nuk po falet.

4. Zbulimi i vendeve të turpshme.


5. Ngrënia ose pirja e diçkaje.

SI FALET NAMAZI

Qëndrimi Në Namaz




Burrë



Grua

Zgjidhet një vend i pastër për t'u falur, drejtohet nga kibla dhe bëhet nijeti.


TEKBIRI FILLESTAR



Burrë

Duart ngrihen në lartësinë e veshëve. Shuplakat mbahen të hapura përballë kibles.


Grua



Duart ngrihen në lartësinë e shpatullave. Gishtërinjtë mbahen të bashkuar dhe të drejtuar drejt kibles.

Themi "Allahu Ekber" dhe fillojmë namazin duke lidhur duart.


KIJAM





Burrë

Sytë shikojnë vendin ku bëhet sexhdja. Duart lidhen mbi kërthizë. Dora e djathtë vendoset mbi të majtën.






Grua

Sytë shikojnë vendin ku bëhet sexhdja Duart lidhen dhe vendosen mbi kraharor. Dora e djathtë vendoset mbi të majtën.

Në kijam lexohet Fatiha dhe një sure.

Leximi në këmbë quhet *kiraat*.


RUKU



Burrë

Përkulim mirë trupin. Koka dhe shpina duhet të jenë në një nivel Duart përfshijnë kupat e gjunjëve.


Grua



Përkulim pak trupin. Gjunjët thyhen pak. Duart vendosen mbi gjunjë.


Në ruku shqiptojmë *'Subhane rabbijel adhim"* tre herë.

KAVME



Burrë


Grua



Ngrihemi nga rukuja duke thënë *'Semiallahu limen hamideh'*.

Në kavme thuhet *'Rabbena ue lekel hamd'*.

SEXHDE



Burrë

Balli dhe hunda prekin tokën. Duart mbahen afër fytyrës. Bërrylat janë pak të hapur. Thembrat mbahen të bashkuara.

Grua




Bërrylat vendosen në tokë dhe mbahen afër trupit. Gjunjtë mbahen ngjitur me barkun.

Sexhdja bëhet dy herë rresht.

Në sexhde themi *'Subhane rabbijel a'la"* tre herë.


ULJA (ETTEHIJJATU)



Burrë

Duart vendosen mbi gjunjë. Këmba e djathtë dhe gishtërinjtë mbahen të drejtuar kah kibla.

Grua




Duart vendosen mbi gjunjë. Këmbët shtrihen djathtas. Mbështetja bëhet mbi kofshë.

Në ulje lexohen lutjet "Ettehijjatu", "Allahumme sal'li - barik" dhe "Rabbena".

SELAMI



Burrë



Grua

Në fillim koka kthehet nga e djathta e pastaj majtas. Në të dyja rastet sytë shohin shpatullat.

Në selam thuhet *"es selamu alejkum ue rahmetullah"*.

TABELA E NAMAZEVE

Namazet e mëposhtëm falen në të njëjtën mënyrë:

* Suneti i namazit të sabahut - suneti i fundit i namazit të drekës - suneti i namazit të akshamit - suneti i fundit i namazi të jacisë

* suneti i namazit të ikindisë – suneti i parë të namazit të jacisë.

NAMAZI I SABAHUT

<table>
<tr><td></td><td>Rekati</td><td colspan="5">NAMAZI I SABAHUT
2 rekatë sunet, 2 rekatë farz</td></tr>
<tr><td rowspan="2">SUNETI</td><td>1</td><td>Subhaneke
Eudhu-Bismil’lah
Fatiha
Sure</td><td rowspan="2"></td><td rowspan="2">FARZI</td><td>1</td><td>Subhaneke
Eudhu-Bismil’lah
Fatiha
Sure</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Bismil’lah
Fatiha
Sure</td><td>2</td><td>Bismil’lah
Fatiha
Sure</td></tr>
<tr><td colspan="7">Në uljen e fundit lexohen duatë:
Ettehijjatu, Allahumme sal’li-barik, Rabbena.</td></tr>
</table>

Le të fillojmë nga mënyra sesi falet suneti i namazit të sabahut:

Dy rekatet sunet të sabahut:

Në fillim drejtohemi nga kibla dhe bëjmë nijetin "bëra nijet të fal sunetin e namazit të sabahut". Pas nijetit shqiptojmë tekbirin dhe fillojmë namazin.

Pasi lidhen duart lexojmë subhaneken. Pastaj *Eudhu-bismilahin*. Pas leximit të Fatihasë lexojmë një sure nga Kurani. Pastaj themi "*Allahu Ekber*" dhe biem në ruku. Pasi themi tri herë "*subhane rabbijel adhim*" në ruku drejtohemi. Gjatë drejtimit themi "*semiallahu limen hamideh"* dhe pasi drejtohemi "*rabbena ue lekel hamd"*. Pastaj biem në sexhde duke thënë "*Allahu ekber"*. Në sexhde themi tri herë "*subhane rabbijel a'la"*. Ngrihemi nga sexhdeja duke thënë "*Allahu ekber*" dhe ulemi. Pasi presim pak, biem përsëri në sexhde duke thënë "*Allahu ekber"*. Në sexhde shqiptojmë tri herë "s*ubhane rabbijel a'la*" dhe ngrihemi në këmbë duke thënë "*Allahu ekber'*. Në këtë mënyrë mbarojmë rekatin e parë. Në fillim të rekatit të dytë lidhim duart.

Pasi themi *bismil'lahin,* lexojmë Fatihanë dhe një sure, themi "*Allahu ekber"* dhe biem në ruku. Pasi themi tri herë "s*ubhane rabbijel adhim*" në ruku drejtohemi duke thënë "*semiallahu limen hamideh"*. Kur drejtohemi themi "r*abbena ue lekel hamd"*. Pastaj biem në sexhde duke thënë "*Allahu ekber*". Në sexhde themi tri herë "*subhane rabbijel a'la"*. Ngrihemi dhe themi "*Allahu ekber*", qëndrojmë pak ulur dhe biem përsëri në sexhde duke thënë *"Allahu ekber*". Në sexhde themi përsëri tri herë "*subhane rabbijel a'la*". Ngrihemi duke thënë *"Allahu ekber*" dhe ulemi në uljen e fundit. Në uljen e fundit lexojmë "*Ettehijjatun, Allahumme sal'li-barik, rabbena*". Në këtë mënyrë falim dy rekatë namaz. Në fillim kthejmë kokën nga ana e djathtë dhe japim selam duke thënë "*es selamu alejkum ue rahmetullah*". Në të njëjtën mënyrë japim selam dhe nga e majta. Kështu përfundon namazi.

Dy rekatet farz të namazit të sabahut:

Farzi i namazit të sabahut falet njëlloj si suneti i sabahut vetëm se para farzit burrat thërrasin ikametin.

Kohët e tjera të namazit falen kështu.

NAMAZI I DREKËS

	Rekati	NAMAZI I DREKËS **4** sunet **4** farz **2** sunet të fundit					
SUNETI I PARË	1	Subhaneke Eudhu-Bismil'lah Fatiha Sure	**FARZI**	Subhaneke Eudhu-Bismil'lah Fatiha Sure	**SUNETI FUNDIT**	1	Subhaneke Eudhu-Bismil'lah Fatiha Sure
	2	Bismil'lah Fatiha Sure Ettehijjatu		Bismil'lah Fatiha Sure Ettehijjatu			
	3	Bismil'lah Fatiha Sure		Bismil'lah Fatiha		2	Bismil'lah Fatiha Sure
	4	Bismil'lah Fatiha Sure		Bismil'lah Fatiha			
Në uljen e fundit lexohen duatë: *Ettehijjatu, Allahumme sal'li-barik, Rabbena.*							

Katër rekatet e parë sunet të drekës:

Dy rekatet e para falen njëlloj si dy rekatë sunet të namazit të sabahut. Në uljen e parë lexojmë vetëm

Ettehijjatun, ngrihemi në këmbë pa lexuar Subhaneken, lexojmë Bismilahin, fatihanë dhe një sure. Pastaj shkojmë në ruku, sexhde dhe kalojmë në rekatin e katërt i cili falet njëlloj si rekati i tretë. Në fund të rekatit të katërt ulemi dhe lexojmë *"Ettehijjatun, Allahumme sal'li-barik* dhe *Rabbena"*. Pastaj japim selam.

Katër rekatet farz të drekës:

Dy rekatet e para falen si namazi i sabahut. Në fund të rekatit të dytë ulemi dhe lexojmë Ettehijjatun. Ngrihemi në rekatin e tretë, lexojmë Bismilahin dhe fatihanë. Pas rukusë dhe sexhdeve ngrihemi në rekatin e katërt. Përsëri lexojmë Bismilahin dhe fatihanë, bëjmë rukunë dhe sexhdet dhe ulemi në uljen e fundit ku lexojmë *"Ettehijjatun, Allahumme sal'li-barik* dhe *Rabbena"*.

Dy rekatet e fundit sunet të drekës:

Falen njëlloj si suneti i namazit të sabahut.

NAMAZI I IQINDISË

		NAMAZI I IQINDISË **4** sunet **4** farz		
SUNETI	1	Subhaneke Eudhu-Bismil'lah Fatiha Sure	**FARZI**	Subhaneke Eudhu-Bismil'lah Fatiha Sure
	2	Bismil'lah Fatiha Sure Ettehijjatu		Bismil'lah Fatiha Sure Ettehijjatu
	3	Bismil'lah Fatiha Sure		Bismil'lah Fatiha
	4	Bismil'lah Fatiha Sure		Bismil'lah Fatiha
Në uljen e fundit lexohen duatë: *Ettehijjatu, Allahumme sal'li-barik, Rabbena.*				

Katër rekatet sunet të namazit të ikindisë:

Dy rekatet e para falen si namazi i sabahut. Në uljen e parë lexohen "*Ettehijjatu* dhe *Sal'li-Barik*" dhe ngrihemi në rekatin e tretë. Rekati i tretë fillon me leximin e Subhanekes dhe falet njëlloj si dy rekatet e para. Në fund japim selam.

Katër rekatet farz të namazit të ikindisë:

Falen njëlloj si farzi i namazit të drekës.

NAMAZI I AKSHAMIT

<table>
<tr><td></td><td></td><td colspan="4">NAMAZI I AKSHAMIT
3 rekate farz 2 rekate sunet</td></tr>
<tr><td rowspan="3">FARZI</td><td>1</td><td>Subhaneke
Eudhu-Bismil'lah
Fatiha
Sure</td><td rowspan="4">SUNETI</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>2</td><td>Bismil'lah
Fatiha
Sure
Ettehijjatu</td><td>1</td><td>Subhaneke
Eudhu-Bismil'lah
Fatiha
Sure</td></tr>
<tr><td>3</td><td>Bismil'lah
Fatiha</td><td>2</td><td>Bismil'lah
Fatiha
Sure</td></tr>
<tr><td colspan="6">Në uljen e fundit lexohen duatë:
Ettehijjatu, Allahumme sal'li-barik, Rabbena.</td></tr>
</table>

Tre rekatet farz të namazit të akshamit:

Falet njëlloj si farzi i drekës vetëm se pasi falet rekati i tretë ulemi në uljen e fundit dhe japim selam.

Dy rekatet sunet të namazit të akshamit:

Falet njëlloj si suneti i namazit të sabahut.

NAMAZI I JACISË

<table>
<tr><td colspan="2"></td><td colspan="5">NAMAZI I JACISË
4 rekatë sunet 4 rekatë farz 2 rekate sunet të fundit, vitri</td></tr>
<tr><td rowspan="4">SUNETI I PARË</td><td>1</td><td>Subhaneke
Eudhu-Bismil'lah
Fatiha
Sure</td><td rowspan="4">FARZI</td><td>Subhaneke
Eudhu-Bismil'lah
Fatiha
Sure</td><td rowspan="4">SUNETI FUNDIT</td><td rowspan="2">1</td><td rowspan="2">Subhaneke
Eudhu-Bismil'lah
Fatiha
Sure</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Bismil'lah
Fatiha
Sure
Ettehijjatu, Sal'li-Barik</td><td>Bismil'lah
Fatiha
Sure
Ettehijjatu</td></tr>
<tr><td>3</td><td>Subhaneke
Eudhu-Bismil'lah
Fatiha
Sure</td><td>Bismil'lah
Fatiha</td><td rowspan="2">2</td><td rowspan="2">Bismil'lah
Fatiha
Sure</td></tr>
<tr><td>4</td><td>Bismil'lah
Fatiha
Sure</td><td>Bismil'lah
Fatiha</td></tr>
<tr><td colspan="7">Në uljen e fundit lexohen duatë:
Ettehijjatu, Allahumme sal'li-barik, Rabbena.</td></tr>
</table>

Katër rekatet sunet të jacisë:

Falen në të njëjtën mënyrë si katër rekatet sunet të ikindisë.

Katër rekatet farz të jacisë:

Falen njëlloj si farzi i drekës.

Dy rekatet e fundit sunet të jacisë:

Falen njëlloj si suneti i namazit të sabahut.

NAMAZI I VITRIT

NAMAZI I VITRIT 3 rekate			
	1	2	3
VAVIP	Subhaneke Eudhu-Bismil'lah Fatiha Sure	Bismil'lah Fatiha Sure Ettehijjat	Bismil'lah Fatiha Sure Duaja e Kunutit
Në uljen e fundit lexohen duatë: *Ettehijjatu, Allahumme sal'li-barik, Rabbena*.			

Namazi i vitrit ka tre rekatë. Dy rekatet e para falen njëlloj si suneti i sabahut. Vetëm se në fund të rekatit të dytë lexohet vetëm Ettehijjatu dhe ngrihemi në rekatin e tretë. Shqiptojmë Bismil'lahin dhe lexojmë Fatihanë me një sure, pastaj ngrejë duart lart duke thënë "*Allahu Ekber*". Pasi marrim tekbir i lidhim përsëri duart dhe lexojmë duatë e kunutit. Pasi lexojmë duatë e kunutit biem në ruku, sexhde dhe në uljen e fundit. Në fund japim selam.

NAMAZI I XHUMASË

Përveç pesë kohëve namaz të detyruara, çdo mysliman mashkull është i obliguar të falë edhe namazin e xhumasë.

Namazi i xhumasë falet ditën e premte në kohën e

namazit të drekës dhe me xhemat. Ka dhjetë rekate, katër rekate sunet, dy rekate farz dhe katër rekat sunet të fundit.

Mënyra e faljes së xhumasë:

Katër rekatet e parë sunet të xhumasë:

Bëhet nijeti për faljen e namazit të xhumasë dhe falet njëlloj si suneti i parë i namazit të drekës.

Dy rekatet farz të xhumasë:

Para se të falen dy rekatet farz të namazit të xhumasë duhet të dëgjohet hutbeja. Pasi thërret ikameti, bëhet nijeti për faljen e farzit të xhumasë dhe lidhemi pas imamit. Pasi imami thërret tekbirin edhe xhemati e përsërit dhe lexon në heshtje vetëm Subhaneken. Nuk lexohet asgjë tjetër. Edhe në rekatin e dytë nuk lexohet asgjë. Biem në ruku, sexhde dhe ulemi në uljen e fundit për të lexuar duatë. Japim selam bashkë me imamin. Kështu përfundon falja e farzit të xhumasë.

Katër rekatet e fundit sunet të xhumasë:

Edhe këta falen njëlloj si suneti i parë i drekës.

NAMAZI I BAJRAMIT

Namazi i Bajramit falet dy herë në vit, në Bajramin e Ramazanit dhe atë të Kurbanit. Falja e namazit të Bajramit është vaxhib. Falet ditën e parë të Bajramit, në një afat të caktuar pas lindjes së diellit.

Namazi i Bajramit falet kështu:

Bëhet nijeti për të falur namazin e Bajramit, lidhemi pas imamit dhe fillojmë namazin duke thënë "*Allahu Ekber*". Lexojmë Subhaneken në heshtje. Imami merr tekbir duke ngritur duart tek veshët.

Edhe xhemati merr tekbir pas imamit dhe pastaj i lëshon duart poshtë. Herën e dytë marrim përsëri tekbir dhe i lëshojmë duart. Përsëri marrim tekbir për herë të tretë dhe pas tij i lidhim duart. Imami lexon Fatihanë dhe një sure. Biem në ruku dhe sexhde dhe pastaj ngrihemi në rekatin e dytë.

Në rekatin e dytë imami lexon Fatihanë dhe një sure. Pas leximit të tyre përsëri ashtu siç bëmë në rekatin e parë, marrim tre tekbire. Në tekbirin e katërt biem në ruku, pastaj në sexhde. Ulemi në uljen e fundit dhe japim selam.

Pas faljes së namazit të Bajramit dëgjojmë hutben.

Tekbiret e teshrikut

Gjatë Kurban Bajramit këndojmë tekbire pas çdo namazi farz duke filluar pas faljes së namazit të sabahut ditën e parë të Bajramit deri pas faljes së namazit të ikindisë në ditën e katërt. Këto quhen tekbire teshrikë dhe janë vaxhib.

"*Allahu ekber, Allahu ekber, la ilahe il'lallahu uallahu ekber, Allahu ekber ue lil'lahil hamd*"

NAMAZI I TERAVISË

Falet vetëm gjatë muajit të Ramazanit çdo ditë mes të namazit të jacisë dhe vitrit. Falja e namazit të teravisë në Ramazan është sunet. Pas teravisë falet namazi i vitrit. Namazi i teravisë ka njëzet rekatë. Mund të falet vetëm, ose me xhemat. Mund të japim selam pas dy ose katër rekateve. Më e mira është të japim selam pas çdo dy rekatësh. Kur veprojmë kështu sunetet me nga dy rekate falen njëlloj si suneti i namazit të sabahut. Nëse e falim me nga katër rekate atëherë falet si suneti i namazit të ikindisë.

NAMAZI I UDHËTARIT

Feja Islame ka sjellë shumë lehtësira për ata persona që udhëtojnë, pra që janë udhëtarë. Njëra nga këta është edhe namazi i udhëtarit.

Personi i cili kalon një largësi mbi 90 km nga vendi ku banon quhet udhëtar. Nëse ky njeri qëndron më pak se dy javë në vendin ku shkon, atëherë brenda kësaj kohe ai mund të falet duke shkurtuar namazet farz me nga katër rekatë në dy rekate. Sunetet nuk i shkurton por nëse ka mundësi mund t'i falë. Namazi i akshamit dhe i vitrit nuk shkurtohen dhe falen me nga tre rekate.

NAMAZI I XHENAZES

Namazi i xhenazes është një lutje për myslimanët që ndërrojnë jetë. Është detyra e fundit dhe një lloj detyrimi ndaj të vdekurit për faljen e mëkateve dhe të gabimeve.

Namazi i xhenazes është një adhurim i cili nëse praktikohet nga një pjesë e myslimanëve heq përgjegjësinë nga gjithë të tjerët që nuk mund ta falin. Nëse nuk e fal asnjë person, atëherë të gjithë myslimanët e atij vendi konsiderohen mëkatarë. Ky lloj adhurimi quhet *farz kifaje*.

SI FALET NAMAZI I XHENAZES?

Namazi i xhenazes falet me xhemat. I vdekuri pasi lahet, pastrohet, mbështillet me qefin dhe vendoset në vendin ku do të falet xhenazeja. Xhenazeja vendoset para xhematit. Imami që do të falë namazin e xhenazes qëndron afër të vdekurit. Xhemati qëndron pas imamit në këmbë i rreshtuar. Formimi i tre rreshtave është mustehab.

Namazi i xhenazes falet në këmbë duke marrë katër

tekbire. Nuk ka as ruku e as sexhde. Në fillim bëhet nijeti duke cilësuar në është burrë, grua, djalë ose vajzë e vogël. Merret tekbiri i parë bashkë me imamin, lidhen duart pastaj lexohet *Subhaneke* bashkë me pjesën "*ue xhel'le thenauk*". Pastaj merret tekbiri i dytë dhe lexohen duatë '*Allahumme sal'li-barik'*. Pastaj imami merr tekbirin e tretë dhe lexon një nga duatë e xhenazes të cilat i ka lexuar dhe vetë Profeti (a.s). Në rast mosnjohje të duave të xhenazes mund të lexohet duaja e kunutit ose '*Rabbena atina*', "*Rabbenagfirli*" ose mund të lexojë një ajet tjetër. Më pas imami merr tekbirin e katërt dhe pa lexuar asgjë jep selam një herë nga e djathta pastaj nga e majta.

Në tekbiret e tjera përveç të parit nuk ngrihen duart. Gjërat që prishin namazet e tjera prishin dhe namazin e xhenazes.

NAMAZET KAZA

Namazi i cili për shkak të harresës, gjumit apo ndonjë shkaku tjetër nuk falet në kohën e duhur por falet më vonë quhet kaza. Namazet duhet të falen në kohën e duhur. Por nëse nuk mund t'i falim, atëherë duhet t'i falim kaza.

Namazi kaza falet kështu:

Në fillim thirret ezani, ikameti dhe bëhet nijeti për atë namaz të cilin nuk kemi pasur mundësi ta falim në kohën e duhur dhe falim vetëm farzin e tij. Sunetet nuk bëhen kaza.

Nëse nuk kemi pasur mundësi të falim namazin e sabahut atëherë mund ta falim kaza atë pas lindjes së dielli, duke falur në fillim sunetin pastaj farzin.

NAMAZI ME XHEMAT

Namazet farze duhet të falen me xhemat, qoftë në

shtëpi, qoftë në xhami. Namazi i falur me xhemat ka 27 herë më shumë sevape se namazi i falur vetëm.

Namazi me xhemat falet kështu:

Imami qëndron pak para xhematit. Ndërkohë që imami lexon Fatihan dhe një sure, xhemati vetëm dëgjon, ndërsa duatë lexohen nga të gjithë.

Personi i cili lidhet pas imamit në rekatin e parë lexon vetëm Subhaneken. Imami mund të lexojë me zë ose pa zë në varësi të namazit. Ai që falet pas tij lexon duatë në ruku dhe sexhde.

Për të falur namaz me xhemat mjaftojnë dy persona. Njëri bëhet imam dhe tjetri falet pas tij. Pas imamit mund të falet një fëmijë i moshës së rritur ose një grua dhe namazi që falin konsiderohet namaz me xhemat. Në një namaz të falur me xhemat nëse njëri mund të vonohet, atëherë duhet të lidhet menjëherë me imamin kur të vijë. Kur imami jep selam, ai ngrihet në këmbë dhe fal rekatet që nuk i ka arritur.

Personi i cili arrin imamin para rukusë apo në ruku konsiderohet se e ka arritur rekatin. Ai që lidhet pas imamit nuk merr tekbir para imamit, nuk shkon në ruku dhe në sexhde para tij.

Si e plotëson namazin ai i cili e arrin imamin në rekatin e dytë apo në rekatet e tjera?

Personi që e arrin imamin në rekatin e parë ashtu siç e përmendëm më lart (në ruku apo para saj) vazhdon të falë namazin bashkë me imamin. Ata që e arrijnë imamin në rekatet e tjera falen kështu:

Nëse e arrin në rekatin e dytë: bën nijetin, merr tekbir dhe lidhet me imamin. Në uljen e fundit pasi lexon

Ettehijjatun pret që imami të japë selam. Kur imami jep selam nga ana e djathtë, ai ngrihet në këmbë duke thënë *Allahu ekber* dhe fal rekatin e paarritur. Lexon *Subhaneken*, *Eudhu-Bismilahin*, *Fatihan* dhe një sure. Pastaj bie në ruku dhe sexhde. Në fund ulet dhe lexon *Ettehijjatu*, *Allahumme sal'li-barik* dhe *Rabbena*. Pastaj e mbaron namazin duke dhënë selam në të dyja anët.

Nëse e arrin në rekatin e tretë të një namazi me katër rekatë: në uljen e fundit lexon *Ettehijjatun* dhe pret selamin e imamit. Kur imami jep selam nga ana e djathtë ngrihet në këmbë duke thënë *Allahu ekber* dhe dy rekatet e paarritur i fal në këtë mënyrë:

Në fillim lexon *Subhaneken*, *Eudhu-Bismilahin*, *Fatihan* dhe një sure, bie në ruku dhe sexhde, pastaj ngrihet përsëri në këmbë. Lexon *Bismilahin*, *Fatihan* dhe një sure, kryen rukunë dhe sexhden dhe ulet në uljen e fundit. Aty lexon *Ettehijjatun*, *Allahumme sal'li-barik* dhe *Rabbena*. Jep selam dhe kështu plotëson pjesën e rekateve të paarritura.

Nëse arrin në rekatin e tretë të namazit të akshamit apo të vitrit: e përfundon namazin bashkë me imamin, lexon vetëm *Ettehijjatun* në uljen e fundit dhe pret selamin e imamit. Ngrihet në këmbë duke thënë *Allahu ekber* dhe lexon *Subhaneken, Eudhu-Bismilahin, Fatihan*, një sure. Më pas bie në ruku dhe sexhde. Ulet dhe lexon vetëm *Ettehijjatun*. Pastaj ngrihet në këmbë duke thënë *Allahu Ekber* dhe lexon *Bismilahin, Fatihan* dhe një sure, ulet në ruku dhe sexhde dhe në fund në uljen e fundit. Aty lexon *Ettehijjatun*, *Allahumme sal'li-barik, Rabbena*. Jep selam dhe e përfundon namazin.

Personi që arrin imamin në rekatin e katërt: Nëse arrin imamin në rekatin e katërt të një namazi me katër rekate atëherë falet bashkë me të, ulet në uljen e fundit dhe duke lexuar vetëm *Ettehijjatun* pret selamin e imamit. Pasi imami jep selam nga ana e djathtë ai ngrihet në këmbë duke

thënë *Allahu ekber*, lexon *Subhaneken*, *Eudhu-Bismilahin*, *Fatihan*, një sure. Ulet në ruku dhe sexhde dhe këtu lexon vetëm *Ettehijjatun*. Pastaj ngrihet përsëri në këmbë duke thënë *Allahu Ekber*, lexon *Bismilahin*, *Fatihan*, një sure, bie në ruku dhe sexhde dhe ngrihet sërish në këmbë. Lexon vetëm *Bismilahin* dhe *Fatihan*, kryen rukunë dhe sexhden dhe ulet në uljen e fundit ku lexon *Ettehijjatun*, *Allahumme salli-barik* dhe *Rabbena*. Jep selam në të dy anët dhe përfundon namazin.

Nëse personi e arrin imamin pas rukusë së rekatit të fundit, pasi imami jep selam ngrihet në këmbë duke thënë *Allahu Ekber* dhe e fal namazin prej fillimit deri në fund.

SEHVI SEXHDJA

Sehvi sexhde do të thotë sexhdja e gabimit. Nëse një person gjatë namazit lë vaxhibet apo vonon vaxhibet ose farzet e namazit, atëherë duhet të bëjë sehvi sexhde.

Në uljen e fundit të namazit lexohet vetëm , jepet selam nga e djathta pastaj bie në sexhde dy herë. Pas sexhdeve ulet përsëri. Lexohet *Ettehijjatu, Allahumme salli-barik, Rabbena* dhe jepet selam.

SEXHDJA E TILAVETIT

Në Kuran ka disa ajete të cilat kur lexohen apo kur dëgjohen, lexuesi apo dëgjuesi e ka vaxhib bërjen e sexhdes. Në Kuran ka 14 vende ku duhet të bëhet sexhde.

Sexhdja e tilavetit bëhet kështu:

Duke bërë nijetin për sexhden e tilvetit thuhet *Allahu ekber* pa i ngritur duart dhe shkohet në sexhde. Në sexhde

thuhet tri herë *"Subhane rabbijel a'la"*. Pastaj ngrihet duke thënë *Allahu ekber*. Pas ngritjes në këmbë, është mustehab të lexohet ajeti *"Gufraneke rabbena ue ilejkel masir"*.

DISA NAMAZE NAFILE

Përveç namazeve sunet të pesë kohëve ka dhe namaze të tjera. Këto quhen namaze nafile. Janë namaze mustehab dhe mendub. Falja e këtyre namazeve është shumë e rëndësishme për forcimin e lidhjes me Allahun dhe dashurisë për Profetin. Gjithashtu këto namaze mbartin me vete shumë sevape. Në një hadith kudsi, Allahu i Madhëruar thotë: *"Robi shpëton nga dënimi im kur fal farzet ndërsa kur fal sunetet më afrohet më shumë."*

NAMAZI EVVABIN

Është një namaz i cili falet mes akshamit dhe jacisë. Namazi evvabin do të thotë namazi i atyre që pendohen dhe i mbështeten Allahut. Një namaz i përbërë nga gjashtë rekate ashtu siç mund të falet me një selam mund të falet dhe dy nga dy, me tre selame. Profeti (a.s) thotë: *"Ai që fal gjashtë rekate pas namazit të akshamit pa folur ndërkohë fjalë të këqija, ky adhurim është i barabartë për të me dhjetë vjet adhurim."*

NAMAZI I DUHASË

Namazi i duhasë, ndryshe i paradites, është një namaz mustehab i cili mund të falet duke filluar 45-50min pas lindjes së diellit deri kur dielli arrin pikën më të lartë. Mund të jetë dy, katër, tetë ose dymbëdhjetë rekatësh. Më e mira është të falim tetë rekatë. Nga Profeti (a.s) transmetohet se ai person i cili fal dymbëdhjetë rekate në

kohën e duhasë, lajmërohet se Allahu do t'i ndërtojë një shtëpi në xhenet.

NAMAZI TEHEXHUD (NATËS)

Namazi tehexhud është një namaz i cili falet pasi kemi fjetur pak deri para agimit (imsakut). Është një nga namazet që Profeti (a.s) nuk e ka lënë kurrë. Profeti ynë (s.a.s) pasi falte jacinë binte të flinte pa falur vitrin, ngrihej nga mesi i natës dhe pasi falte namazin tehexhud falte dhe vitrin dhe më vonë kur hynte koha e sabahut falte sunetin e sabahut. Nata e cila kalon me tehexhud është si një projektor që ndriçon jetën tjetër. Gjithashtu, gjallërimi i shpirtrave është i lidhur me gjallërimin e netëve.

NAMAZI TESBIH

Namazi tesbih është namazi më i madh i pendimit, faljes dhe bëhet me gjithë trupin. Profeti (s.a.s) duke dashur t'i dhurojë diçka xhaxhait të tij, Abasit, e ka këshilluar të falë këtë namaz. *"Dëgjo xhaxha, a do të mësosh diçka nga e cila të kesh dhjetë dobi, nëse e bën këtë Allahu të të falë dhjetë lloje mëkatesh, të parin apo të fundit, të ri apo të vjetër, të vogël apo të madh, të bërë me dëshirë apo pa dëshirë, fshehtazi apo haptazi".*

Namazi tesbih është një namaz i përbërë nga katër rekate. Në çdo rekat lexohet 75 herë "*Subhanallahi uel hamdu lil'lahi ue la ilahe il'lallahu uallahu ekber'*.

Në rekatin e parë pas *Subhanekes* dhe në rekatin e dytë para *Fatihas* lexohet 15 herë.

Pas leximit të sures pas *Fatihas* lexohet 10 herë.

Në ruku pasi themi tri herë "*Subhane rabbijel adhim"*, lexohet 10 herë.

Kur ngrihemi nga rukuja 10 herë.

Në sexhden e parë pasi themi tri herë "*Subhane rabbijel a'la*"e lexojmë 10 herë.

Kur ngrihemi nga sexhdja 10 herë.

Herën e dytë kur biem në sexhde e lexojmë 10 herë pasi themi tri herë "*Subhane rabbijel a'la"*.

Në këtë mënyrë në çdo rekat lexohet 75 herë fjalia *'Subhanallahi...'*. Në fund të rekatit të dytë japim selam por mund edhe të ngrihemi në rekatin e tretë dhe ta falim me një selam. Rekati i tretë dhe i katërt falen njëlloj si rekati i parë dhe i dytë. Kështu në katër rekate lexojmë 300 herë fjalinë e tesbihit.

Këtë namaz duhet ta falim të paktën një herë në jetë. Ata të cilët nuk dinë si ta falin, mund ta falin atë me xhemat. Imami duhet të lexojë me zë tesbihet në çdo vend. Ndërsa xhemati dëgjon.

TAHIJJETUL MESXHID

Është namazi nafile prej dy rekatesh që falet kur hyn për herë të parë në një xhami. *Tahijjetul mesxhid* do të thotë përshëndetja e xhamisë, respektimi i saj, por në të vërtetë vjen në kuptimin e respektit dhe nderimit ndaj Allahut (xh.sh). Prandaj dhe Profeti ynë (s.a.s) na ka urdhëruar duke thënë: *"Nëse ndonjëri prej jush hyn në xhami, në fillim le të falë dy rekate namaz."*

NAMAZI I NEVOJËS (HAXHET)

Ai njeri i cili ka ndonjë shqetësim, problem apo hall, merr abdes dhe fal dy rekatë namaz, pastaj lutet kështu:

'O Allah të lutem Ty dhe kërkoj prej Teje, të drejtohem

Ty me ndihmën e të Dërguarit Tënd, Muhamedit (a.s). O Allah të drejtohem Ty për të më shpëtuar nga ky shqetësim. Bëj të mundur dhe shefaatin e Profetit tonë."

Namazi i haxhetit mund të falet me katër ose me 12 rekate. Nëse falet me katër rekate, në rekatin e parë pas *Fatihas* lexohet *Ajetul Kursi*, ndërsa në tre rekatet e tjera pas Fatihas lexohen suret *Ihlas, Felek* dhe *Nas*. Ai person që e fal këtë namaz bën lutjen pas namazit dhe ia transmeton dëshirën Zotit të gjithësisë.

NAMAZI ISTIHARE

Istihare do të thotë "të kërkosh më të mirën, më të vlefshmen". Kur njerëzit duan të vendosin apo të zgjedhin rreth diçkaje, ndonjëherë për shkak të mundësive të munguara që u janë dhënë në dorë, ndonjëherë aplikojnë rrugë të ndryshme për të kuptuar se cila zgjedhje është më e mirë për ta në këtë jetë dhe për jetën tjetër. P.sh., në kohën kur Profetit kishte filluar t'i zbriste shpallja, arabët shihnin fall para se të udhëtonin për të parë se çfarë gjëje të dobishme apo të padobishme mund t'i sillte ai udhëtim. Profeti (s.a.s) e ka hequr atë zakon dhe në vend të tij ka sjellë namazin e istihares duke na urdhëruar: "Kur ndonjëri prej jush bën nijet të bëjë diçka, atëherë le të falë dy rekate namaz jashtë namaze farz dhe të lutet kështu:

"O Allah, duke u mbështetur tek dituria Jote, kërkoj të më japësh më të mirën dhe të më japësh forcë. Të lutem, më mëshiro me begatinë Tënde! Unë nuk e di, por Ti e di, unë nuk kam fuqi ndërsa Ti je i Plotfuqishëm. O Allah! Nëse puna që do të bëj do të jetë e hajrit për fenë, jetën dhe të ardhmen time, të lutem caktoje dhe ma lehtëso, më dhuro begati! Nëse është e dëmshme dhe e padobishme për fenë, jetën dhe të ardhmen time, largoje nga unë! Më jep më të mirën dhe më fal lumturi." Pas kësaj personi lutjeje shpreh dëshirën e vet.

Nëse lutja bëhet në mënyrë të sinqertë, atëherë lind shpresa për gjënë e mirë dhe zemra rilind bashkë me shpresën. Nëse njeriu në fund të istihares ndjen një lehtësim dhe qetësi, atëherë kjo interpretohet se do të jetë diçka e mirë, por nëse ndjen shqetësim dhe nuk është i qetë, interpretohet se nuk është diçka e dobishme për të. Allahu (xh.sh) u jep një shenjë atyre të cilët e falin namazin e istihares në qetësi dhe më pas bien të flenë. Nëse nuk arrin ndonjë rezultat në herën e parë, atëherë përsëritet tri deri në shtatë herë. Lutja mund të lexohet në gjuhën arabe por mund të lexohet dhe përkthimi i saj në gjuhën e lutësit.

FALJA E DY NAMAZEVE NË NJË KOHË (XHEM)

Sipas medhhebit hanefi bashkimi i dy namazeve mund të bëhet vetëm gjatë kohës së haxhit në Arafat dhe Muzdelife. Në Arafat falen dreka bashkë me ikindinë në kohën e drekës dhe në Muzdelife falen akshami bashkë me jacinë në kohën e jacisë. Në medhhebin Hanefi bashkimi i namazeve ndodh vetëm në këto dy raste.

Namazi i sabahut nuk mund të bashkohet me ndonjë namaz tjetër. Bashkimi mund të ndodhë mes namazeve të drekës dhe të ikindisë, si dhe mes akshamit dhe jacisë. P.sh., nëse duam të bashkojmë drekën me ikindinë, duhet të bëjmë nijetin përpara kur fillojmë të falim drekën. Ndërsa në bashkimin e vonuar (xhemi tehir) nijeti duhet të bëhet brenda kohës së namazit të parë. Përkundrazi namazi quhet i vonuar, gjë që është e ndaluar.

Duke u nisur nga mundësitë, njerëzit që nuk mund të falin namaz në kohën e caktuar, mund t'i bashkojnë namazet, kështu të paktën do të shpëtojnë nga mëkati i mosfaljes së namazit dhe do të kryejnë obligimin që i takon para Allahut.

Në bashkimin e shpejtuar (xhemi takdim) duhet të kontrollojmë radhën. Në fillim falet farzi i drekës pastaj ai i ikindisë. Sunetet ndërmjet nuk falen. Në bashkimin e namazit të akshamit me të jacisë, namazi i vitrit falet pas namazit të jacisë.

Nëse jemi në avion dhe kemi mundësi ta falim namazin në këmbë, le ta falim në këmbë; nëse nuk kemi mundësi të falim namaz, atëherë mund t'i bashkojmë namazet para ose pas zbritjes së avionit.

NJERIU QË FAL NAMAZ

• Mbrohet nga çdo lloj vepre e shëmtuar.

• Duke përmendur disa herë madhështinë e Allahut forcon lidhjen me Të.

• Kujton përherë Allahun dhe në çdo vepër përpiqet të fitojë kënaqësinë e Tij.

• Kujdeset për pastërtinë duke marrë abdes dhe kështu fiton shprehi të mira. Gjithashtu abdesi është dhe një mbështetje shpirtërore për të.

• Duke falur namaz në kohë të caktuara mëson të planifikojë kohën.

• Përjeton lumturinë e lidhjes me Allahun në kohë të caktuara mes të shqetësimeve dhe problemeve të përditshme.

• I përgjigjet thirrjes së Allahut **"O ju që besuat! Kërkoni ndihmë nga Allahu me namaz dhe durim. Pa dyshim që Allahu është me durimtarët."** (Bekare, 153), duke fituar forcë dhe besim në vetvete përballë vështirësive.

• Namazet që fal ia qetësojnë shpirtin dhe ia shtojnë dritën e zemrës.

Ka rastin t'i shprehë Allahut të gjitha falënderimet, lavdet dhe mirënjohjen me anë të trupit, mendjes, gjuhës, shpirtit, kohës dhe vendit.

DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME NAMAZIN

Cila është më e përshtatshme të bësh nijetin në gjuhën arabe apo në shqip?

Nijeti për namaz nuk është kusht që të bëhet me gojë. Vendi i nijetit është zemra. Nijet do të thotë qëllimi që ka zemra. Dijetarët e medhhebit hanefi e kanë parë si mustehab që nijetin e bërë me zemër ta transmetojmë dhe me gojë. Ndërsa Imam Rabbani thotë: "Në një kohë ku mbizotëron gabimi, nijeti nuk duhet të bëhet me gojë. Shqiptimi me gojë duhet të braktiset. Sepse kur gjuha e shqipton atë zemra mund të braktisë qëllimin e vërtetë."

Duke u nisur nga kjo, kur e shqiptojmë nijetin me gojë duhet të bëjmë marrëveshje dhe me zemrën e cila duhet të jetë e vetëdijshme deri në fund të namazit për qëllimin dhe t'i qëndrojë besnik atij. Nuk ka ndonjë ndalesë nëse nijeti bëhet në gjuhën arabe apo shqip.

Kur falim namaz dhe qëndrojmë në këmbë, sa duhet të jetë hapësira mes këmbëve?

Hapësira mes këmbëve mund të jetë katër gishtërinj ose sa gjerësia e shpatullave, kjo nuk është as vaxhib, as mubah, as mekruh dhe as haram përsa i përket veprave të të obliguarit. Kjo është një çështje jashtë farzit, sunetit dhe vaxhibit të namazit.

Në disa ilmihale ka të dhëna se hapësira mes këmbëve duhet të jetë katër gishtërinj. Por në asnjë libër të fikhut nuk është e mundur të gjesh diçka të tillë. Përkundrazi, në librat e hadithit në kapitujt e "rregullimit të safeve", shpjegohet për vendosjen e këpucëve mes të këmbëve

gjatë faljes së namazit, për bashkimin e pjesëve të jashtme ose të thembrave kur rreshtohemi për të formuar safet dhe tregohet për formimin e kallos nga bashkimi i thembrave.

Prandaj koncepti i katër gishtërinjve lind nga një burim etik. Njerëzit edhe këtu përdorin matje të cilat i përdorin në marrëdhëniet e përditshme dhe gabohen duke i përdorur ato në lidhjen me Allahun. Profeti (s.a.s) urdhëron: *"Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur."* Qëndrimi që duhet të mbajmë ndaj lidhjes me Allahun nuk duhet të bazohet tek konceptet e shekullit, por në konceptet e transmetuara nga Profeti (a.s).

Përveç kësaj, nuk ka asnjë kuptim të debatojmë rreth çështjeve që kanë lidhje me hollësirat. Një njeri i cili nuk e zbaton masën e hapësirës mes këmbëve -qoftë edhe sunet-do të thotë që ka lënë një sunet dhe mban përgjegjësi për të. Por njerëzit të cilët flasin gjatë gjithë kohës duke bërë komente rreth kësaj çështjeje, bëjnë thashetheme gjë e cila është e ndaluar.

Çfarë duhet të bëjë personi i cili ka namaze të pafalura?

Namazi zë një vend shumë të rëndësishëm në jetën e myslimanit. Në Kuran ka shumë ajete të cilat flasin për namazin. Namazi është pranuar si shtylla e fesë jo vetëm për periudhën e Profetit, por për të gjitha kohërat. Profeti ynë (s.a.s) e ka pranuar atë në ndarjen e rrugëve të besimit dhe kufrit dhe ka thënë: *"Ajo gjë që e ndan njeriun me shirkun dhe kufrin është braktisja e namazit."* Namazi për myslimanin është një adhurim i pazëvendësueshëm. Kemi aq shumë ajete dhe hadithe rreth namazit, por meqë pyetja ka lidhje me një çështje tjetër po kalojmë menjëherë aty.

Të vijmë te pyetja, një person nuk ka falur namaz deri në moshën 30vjeçare. Në moshën 30 vjeçare gjen vetveten,

përfshihet në një atmosferë të pastër të adhurimit dhe fillon të marrë frymë krejt i qetë. Çfarë do bëhet me namazet që nuk ka falur deri atë ditë? Nëse pranojmë si moshë pjekurie moshën 15 vjeç atëherë ky person ka 15 vjet namaze kaza.

Në shoqërinë tonë ka shumë shembuj të tillë. Kjo na gëzon nga njëra anë sepse njerëzit pas një farë kohe shohin shpëtimin tek feja dhe e ndiejnë të nevojshme të kthehen. Por nga ana tjetër është hidhërimi i qëndrimit larg ndjenjave fetare për një kohë kaq të gjatë.

Sidoqoftë, kthimi në të vërtetën është bërë tashmë dhe nëse ekziston edhe mendimi i kompensimit të adhurimeve të paplotësuara atëherë duhet t'ju kujtojmë diçka: Në fillim duhet të përcaktohet sa namaze kaza ka ai person. Kjo përcaktohet duke filluar nga mosha e pubertetit deri në moshën kur është kthyer në fenë e vërtetë. Ta zëmë se kjo periudhë është njëzet vjet. Në këtë mënyrë personi njëzet vitet e ardhshme duhet të falë çdo ditë nga një namaz plus për çdo kohë namazi, përveç namazeve të ditës. Nuk është e thënë të bëhet medoemos diçka e tillë. Njeriu mund të bëjë kaza më shumë namaze një herë në ditë. E rëndësishme është vazhdimësia e adhurimeve. Duhet të përcaktohet një shifër periodike në mënyrë që të mos mërzitet. Madje njeriu në vend të namazeve evvabin, duha mund të falë namazet e mbetura kaza.

A mund të falen namazet kaza në vend të namazeve sunet?

Përsa i përket faljes së namazeve kaza në vend të namazeve sunet ka dy mendime. Imam Shafiu nuk e sheh të drejtë që një person i cili ka namaze kaza për të falur të falë nafile, duke lejuar faljen e namazeve kaza në vend të suneteve. Ndërsa Ebu Hanife thotë që sunetet kanë vendin e tyre dhe duhet të falen të ndara, namazet kaza

veç e sunetet veç. Nëse mendojmë pak, nuk është e drejtë që një njeri të sakrifikojë sunetet për namazet kaza. Sepse në botën tjetër kur të hapen librat, ka transmetime për dhënie llogarie në lidhje me faljen e mangët të namazeve (pa sunete, vetëm me farze). Vetëm nëse personi ka 30-40 vjet namaze kaza për të plotësuar, atëherë mund të veprojë sipas mendimit të imam Shafiut.

Nëse një person vdes pa i plotësuar namazet kaza, atëherë shpresohet nga Allahu që ta falë. Nëse kujtojmë rastin e treguar në hadithe të njeriut i cili kishte vrarë njëqind njerëz, Allahu do ta falë njeriun duke parë ndjenjën e sinqertë të besimit dhe veprimin e tij sipas urdhëresave dhe ndalesave të Allahu. Sigurisht që kjo gjë i takon Allahut, askush s'mund të ndërhyjë. Ajo që na takon ne është vlerësimi i rasteve të dhëna për të falur namazet kaza dhe mbarimi i tyre. Nëse nuk arrijmë t'i mbarojmë, atëherë i lutemi Allahut kështu: *"O Allah kaq munda të bëj pasi kuptova të vërtetën. Ti e di që nëse do të kisha mundësi, të më jepej dhe pak kohë, do t'i kisha plotësuar të gjitha."* Le të shpresojmë që edhe Allahu të na pranojë me kaq sa kemi bërë në mëshirën e Tij të pafund.

Çfarë moshe duhet të marrim për bazë për përcaktimin e namazeve kaza?

Namazi është një obligim që fillon kur njeriu hyn në moshën e pjekurisë. Kjo moshë tek femrat fillon me ardhjen e menstruacioneve dhe tek meshkujt fillon me derdhjen e spermës. Prandaj një person i cili pranon vonë Islamin, i cili nuk ka falur namaz gjatë jetës së tij për të përcaktuar numrin e namazeve kaza duhet të marrë për bazë moshën e pjekurisë. Në qoftë se nuk e mban mend atëherë mund të merren për bazë moshat e përcaktuara nga dijetarët në periudhën e Omer ibn Abdulazizit: për meshkujt mosha 15 vjeç ndërsa për femrat 11.

Duhet të sqarojmë dhe një çështje tjetër. Gjëja më kryesore e adhurimeve është kujdesi. Në një vend si i yni, ku përjetohen të katër stinët, mosha e pjekurisë mund të jetë më e madhe se ajo e vendeve të nxehta. Ndaj duhet të tregohemi të kujdesshëm dhe të përcaktojmë saktësisht moshën e pjekurisë. Duke u bazuar tek kjo moshë duhet të plotësojmë të gjitha namazet e pafalura.

A mund të falim namaz hipur në mjete transporti si avioni, treni apo autobusi?

Namazi është një adhurim shumë i rëndësishëm për besimtarin. Prandaj besimtari do ta kryeje atë adhurim në mënyrën e duhur kudo që të jetë. Sepse lënia e tij për kaza është një mëkat i madh.

E dimë që namazi ka dymbëdhjetë farze, gjashtë të jashtme dhe gjashtë të brendshme. Nëse i braktisim këto dymbëdhjetë farze, do të thotë që namazi humb vlefshmërinë. Por nëse ne mund t'i plotësojmë këto farze në mjetet e transportit si avioni, treni apo autobusi atëherë ai namaz pranohet. Por nëse nuk plotësohen disa nga këto farze, duhet shikuar nëse kjo mund të hyjë në kornizën e detyrimit, e në këtë pikë duhet vlerësuar situata.

P.sh., kur jemi në autobus gjatë faljes së namazit nuk zbatohen tre farze të rëndësishme si kibleja, kijami dhe sexhdja. Por këta zbatohen dhe me lëvizje të menduara.. Kjo është një gjendje e lidhur me realizimin e detyrimit në bazë të aludimit. Këtu nuk duam të themi që në autobus nuk mund të falemi. Sepse besimtari duhet ta falë namazin kudo që të jetë. Nëse i ka vlerësuar të gjitha mundësitë dhe përsëri nuk i ka plotësuar kushtet, atëherë duhet ta falë me lëvizje.

Në tren është e mundur të gjesh kiblen, të qëndrosh në këmbë dhe të bësh sexhde. Ndërsa në avion kibleja mund të gjendet me busull. Në anije nuk ka ndonjë pengesë.

Këto janë disa aspekte që i përkasin fushës së fikhut në lidhje me çështjen. Duhet të theksojmë dhe një pikë shumë të rëndësishme:

Ata persona që duan të udhëtojnë me autobus le t'i rregullojnë oraret në bazë të kohëve të namazit. P.sh., një njeri i cili fal namazin e akshamit dhe niset për rrugë, namazin e jacisë mund ta falë në çfarëdo ndalese që mund të ketë autobusi. Edhe autobusët vetë ndalën çdo dy-tre orë për të pushuar, prandaj për një person i cili e llogarit kohën e namazit, nuk paraqitet ndonjë problem. Kështu nuk do të përjetojë as shqetësimin e gjetjes së një mjeti transporti tjetër përveç autobusit.

Çfarë do të thotë ta'dili erkan në namaz?

Ta'dili erkan do të thotë zbatimi me përpikëri i rregullave të namazit. Nëse pjesët e namazit zbatohen me përpikëri, do të thotë që edhe si formë edhe si përmbajtje janë të rregullta. Kështu njeriu nuk e fal namazin sa për të kaluar radhën, por me një përkushtim dinjitoz.

Ta'dili erkan në namaz do të thotë zbatimi i rukusë, i sexhdes, i kijamit, e pjesëve të tjera ashtu siç duhet, pa shpejtuar a nxituar. P.sh., kur ngrihemi nga rukuja trupi duhet të qëndrojë drejt, në këmbë duhet të qëndrojmë të paktën sa të themi një herë '*subhane rabbijel adhim*" pastaj mund të biem në sexhde. Edhe mes dy sexhdeve duhet të qëndrojmë pak aq sa të përmendim një herë Allahun. Përndryshe nëse nuk drejtohemi kur ngrihemi nga rukuja dhe biem menjëherë në sexhde, nëse nuk qëndrojmë pak mes dy sexhdeve, atëherë kjo bie ndesh me *ta'dili erkanin*.

Sipas imam Ebu Jusufit, *ta'dili erkan* është farz. Ndërsa sipas imam Ebu Hanifes dhe imam Muhamedit është vaxhib. Sipas mendimit të parë nëse nuk zbatohet *ta'dili*

erkan në namaz, atëherë namazi duhet të falet përsëri, ndërsa sipas mendimit të dytë nëse lihet, atëherë duhet të bëjmë *sehvi sexhde*. Por më e mira është që një namaz të tillë ta falim dhe një herë. Kështu njeriu shpëton nga dyshimet.

Këtu duam të theksojmë diçka të rëndësishme: përveç zbatimit me përpikëri të rregullave të aspektit të jashtëm të namazit, një përpikëri nevojitet edhe në aspektin e brendshëm të namazit, që ndryshe e quajmë përulje dhe dorëzim. Përulja dhe dorëzimi e lidhin çështjen me shpirtin e namazit. Shpirti është më i rëndësishmi në lidhjen e njeriut me Allahun. Por ajo ç'ka mbart njeriu në shpirt pasqyrohet në fjalët, veprimet dhe sjelljet e tij. Prandaj duhet të tregohemi të kujdesshëm përsa i përket veprimeve dhe fjalëve. Ata duhet të transmetojnë të vërtetën e brendshme. Për këtë arsye nuk mund të themi që lëvizjet dhe veprimet nuk kanë kuptim. Por ç'të bësh që ka namaz i cili nuk i ngjason namazit, ka agjërim i cili nuk i ngjason agjërimit. Prandaj Allahu urdhëron në Kuran: **"Janë të shpëtuar besimtarët. Ata *që janë të përulur* në namaz."** (Muminun 23/1-2) Nuk thuhet "Ata që falen", por përdoret një shprehje e cila pasqyron qëndrueshmëri dhe vazhdimësi. Do të thotë se ato që e falin namazin me përulje, përqendrohen dhe e ndiejnë qetësinë dhe freskinë e tij në çdo çast, ata janë të shpëtuarit.

Duke u nisur nga ky ajet themi se namazi duhet të falet duke respektuar me përpikëri dhe seriozitet rregullat dhe aspektet e jashtme si dhe duke e ndjerë me zemër e shpirt të qenurit në prani të Zotit.

Namazi është një sjellje njerëzore. Por nëse nuk qëndrojmë brenda vijës së përcaktuar, atëherë të gjitha lëvizjet kthehen në lëvizje të pakuptimta. Në një hadith, Profeti (s.a.s) thotë: *"Nëse ndonjëri nga ju e ngre kokën nga rukuja para imamit, a nuk frikësohet nga Allahu mos*

t'ia përngjasojë fytyrën me atë të gomarit?" Kjo do të thotë që të vepruarit para imami e nxjerr njeriun jashtë vijës njerëzore. Në një hadith tjetër, Profeti (a.s) thotë: *"Kur të bini në sexhde mos bini sikur bën gjeli kur ha ushqimin."* Vendosja e kokës në tokë dhe ngritja e menjëhershme është një veprim i kafshëve. Ndërsa në një hadith i cili flet për mënyrën si bëhet sexhdja, thuhet: *"Mos i vendosni duart në tokë si qeni"*. Në të gjitha këto hadithe tregohet se lëvizjet e namazit si, ngritja nga rukuja, rënia në sexhde, qëndrimi mes dy sexhdeve duhet të jenë ndryshe nga lëvizjet e kafshëve.

Me fjalët e tij fisnike, i Dërguari i Allahut (s.a.s) na fton në një sjellje të përbashkët njerëzore. Kjo sjellje mund të përshkruhet vetëm me përulje dhe dorëzim.

Cili është vendimi rreth shit-blerjes dhe përdorimit të kolonjës? A e prish namazin përdorimi i kolonjës?

Për të dhënë një vendim rreth ndalimit apo lejimit të një materiali në fillim duhet të shohim substancat përbërëse të tij. Nëse pas analizave shohim se substanca përbërëse është e ndaluar, atëherë edhe materiali është i ndaluar.

Edhe çështjen e kolonjës e shohim nga ky këndvështrim. Kolonja, siç e dinë të gjithë, përmban alkool dhe nëse merret nga goja mund të krijojë dehje. Vendimi për këtë në fenë tonë është i qartë. Të gjithë dijetarët janë të një mendimi në këtë pikë dhe kanë deklaruar se nëse alkooli i tepërt shkakton dehje edhe alkooli i pakët është i ndaluar.

Por tek kolonja çështja është pak ndryshe. Sepse ajo nuk merret për t'u pirë, por me mendimin e mbytjes së mikrobeve dhe përhapjen e aromës së mirë. Prandaj është e rëndësishme të theksojmë disa pika për të mos u gabuar. Në fillim, ashtu siç është e ndaluar pirja e gjërave

të cilat shkaktojnë dehje, ashtu është e ndaluar edhe falja e namazit me një veshje ku ka rënë alkool. Sepse këto lëndë përfshihen në grupin e lëndëve të pista. Kolonja është analizuar dhe është futur në grupin papastërtisë së madhe, dhe nëse përdoret më shumë se duhet, atëherë namazi nuk pranohet.

Edhe pse një pjesë e njerëzve flasin për veçorinë avulluese të kolonjës, në të vërtetë është e qartë sasia e cila avullon. Dijetarët shprehen se edhe pse ndodh procesi i avullimit, mbetja e papastërtisë është reale. Nëse do ta shqyrtonim çështjen nga kjo anë, atëherë do të pranonim se papatërtia në veshje zhduket bashkë me avullimin, gjë e cila nuk mund të pranohet.

Siç e dimë, lëkura përmban pore të cilat kanë veçorinë e thithjes së lëngjeve. Prandaj çdo lloj lëngu i cili prek trupin tonë përthithet nga poret e lëkurës. Në këtë rast ne duhet të pengojmë përhapjen e papastërtisë.

Ndërsa komentet për veçorinë e mbytjes së mikrobeve të kolonjës shkencëtarët e shohin ndryshe. Sipas tyre, kolonja nuk mbyt mikrobet, por përcakton kufijtë e tyre dhe i mban brenda një kornize. Prandaj mund të themi se kjo çështje nuk është qartësuar ende... Më e mira është mospërdorimi i një lënde dobitë e së cilës nuk janë të qarta akoma.

Përsa i përket aromës së mirë, sot ka çfarëdolloj ere, arome të duash të prodhuara për këtë qëllim. Mund të merrni prej tyre, ta përhapni në shtëpi dhe shtëpia juaj do ruajë freskinë, mund ta përdorni në rrobat tuaja dhe me erën e këndshme të tij mund të falni namazin e qetë.

Edhe pse ne mund të vendosim se cila aromë është më e këndshme e cila më e shëmtuar, përsëri nuk duhet të harrojmë dhe kënaqësinë e shpirtrave të pastër (melekëve). Sipas haditheve të Profeti,t shpirtrave të pastër u pëlqejnë

aromat e mira. Aromat e mira janë një lloj ftese për to. Në të njëjtën kohë ato qëndrojnë larg papastërtisë dhe gjërave të pista. Prandaj nuk duhet të harrojmë se edhe pse pa qëllim mund t'i largojmë ato duke përdorur kolonjë. Sepse një nga veçoritë e tyre është qëndrimi larg papastërtisë.

A anulohet nikahu (kurora) dhe a i vuloset zemra atij personi që e lë xhumanë tre herë radhazi?

Brenda rregullave të fikhut *nikahu* i një personi mund të bjerë vetëm nëse ndahet nga gruaja apo ndahet nga gjykatësi -ose mos qoftë e thënë- nëse del nga feja. Një person i cili e braktis namazin e xhumasë edhe pse nuk e mohon faktin që xhumaja është farz, është mëkatar. Në mënyrë të prerë nuk është as qafir apo i dalë nga feja që t'i bjerë nikahu. Nëse e mohon xhumanë si namaz farz atëherë dashur pa dashur nikahu (kurora) bie sepse një grua myslimane nuk mund të martohet apo të jetë e kurorëzuar me një person jobesimtar.

Nëse analizojmë një fjalë e cila qarkullon ndër njerëz si hadith i profetit (a.s.), "personi i cili nuk fal tre xhuma radhazi pa asnjë justifikim quhet qafir", atëherë mund të themi se nuk është hadith sepse nuk plotëson kriteret e hadithit. Por në vend të kësaj ka transmetime të dobëta që nëse një person braktis xhumanë pa asnjë justifikim atëherë zemra e tij është e vulosur dhe e mbyllur. Këto nuk janë gjëra të cilat heqin kurorën.

A është e drejtë të vonohet namazi?

Bëhet fjalë nëse namazi nuk falet në fillim të kohës por lihet për më vonë në fund. Le t'i përgjigjemi:

1)Në bazë të ajetit kuranor **"...namazi është detyrë**

për besimtarët në kohë të caktuar." (nisa, 4/103) kuptojmë që namazi kryhet brenda afateve kohore.

2) Falja e namazit në fillim të kohës është një nga veprat e mira të deklaruara nga Profeti (s.a.s).

3) Nëse namazin e lëmë për në minutat e fundit pa asnjë arsye, atëherë kjo është tahrimen mekruh.

4)Namazi i pafalur në kohën e duhur siç dihet nga të gjithë mbetet kaza. Por falja e namazit kaza edhe sikur të jetë e përkryer nuk ka vlerën e namazit të falur në kohën e vet.

Ka pasur namaze që vetë Profeti (s.a.s.) i ka falur me vonesë për shkak të ndonjë urtësie apo arsyeje. P.sh., falja e namazit pak pas hyrjes së kohës së tij në një ditë me re, shtyrja e namazit të drekës në ditët e nxehta, falja e namazit të sabahut afër kohës së quajtur 'isfar'. Prandaj në prani të këtyre shkaqeve dhe në rastet kur duam të shohim qëllimin e Profetit, namazi mund të falet ashtu si e ka falur ai. Por parimisht namazi duhet të falet sapo hyn koha e tij.

PJESA E KATËRT

AGJËRIMI

Zekati i trupit..

AGJËRIMI



"Agjërimi është zekati i trupit."

"Agjërimi është gjysma e durimit."

Hadith



Agjërim do të thotë të largohesh nga ngrënia, pirja, kryerja e marrëdhënieve seksuale me qëllimin e adhurimit që nga agimi deri në perëndimin e diellit.

Agjërimi është shprehje e shmangies nga dëshirat seksuale, të ngrënit, të pirit, largimi nga lidhjet e kësaj bote dhe afrimi me Allahun (xh.sh).

Agjëruesi duhet të jetë mysliman, në moshë madhore, i shëndoshë mendërisht dhe fizikisht, nuk duhet të jetë i sëmurë apo udhëtar. Ata që nuk mund të agjërojnë nga mungesa e fuqisë, ata që janë udhëtarë apo të sëmurë nuk e kanë detyrim agjërimin. Por nëse munden, agjërimi i mbajtur i vlerësohet.

FARZET E AGJËRIMIT

1. Qëllimi (të bësh nijetin).

2. Largimi nga gjërat të cilat e prishin agjërimin nga agimi deri në perëndimin e diellit. Fillimi i kohës së agjërimit quhet '*imsak*' dhe mbarimi i saj '*iftar*'.

LLOJET E AGJËRIMIT

Agjërimi ndahet në:

1. Farz
2. Vaxhib
3. Sunet
4. Mendub
5. Nafile
6. Mekruh

Agjërimi Farz: është agjërimi i Ramazanit, kazaja e tij dhe kefareti.

Agjërimi Vaxhib: është kazaja e agjërimit të prishur nafile si dhe agjërimi i betimit.

Agjërimi Sunet: është agjërimi i ditës së nëntë të muajit Muharrem dhe ditës së Ashures (ditës së dhjetë të muajit Muharrem), si dhe agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte.

Agjërimi Mendub: është agjërimi i tre ditëve në muaj, përkatësisht dita e 13, 14, 15 e çdo muaji hënor.

Agjërimi Nafile: janë agjërimet të cilat mbesin jashtë agjërimeve mekruh dhe atyre të mësipërm.

Agjërimi Mekruh: agjërimi vetëm ditën e Ashures, vetëm ditën e parë të Bajramit të Ramazanit apo ditën e 1,2,3,4 të Kurban Bajramit është tahrimen mekruh.

Agjërimi ndahet në dy lloje nga natyra e nijetit:

1. Agjërimet për të cilat nijeti bëhet natën. Në agjërimet kaza të Ramazanit, të nafileve, në agjërimin e kefaretit dhe të betimit nijeti duhet të bëhet që natën.

2. Agjërimet të cilat nuk e kanë të domosdoshëm nijetin natën: agjërimi i mbajtur në Ramazan si dhe agjërimet nafile. Tek këto agjërime nuk është kusht bërja e nijetit që natën. Nijeti mund të bëhet duke filluar natën e deri në drekën e ditës së nesërme. Në muajin e Ramazanit le të bëhet nijet për nafile apo për vaxhibe, agjërimi mbetet agjërimi i muajit Ramazan.

RASTET QË PRISHIN AGJËRIMIN

Rastet që prishin agjërimin i ndajmë në dy grupe: në rastet të cilat kërkojnë vetëm kazanë dhe në rastet të cilat kërkojnë kefaretin.

RASTET TË CILAT PRISHIN AGJËRIMIN DHE KËRKOJNË VETËM KAZANË

1. Ngrënia e diçkaje pa dashur duke e ditur se është agjërueshëm.
2. Kalimi në fyt i ujit të marrë nga goja apo hunda.
3. Bërja e nijetit pas dreke dhe jo në kohën e duhur.
4. Ngrënia e diçkaje me qëllim pasi më parë ka ngrënë diçka pa e ditur se ka qenë agjërueshëm, gjë e cila nuk prish agjërimin.
5. Të kalosh ujin e shiut apo të borës që hyn nga goja.
6. Bërja e gjilpërës.
7. Marrja e ilaçit nga hunda.
8. Marrja e ilaçit nga vesh.

9. Ngrënia e syfyrit duke menduar se ende nuk ka dalë koha.

10. Të bësh iftar duke menduar se ka perënduar dielli.

11. Kalimi poshtë i të vjellës që vjen deri në gojë.

12. Nxjerrja e pështymës pastaj kalimi i saj poshtë.

13. Nëse nga dhëmbi na rrjedh gjak më shumë se masa e pështymës dhe kalimi i tij poshtë.

14. Të ndezësh temjan dhe të kalosh në fyt tymin.

RASTET TË CILAT PRISHIN AGJËRIMIN DHE KËRKOJNË KAZA DHE KEFFARET

1. Ngrënia dhe pirja me qëllim.
2. Kryerja e marrëdhënieve seksuale me qëllim.
3. Pirja me qëllim e cigares.

Nëse ndonjëri bën një nga rastet e mësipërme duhet të bëjë kaza agjërimin si dhe të zbatojë kefaretin, të agjërojë dy muaj pa ndërprerje.

GJËRAT MEKRUH PËR AGJËRUESIN

1. Të shijosh diçka pa pasur nevojë.
2. Të përtypësh diçka kot.
3. Të përtypësh një çamçakëz që nuk i ka mbetur shije.
4. Të puthurit.
5. Përqafimi me bashkëshortin/en.
6. Të mbledhësh pështymën në gojë dhe ta kalosh poshtë.
7. Të dhurosh gjak.

RASTET TË CILAT NUK PRISHIN AGJËRIMIN

1. Të ngrënit, të pirit, kryerja e marrëdhënieve seksuale në harresë.
2. Ejakulimi i spermës thjesht nga shikimi apo fantazia.
3. Ejakulimi i spermës gjatë gjumit.
4. Të puthurit pa ardhjen e ejakulimit.
5. Të zgjohesh nga gjumi me probleme mendore.
6. Të kalosh këlbazën që të vjen deri në gojë.
7. Të thithurit e sekrecioneve që vijnë nga hunda.
8. Kalimi i ujit në vesh.
9. Të kalosh poshtë thërrime të mbetura mes dhëmbëve që janë më të vogla se një kokërr misër.
10. Të vjellësh pa dëshirë me gojë të plotë.
11. Të bësh makijazh.
12. Të bësh thashetheme.
13. Të hedhësh ilaç në sy.

AGJËRUESI

• Fiton të drejtën e një çmimi të veçantë. Profeti ynë (s.a.s) na transmeton një hadith kudsi në të cilin thuhet: *"Agjërimi është për Mua, dhe vetëm Unë e jap shpërblimin për të."* (Buhari, Savm, 9)

• Duke qëndruar larg dëshirave edukon vullnetin.

• Duke parë vështirësitë e qëndrimit larg mirësive dhe duke përjetuar urinë dhe etjen zgjeron kufijtë e durimit. Profeti ynë (s.a.s) thotë: *"Agjërimi është gjysma e durimit."* (*Tergib ue Terhib, 11/ 208*)

• U vë kufi dëshirave dhe kërkesave të pafund dhe pengon të gjitha mosmarrëveshjet që i hapin rrugë

pakënaqësisë në mes njerëzve.

• Mbron gjuhën nga fjalët e shëmtuara dhe të këqija. Profeti (s.a.s) ka thënë: *"Nëse ndonjëri ju shqetëson apo nxehet ndaj jush, atëherë thuajini: "Jam agjëruesh ëm"*. (Muslim, Sijam, 163)

• Arrin të jetë i kuptueshëm ndaj atyre të cilët nuk kanë mundësi të njëjta me të dhe përpiqet t'i ndihmojë ata në zgjidhjen e problemeve.

• Beson se nëse agjërimi bëhet duke i besuar Allahut dhe duke pritur shpërblim vetëm nga Ai, atëherë i falen të gjitha mëkatet e të shkuarës, hap një faqe të re për të ardhmen, mbron veten nga të këqijat dhe mëkatet.

• Gjatë një muaji ndryshon rrjedhën e jetës që bën gjatë njëmbëdhjetë muajve dhe drejton veten drejt të mirës dhe të bukurës.

FITRI

Sadakaja e fitrit është një adhurim material i cili realizohet në muajin e Ramazanit nga myslimanët të cilët përveç plotësimit të nevojave të tyre zotërojnë një sasi të caktuar të hollash dhe të cilin e japin për veten dhe për personat që kanë nën përgjegjësi. Dhënia e sadakasë së fitrit është vaxhib. Sadakaja e fitrit mund të jepet dhe në vendin ku jepet zekati.

Sadakaja e fitrit është një shprehje e falënderimit ndaj Allahut përballë mirësive dhe begative që na ka dhuruar neve dhe të afërmve tanë. Për të dhënë sadakanë e fitrit nuk është e detyrueshme (vaxhib) të agjërosh. Dhënia e saj është vaxhib për agjëruesit dhe për ata të cilët nuk kanë mundësi të agjërojnë.

Sadakaja e fitrit mund të jepet që në fillim të muajit të

Ramazanit. Por dhënia e saj dy ose tre ditë para Bajramit është diçka më e bukur sepse plotëson nevojat e të varfërve.

Nuk duhet të lihet të jepet pas ditës së parë të Bajramit. Nëse nuk keni pasur mundësi ta jepni para Bajramit atëherë duhet ta jepni menjëherë pas tij.

Kriteri më i saktë i përllogaritjes së fitrit është sigurimi i ushqimit të nevojshëm njëditor normal për një person. Kjo është sasia limit. Gjithsesi, këtu vlen të shtojmë se çdokush duhet të japë fitër aq sa të jetë edhe shpenzimi i tij ditor në ushqime.

Sadakaja e fitrit është një adhurim. Dhe në adhurime qëllimi është kusht kryesor. Prandaj duhet të bëjmë nijetin kur japim fitrat. Nijeti mund të bëhet kur japim fitren ose kur e ndajmë, e bëjmë gati për t'ia dhënë. Qëllimi bazohet në dhënien me zemër për hir të Allahut. Kur japim fitren nuk është e nevojshme të thuhet se 'kjo është sadakataja e fitrit'.

KEFARETET

Kefaretet i ndajmë në katër grupe: kefareti i agjërimit të muajit të Ramazanit, kefareti dhihar, kefareti i betimit dhe kefareti i mbytjes së një personi.

1. KEFARETI I AGJËRIMIT TË RAMAZANIT

Nëse agjërimi i Ramazanit prishet qëllimisht ose pa asnjë lloj shkaku apo justifikimi, atëherë pas Ramazanit duhet të agjërohet dy muaj rresht pa ndërprerje. Kjo çështje është shpjeguar edhe në hadithe:

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejre (r.a) thuhet:

Një burrë erdhi tek Profeti dhe i tha:

"U shkatërrova".

"Ç'është ajo gjë që të ka shkatërruar?" e pyeti Profeti (s.a.s).

"Kam kryer marrëdhënie seksuale me gruan gjatë muajit të Ramazanit" iu përgjigj ai:

Pas kësaj Profeti (s.a.s) iu drejtua me këto fjalë:

"A mund të lirosh një skllav?"

"Jo" iu përgjigj burri.

"A mund të agjërosh dy muaj pa ndërprerje?" e pyeti përsëri Profeti (a.s).

"Jo" iu përgjigj burri.

"A ke aq pasuri sa të ushqesh 60 të varfër?" e pyeti Profeti (a.s).

Burri përsëri iu përgjigj: "Jo".

Në atë çast Profetit (a.s) i sollën një shportë me hurma. Profeti (a.s) ia zgjati shportën me hurma dhe i tha:

"Shpërndaji këto si sadaka!"

"Ku ka më të varfër se unë? Nuk ka familje më të varfër se ne mes lindjes dhe perëndimit të Medines" iu drejtua burri Profetit.

Pas këtyre fjalëve transmetohet se profeti qeshi aq shumë sa iu dukën dhëmballët dhe iu drejtua burrit me këta fjalë:

"Shko dhe jepja familjes tënde."

2. KEFARETI DHIHAR

Dhihar do të thotë përngjasimi i trupit të gruas apo të ndonjë pjese të trupit që tregon gjithë trupin, me një pjesë trupi të personave të cilët i ka të ndaluar (e ka të ndaluar martesën) si nëna apo motra, apo me një organ shikimin e të cilit e ka të ndaluar. P.sh., nëse një njeri i thotë gruas së tij: "Ti je si nëna ime, qafa jote është si të mbrapmet e nënës sime". Nëse një person flet në këtë mënyrë atëherë kërkohet kefaret. Nuk e ka të lejuar kryerjen e marrëdhënieve seksuale me gruan e tij derisa të plotësojë kefaretin. Sepse duke folur në atë mënyrë ka gënjyer dhe ka treguar si të ndaluar diçka të lejuar. Kefareti në këtë rast është agjërimi i dy muajve rresht. Nëse nuk ka mundësi të agjërojë dy muaj, atëherë duhet të ushqejë 60 të varfër.

3. KEFARETI I BETIMIT

Kefareti i betimit kërkohet në rastin kur një person nuk i përmbahet betimit apo premtimit të dhënë dhe e prish atë. Një person i tillë nëse ka mundësi duhet të ushqejë dhjetë të varfër, për mëngjes dhe darkë si dhe t'i veshë ata. Nuk mjafton vetëm një palë pantollona. Nëse nuk ka mundësi ta bëjë këtë, atëherë duhet të agjërojë tri ditë rresht. Nëse agjërimi prishet nga ardhja e menstruacioneve apo diçkaje tjetër, duhet të mbahet përsëri.

4. KEFARETI I TË QETHURIT

Kefareti i të qethurit kërkohet atëherë nëse personi i qeth flokët e tij para se të hyjë në ihram për shkak të ndonjë arsyeje. Ky kefaret është agjërimi i tri ditëve. Ky agjërim nuk është i detyrueshëm të mbahet tri ditë rresht; mund të mbahet edhe në ditë të veçuara.

KEFARETI I VRASJES SË NJË PERSONI

Ky është një lloj kefareti që i kërkohet atij personi i cili vret pa qëllim, gabimisht një mysliman apo një jomysliman që jeton nën mbrojtjen e shtetit islam. Nëse ky person ka mundësi financiare, duhet të lirojë një rob. Nëse nuk mundet, atëherë duhet të agjërojë dy muaj pa ndërprerje.

ITIKAFI

Qëndrimi në xhami apo në një pjesë brenda xhamisë për arsye adhurimi për një kohë të caktuar quhet itikaf.

Itikafi ndahet në tre pjesë: vaxhib, sunet dhe mustehab. Nëse premton me gojë bërjen e itikafit atëherë realizimi i tij është vaxhib. Ndërsa itikafi i mbajtur dhjetë ditët e fundit të Ramazanit është sunet. Përveç dy rasteve të mësipërme, itikafi i bërë në xhami për arsye adhurimi është mustehab.

KUSHTET E ITIKAFIT

Itikafi ka katër kushte:

1. Personi i cili do të bëjë itikafin duhet të jetë mysliman, mendërisht i shëndoshë dhe i pastër. Itikafi i personit jomysliman, të çmendurit, të papastrit, gruas me menstruacione nuk është i pranueshëm. Për bërjen e itikafit nuk është kusht mosha e pjekurisë, gjinia apo liria.

2. Duhet të bëhet nijeti për itikaf. Nuk është i pranueshëm një itikaf i cili realizohet pa nijet.

3. Itikafi duhet të bëhet në xhami apo në një pjesë tjetër të njohur si mesxhid. Më e virtytshme është të

realizohet në xhami të mëdha. Ndërsa për gratë është më e përshtatshme ta realizojnë në shtëpi.

4. Personi i cili bën itikafin vaxhib duhet të jetë agjërueshëm. Personi i cili hyn në itikaf nuk del jashtë nga xhamia vetëm në rast të nevojave personale dhe të domosdoshme. Gjatë itikafit përpiqet të flasë vetëm rreth temave morale. Nuk bën asnjë gjë e cila të jetë e ndaluar.

Itikafi më i mirë është itikafi i dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit. Sepse edhe vetë Profeti (s.a.s) ka bërë itikaf çdo ramazan që nga ardhja në Medine e deri në fund të jetës së tij.

Itikafi është edukimi i nefsit dhe i shpirtit për një periudhë kohore të ndarë vetëm për adhurim brenda një xhamie. Në këtë mënyrë zemrat qoftë edhe për pak kohë qëndrojnë larg punëve të kësaj bote, i drejtohen Allahut dhe strehohen në derën e mëshirës dhe të ndihmës, besimtari i cili lutet brenda xhamisë, shtëpisë së Allahut është i mbrojtur nga të gjitha të këqijat porsi të ishte brenda një kalaje të fortë. Njeriu i cili hyn në itikaf i përkushtohet adhurimit dhe fjalëve të mira. Mbron gjuhën nga gënjeshtra, shpifjet dhe thashethemet dhe nuk dëmton askënd. Qëllimi dhe mendimi i tij janë të drejtuar drejt së mirës. Duke qenë gjatë gjithë kohës brenda xhamisë, edhe pritja jashtë kohëve të namazit i llogaritet njësoj si një namaz. Gjatë itikafit qëndron larg punëve të botës dhe i drejtohet vetëm Allahut (xh.sh). Kjo gjendje ia ndriçon zemrën, ia pastron mendimet dhe e lartëson nga ana shpirtërore.

ETIKA E ITIKAFIT

Etikën e itikafit mund ta ndajmë kështu:

1. Itikafi duhet të bëhet në dhjetë ditët e fundit të

Ramazanit në një nga xhamitë më të mira.

2. Gjatë itikafit nuk duhet të flasim gjë tjetër përveç fjalëve të mira. Nuk përbën mëkat të flasësh rreth gjërave të cilat nuk janë të ndaluara. Ndërsa mbrojtja e gjuhës nga gjërat e ndaluara është një nga adhurimet më të mëdha.

3. Kohën e itikafit duhet ta kalojmë duke lexuar Kuran, mësuar hadithe dhe çështje të tjera fetare.

4. Personi i cili hyn në itikaf duhet të vishet bukur dhe të përdorë erë të mirë.

5. Personi i cili do të realizojë itikafin vaxhib duhet të bëjë nijet jo vetëm me zemër por edhe me gojë.

GJËRAT QË E PRISHIN DHE NUK E PRISHIN ITIKAFIN

Dalja nga xhamia e personit i cili është në itikaf për arsye personale (për të falur namazin e xhumasë, për kryerjen e nevojave personale, për të marrë abdes, gusul) nuk e prish itikafin.

Itikafi prishet nëse personi del nga itikafi pa asnjë arsye.

Itikafi gjithashtu prishet nëse dilet për një orë për të vizituar një të sëmurë, për të larë një xhenaze, për të falur namazin e xhenazes, për të dëshmuar apo për arsye shëndetësore. Në rastin e itikafit vaxhib, nëse personi ka vënë kusht vizitimin e të sëmurëve, faljen e namazit të xhenazes gjatë itikafit, atëherë nuk prishet.

Edhe dalja jashtë për shkak të një shqetësimi të rrallë e prish itikafin. Dalja jashtë për të shpëtuar njerëzit kur bie zjarr apo është duke u mbytur dikush, apo edhe dalja jashtë me xhematin e prish itikafin.

Nëse personi i cili është në itikaf qëndron disa ditë pa ndjenja, atëherë itikafi prishet. Ai mund ta fillojë përsëri atë kur të shërohet.

Në rastin kur prishet itikafi vaxhib atëherë duhet kryer kazaja e tij.

Ndërsa në rastin kur lëmë një itikaf nafile nuk është e nevojshme të bëhet kaza më vonë.

Për personin i cili hyn në itikaf është e ndaluar kryerja e marrëdhënieve seksuale ose ndonjë veprim i cili bëhet shkak për të gjatë natës apo ditës.

Personi i cili gjendet në itikaf mund të blejë në xhami gjërat të cilat i duhen. Gjithashtu ai mund të sjellë në xhami gjërat e nevojshme pa dëmtuar xhaminë. Ai ha dhe pi në xhami. Nëse ka një vend të përshtatshëm brenda xhamisë aty mund të marrë abdes apo gusul. Nëse nuk ka, atëherë del jashtë dhe merr abdes në vendin më të afërt dhe pa humbur kohë kthehet menjëherë në xhami.

Personi i cili bën itikaf mund të dalë në minare për të kënduar ezanin. Nuk ka problem edhe nëse dera e minares është jashtë xhamisë.

DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME AGJËRIMIN

A ndalohet agjërimi i ditëve kaza në ditë më të shkurtra?

Agjërimi i mbetur kaza mund të kompensohet më vonë në ditë të shkurtra apo të gjata; e rëndësishme është realizimi i obligimit. Por nëse agjërimi lihet qëllimisht për t'u kompensuar më vonë në ditë më të shkurtra, do të thotë se personi kërkon të shpëtojë nga obligimi. Megjithatë më e rëndësishmja e adhurimeve është qëllimi i pastër, i sinqertë dhe vendosmëria.

A lejohet përdorimi i misvakut kur je agjërueshëm?

Dijetarët myslimanë kanë folur shumë rreth qëndrimit larg rasteve të cilat mund të prishin agjërimin. Misvaku nga struktura e tij nuk është i ndaluar, por për shkak të pështymës e cila mund të kalojë poshtë gjatë përdorimit, është më mirë të mos përdoret. Disa kanë thënë të përdoret në periudha të caktuara para ose pas drekës, misvak i thatë apo i lagësht, e kanë lejuar të përdoret para drekës ndërsa pas drekës e kanë ndaluar, kanë lejuar përdorimin e misvakut të thatë e jo atij të lagësht. Edhe pse elementët të cilët mund të prishin agjërimin janë të njëjtë në të katër rastet.

A e prish agjërimin heqja e dhëmbit?

Heqja e dhëmbit nuk e prish agjërimin. Nëse bëhet gjilpërë gjatë heqjes së dhëmbit atëherë agjërimi prishet. Agjërimi gjithashtu prishet edhe nëse kalohet poshtë gjaku i dalë nga heqja e dhëmbit. Person që gjatë agjërimit të Ramazanit heq një dhëmb dhe për shkaka të gjilpërës apo të gjakut prish agjërimin, e kompenson atë më vonë dhe nuk ka nevojë për kefaret.

A e prishin agjërimin gënjeshtra, thashethemet apo shikimi i të ndaluarës?

Edhe pse në një hadith të Profetit (s.a.s) thuhet: *"Agjërimi prishet nga gënjeshtra, thashethemet, premtimi i rrejshëm dhe nga shikimi me epsh i të ndaluarës"*, Ebu Hanife e shpjegon këtë hadith kështu: "Këto mëkate prishin sevapin e agjërimit, nuk prishin korrektësinë, gjithsesi agjërimi bëhet mekruh." Kjo do të thotë se ai person mund të kryejë agjërimin si obligim, por nuk mund të arrijë sevapin e madh të tij. Nuk duhet të harrojmë se çfarë

thotë Profeti (s.a.s) në një hadith: *"Ka aq shumë agjërues të cilët nuk përfitojnë asgjë nga agjërimi përveç urisë dhe etjes."*

Mënjanimi i shikimit të harameve është një parim që duhet ta shoqërojë gjithnjë besimtarin. Sepse Profeti (s.a.s) thotë: *"Shikimi i të ndaluarës është një shigjetë e helmuar e shejtanit. Ai i cili nuk e bën këtë nga frika për Allahun, Allahu i jep një besim, ëmbëlsinë e të cilit e ndjen brenda në zemër."*

Përveç kësaj, agjëruesi duhet të ruajë dhe gjuhën. *"Agjërimi e shuan zjarrin, është mburojë ndaj tij. E ruan nga thashethemet. Agjëruesi mos të gabojë duke thënë fjalë të shëmtuara. Nëse ndonjëri e ngacmon, le t'i thotë jam agjërueshëm"*, thotë Profeti duke na tërhequr vëmendjen në këtë çështje. Fjala nuk e prish agjërimin.

Ashtu siç ruajmë syrin dhe gjuhën nga mëkatet, ashtu duhet të ruajmë dhe veshin. Është i ndaluar dëgjimi i fjalëve apo bisedave të ndaluara. Edhe duart, këmbët e pjesë të tjera të trupit duhet t'i ruajmë nga e ndaluara. Ata që bëjnë mëkate gjatë agjërimit është njësoj si të pijnë helm në vend të ilaçit. Sepse mëkati është helm. Zhduk të gjitha sevapet e adhurimeve. Prandaj le të mos ia heqim sevapet veprave tona duke vepruar në mënyrë të gabuar.

A prishet agjërimi nga përdorimi i produkteve kozmetike dhe nga përtypja e çamçakëzit?

Një ilaç i ngurtë i vendosur në hundë nuk e prish agjërimin, ndërsa ilaçi i lëngshëm e prish atë. Edhe kremrat, deodorantët nuk e prishin agjërimin. Gjaku i cili mund të rrjedhë për shkak të rruajtjes nuk e prish agjërimin.

Edhe buzëkuqi nuk e prish agjërimin por nëse hahet, atëherë prishet. Duhet të kompensohet më vonë.

Përdorimi i ndonjë kremi për trupin nuk e prish

agjërimin. Nxjerrja e gazit të tabletës së azmës e prish agjërimin ashtu si tymi i duhanit.

Për agjëruesin nuk është e lejuar ngrënia e sheqerkave të vogla. Edhe pse ka prej atyre që e konsiderojnë mekruh, nuk duhet ta mbajmë në gojë. Është e lejuar marrja e hapave për të vonuar ardhjen e menstruacioneve për të mos lënë agjërimin, por nuk është e nevojshme.

Nuk është mekruh marrja erë e aromave të mira apo trëndafilit. Agjërimi nuk prishet as nga marrja erë deodorantëve apo esencave të tjera, madje nuk është as mekruh.

A e prish agjërimin pasta e dhëmbëve?

Përdorimi i furçës së dhëmbëve gjatë kohës së agjërimit është mekruh. Nuk ka ndonjë pengesë në fërkimin e dhëmbëve pa pastë dhëmbësh. Megjithatë duhet patur kujdes në moskalimin e ujit poshtë. Edhe nëse përdorim pastën e dhëmbëve agjërimi nuk prishet, por është mekruh. Por nëse kalohet poshtë pasta e dhëmbëve apo uji, atëherë agjërimin quhet i prishur dhe duhet të kompensohet më vonë.

PJESA E KATËRT

ZEKATI

Ura mes të pasurit dhe të varfrit...

ZEKATI



"Mbrojeni pasurinë tuaj me zekat"

Hadith



Zekati është dhënia e një sasie të caktuar parash personave apo grupeve të përcaktuara sipas vendimeve fetare. Në vend të fjalës zekat mund të përdoren dhe koncepte të ngjashme si dhurim apo sadaka.

Zekat është detyrim për personat në moshë madhore, mendërisht të shëndoshë, të lirë, të mos kenë borxhe dhe përveç përballimit të nevojave të tij dhe të familjes të zotërojë pasuri në vlerën e nisabit mbi të cilin të kalojë një vit pa e prekur. Sasia e *nisabit* është kusht si për pasurinë ashtu dhe për prodhimin. Edhe pse ari dhe argjendi nuk shtohen, zekati jepet kur arrin vlerën e nisabit.

Nisabi: është një masë e caktuar nga feja për detyrimin e zekatit. Kjo masë është 85 gr ar, 595 gr argjend ose pasuri, mallra tregtie, para në vlerën e tyre.

Përsa i përket zekatit të kursimeve të parave, ajo është 2.5 % e vleftës totale të paprekur për periudhën njëvjeçare. Zekati i kafshëve ndryshon nga lloji i tyre. Tek të imtat është një në dyzet; tek devetë një në pesë; tek të trashat (lopë) një në tridhjetë. Edhe për mineralet jepet zekat.

KUJT DUHET T'I JEPET ZEKATI

Allahu i Lartësuar i ka përcaktuar në Kuran në suren Tevbe, ajeti 60, vendet ku duhet të jepet zekat. Sipas ajetit, vendet ku jepet zekat janë:

1. Të varfrit (personat të cilët nuk kanë pasuri në masën e nisabit)

2. Nevojtarët (personat të cilët nuk kanë asgjë)

3. Nëpunësit që mbledhin zekatin

4. Personave të cilët duam t'i afrojmë e t'ia ngrohim zemrën me Islamin. Këtë grup mund ta ndajmë në tre pjesë:

Personat të cilët edhe pse janë myslimanë akoma nuk kanë besim në zemrat e tyre.

Personat që nuk janë myslimanë por shpresohet të bëhen të tillë.

Edhe pse nuk janë myslimanë, mund të jepet për t'u ruajtur nga e keqja dhe për të zbutur pak atmosferën.

5. Robërve, për t'i shpëtuar nga robëria.

6. Borxhlinjve (atyre që nuk kanë pasuri të paguajnë borxhin)

7. Personave që ia kanë kushtuar jetën diturisë, njerëzve dhe institucioneve që ndihmojnë në përhapjen e fesë islame dhe në përgjithësi të gjithë institucionet apo shoqatat që ndikojnë në përhapjen e kulturës Islame.

8. Udhëtarët. (atyre që mund të kenë nevojë për para gjatë udhëtimit)

KUJT NUK MUND T'I JEPET ZEKATI

Përveç përcaktimit se cilës kategori mund t'i jepet zekat, janë përcaktuar gjithashtu edhe personat dhe kategoritë se ku nuk mund të jepet zekati. Këto janë:

1. Të pasurit
2. Personat e aftë për punë
3. Jomyslimanët
4. Farefisi i afërt (Një person nuk mund t'i japë zekat personave të afërt të familjes si nënës, babait, fëmijëve apo gruas. Këtu nënkuptohet se nuk mund t'i japë as gjyshërve, nipërve apo mbesave).
5. Të afërmve të Profetit.

MALLRAT QË MUND TË JEPEN ZEKAT

1. *Mallrat e tregtisë*

Tek mallrat e tregtisë hyn çdo lloj malli si veshmbathje, ushqimet, bagëtitë, shtëpitë, tokat dhe për të gjitha duhet të jepet zekat.

Bagëtitë që mbahen për qëllime tregtie hyjnë brenda mallrave të tregtisë dhe për to jepet zekat në masën 2.5 %.

Zekati i mallrave të tregtisë llogaritet 2.5 % e gjithë vlerës së mallit që zotëron personi. Ky zekat mund të jepet në para ose në vlera të tjera.

2. *Zekati i bagëtive*

Bagëtitë i ndajmë në grupe dhe ndarja e zekatit bëhet sipas grupeve të caktuara në vlerën e caktuar.

3- *Pasuria monetare*

Stolitë të cilat përdoren për qëllime tregtia kanë nisabin e përcaktuar, në ar 85 gram ndërsa në argjend 595 gram. Secili person që zotëron këtë sasi të caktuar duhet të japë zekat 2.5 % të mallit. Edhe ata që kanë bono apo letra me vlerë, zekatin e japin duke llogaritur 1/40 e vlerës së mallit që kanë.

4. *Pasuritë e patundshme*

Përsa i përket personave që kanë shtëpi me qera, diskutohet nëse duhet dhënë zekat mbi vlerën e qerasë apo mbi vlerën e pasurisë. Pjesa më e madhe e dijetarëve janë të mendimit të jepet mbi vlerat personale. Disa dijetarë e përngjasojnë vlerën e qirave me sasinë e mallrave bujqësorë dhe mendojnë se duhet të jepet 1/10 ose 1/20 e vlerës së qirasë. Ndërsa të tjerë mbështesin mendimin e dhënies 1/40 e vlerës së pasurisë së patundshme.

5. Mineralet

Sasia e nisabit për minerale si ari, argjendi, mermeri, smeralde, rubinë, naftë apo gaz natyror është 1/5 ose 20 % e mallit që zotëron personi.

6. Prodhimet bujqësore

Tek prodhimet bujqësore kemi dy lloj ndarjesh: nëse tek toka ku mbillet bëhen shpenzime si ujitja, përdorimi i ilaçeve apo ndonjë lloj shpenzimi tjetër, atëherë zekati është 1/20, ndërsa nëse marrim prodhime pa pasur asnjë shpenzim, është 1/10.

NJERIU QË JEP ZEKAT

• Pastron veten nga ndjenja si koprracia, egoizmi dhe mendjemadhësia.

• Kupton që falënderimi ndaj Allahut (xh.sh) për mirësitë që i ka dhënë nuk bëhet vetëm me gojë.

• Ndikon në eliminimin e hendekut mes të varfërve dhe të pasurve. Në këtë mënyrë mes tyre lind respekti, harmonia, afrimi dhe kjo ndikon në formimin e një klime paqësore në shoqëri.

• Mundëson pakësimin e fenomeneve të turpshme të shoqërisë si lypja apo vjedhja.

• Personi që jep zekat ndërgjegjësohet për detyrimet e tij në shoqëri, pasqyron një shpirt të vetëm dhe të bashkuar. Ashtu siç vuan trupi kur sëmuret një prej organeve të tij, ashtu dhe ai që jep zekat ndikohet nga problemet e shoqërisë dhe përpiqet t'i zgjidhë brenda mundësive që ka.

• Shpëton nga robëria ndaj pasurisë e mallrave dhe me veprat e tij pohon se pronari i vërtetë i të gjithçkaje është Allahu (xh.sh).

• Lartësohet duke mësuar virtytet themelore njerëzore si ndihmesa e vëllezërve në nevojë, ndarja me të tjerët, dhurimi, si dhe lumturohet nga lajmi i mirë që na e thotë Profeti në një hadith të tij: *"Dora që jep është më lart se dora që merr"*. (Buhari, nefakat, 1)

PREMTIMI

Do të thotë t'i premtosh Allahut (xh.sh) realizimin e një vepre jo të ndaluar dhe ta kthesh realizimin e saj në vaxhib (obligim) për veten.

Është një lloj premtimi i bërë Allahut me anë të të

cilit njeriu e obligon veten në realizimin e një vepre e cila mund të jetë mubah.

Personi i cili bën një premtim duhet të jetë mendërisht i shëndoshë dhe të ketë arritur moshën e pjekurisë.

Të premtosh realizimin e disa veprave për hir të Allahut (xh.sh) konsiderohet adhurim dhe një mjet për të fituar sevape. P.sh., të premtosh se nesër do të agjëroj apo do të ushqej disa të varfër. Premtimi i bërë për gjëra të kësaj bote nuk pranohet. Si p.sh., "nëse një punë e imja më shkon mirë do të agjëroj një ditë, do të jap sadaka."

Njeriu duhet t'i mbahet premtimit të dhënë. Sepse premtuesi ka bërë një lloj marrëveshjeje me Allahun e Madhëruar. Prandaj premtimi duhet të respektohet dhe të zbatohet.

KUSHTET E PREMTIMIT

Duhet të zbatohen disa kushte për pranimin e premtimit:

1. Njeriu duhet të premtojë mbi gjëra të cilat janë farz apo vaxhib. Premtimi p.sh., "Do të agjëroj një ditë, apo do të fal dy rekat namaz është i pranueshëm. Por një premtim si "do të vizitoj një të sëmurë", nuk është i nevojshëm të zbatohet. Sepse vizita e një të sëmuri nuk është adhurim farz apo vaxhib.

2. Duhet të përcaktohet mirë ajo gjë farz apo vaxhib për të cilën bëhet premtimi dhe të mos ngatërrohet me ndonjë shkak i cili ndihmon në realizimin e farzit. P.sh., premtimi "do të fal dy rekat namaz" është i pranueshëm, ndërsa premtimi "do të marr abdes" nuk pranohet. Sepse me abdesin nuk nënkuptojmë një adhurim, por një shkak i cili ndihmon në realizimin e një adhurimi.

3. Premtimi nuk duhet të jetë i lidhur me ndonjë

adhurim i cili duhet të zbatohet menjëherë apo në një të ardhme të afërt. Prandaj premtimi si "nëse më plotësohet dëshira do të fal namazin e sabahut nesër" nuk pranohet.

4. Gjëja për të cilën premtohet nuk duhet të jetë kundër kënaqësisë së Allahut dhe të përbëjë një mëkat. Prandaj premtimi si "nëse më ecën kjo punë do të flijohem në rrugë të Allahut" nuk është i vlefshëm.

5. Premtimi duhet të bëhet mbi gjëra realizimi i të cilave është i mundur. Si p.sh., do të agjëroj në këtë ditë apo në një ditë të caktuar në të ardhmen.

6. Njeriu i cili premton duhet të bëjë një premtim brenda mundësive që ka dhe gjithashtu nuk duhet të premtojë mbi pasurinë e dikujt tjetër. P.sh., nëse personi në fjalë premton se do të japë një milion lekë, por në dorë ka vetëm njëqindmijë, atëherë duhet t'i japë ato. Ose nëse një person premton për flijimin e një kurbani që i përket dikujt tjetër atëherë nuk është e nevojshme ta bëjë.

KURBANI I PËRKUSHTUAR

Njeriu mund të premtojë edhe për flijimin e një kurbani. Rreth kësaj çështjeje duhet të kemi parasysh dy gjëra:

1. Kurban mund të bëhen vetëm kafshë me katër këmbë si bagëtitë e imta, të trasha apo devetë. Nuk mund të bëhen kurban kafshë që qëndrojnë në dy këmbë si pula, pata, apo gjeli detit.

2. Nga mishi i kurbanit nuk mund të hanë gruaja, nëna, babai, fëmijët dhe nipërit e mbesat e premtuesit. Mishi i kurbanit u shpërndahet të varfërve. Nëse hanë prej tij, atëherë duhet t'u japin të varfërve ushqime në vlerën e mishit të ngrënë.

DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME ZEKATIN

Nëse kemi një fond të posaçëm zekati, a mund t'ia shpërndajmë nxënësve?

Nëse flasim për një fond, na vjen në mendje një lloj organizimi. Në të vërtetë ne e dimë që në kohën e Profetit (s.a.s) zekati është mbledhur nga nëpunësit e shtetit në vende të posaçme. Prandaj edhe tek kategoritë të cilat përfitojnë nga zekati bëjnë pjesë edhe nëpunësit që mbledhin zekatin.

Në ditët e sotme është e pamundur të flasim për një organizim shtetëror të tillë në mbledhjen e zekatit. Por mund të flasim për fonde të veçanta të mbledhura nga shoqata apo vakëfe të cilat u shpërndahen nxënësve të shkollave tetëvjeçare, të mesme dhe të larta në formë burse, ndihme ushqimore, strehimi e të tjera. Pra, paratë e zekatit të mbledhura në atë fond mund t'u shpërndahen nxënësve. Madje mund të themi se shpërndarja e zekatit në mënyrë të tillë është më frytdhënëse.

A mund të zënë vendin e zekatit taksat e mbledhura nga shteti? Si ishte gjendja në kohën e Profetit?

Siç dihet, zekati është një adhurim i cili realizohet me anë të pasurisë dhe u shpërndahet tetë kategorive të përmendura në Kuran. Prandaj këtu kanë shumë rëndësi personat dhe kategoritë ku jepet zekati. Sepse ata përmenden të specifikuara në Kuran.

Në periudhën e Profetit (s.a.s) zekati shpërndahej në dy mënyra. E para ishte kategoria e nëpunësve, mbledhësve të zekatit të cilët mblidhnin zekatin dhe ia dorëzonin shtetit, pastaj shteti ua shpërndante tetë kategorive të përmendura. Pra, shteti ishte si një lloj organizatori i cili bënte mbledhjen dhe shpërndarjen e zekatit. Mënyra e dytë

ishte mbledhja e zekatit nga nëpunësit dhe shpërndarja e tij njerëzve në nevojë të atij vendi.

Zekati mund të mblidhet dhe nga shteti dhe nuk ka ndonjë dyshim në lidhje me këtë çështje. Në këtë rast, shteti kryen funksionin e shpërndarësit të zekatit. Prandaj shtetit nuk mund t'i jepet zekat. Por kjo nuk vjen në kuptimin që shteti nuk duhet të marrë asgjë nga populli. Sepse përveç zekatit shteti mund të mbledhë taksa të tjera të cilat i shërbejnë për të plotësuar nevojat e tij. Prandaj ne nuk duhet të mendojmë që shteti po na shfrytëzon duke na marrë taksat dhe të mos japim zekat. Duhet t'i dallojmë këta dy gjëra nga njëra-tjetra.

Përveç kësaj, zekati u jepet personave myslimanë. Nëse e pranojmë shtetin si person juridik duhet ta respektojmë tërësisht me rregullat e tij. Ka dhe shtete të cilat pavarësisht se kanë popullsi myslimane mbledhin taksa të caktuara.

A duhet të jepet zekat për makinën?

Mes gjërave të nevojshme të njeriut siç janë shtëpia, orenditë shtëpiake, ushqimet, rrobat e të tjera hyn edhe makina. Nëse makinën e shohim me syrin e gjërave të cilat janë të nevojshme për një njeri, atëherë kuptohet se nuk jepet zekat për të. Por nëse përveç plotësimit të nevojave, një person ka tre ose katër makina të tjera, atëherë mund të themi se këtu hyn në temë zekati. Sepse tashmë këto makina e kanë kaluar kufirin e plotësimit të nevojave të atij personi dhe janë mjete luksi. Duke parë vlerën e tyre, duhet të jepet zekat.

PJESA E GJASHTË

HAXHI

Udhëtimi i shenjtë...

HAXHI



"Shpërblimi i haxhit të pranuar nuk
është tjetër vetëm se xheneti."

hadith



Haxh quhet vizita e disa vendeve të caktuara brenda një periudhe specifike sipas disa rregullave të përcaktuara. Ndryshe mund të themi që haxhi është një adhurim i bërë në një periudhë të caktuar të vitit dhe konsiston në veshjen e ihramit duke bërë nijetin përkatës, në bërjen e tavafit të Qabes, qëndrimit në Arafat. Ihrami është kusht i haxhit ndërsa tavafi dhe qëndrimi në Arafat janë pjesët përbërëse të tij.

Çdo mysliman, burrë apo grua, nëse plotëson kushtet, pra nëse ka mundësi financiare dhe shëndetësore e ka obligim (farz) të shkojë në haxh të paktën një herë në jetën e tij. Njeriu nuk duhet ta shtyjë këtë obligim, por duhet ta realizojë sapo t'i jepet mundësia.

Kushtet e detyrimit të haxhit

Një person i cili e ka obligim haxhin duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të jetë mysliman

2. Të ketë arritur moshën e pjekurisë.

3. Të jetë i shëndoshë mendërisht.

4. Të jetë i lirë.

5. Të ketë aq mundësi financiare sa të përballojë shpenzimet e familjes gjatë kohës që do të jetë në haxh, shpenzimet e rrugës dhe të qëndrimit në vendet e shenjta.

Kushtet që duhet të plotësoje personi që kryen haxhin:

Kushtet që duhet të plotësojë personi i cili e ka obligim haxhin janë:

1. Të jetë mirë nga ana fizike. Personi i cili mund të kryejë haxhin duhet të jetë i shëndoshë fizikisht. Nëse vuan nga ndonjë sëmundje atëherë mund të ngarkojë dikë tjetër në vend të tij për kryerjen e haxhit.

2. Siguria e rrugës. Nuk duhet të ketë luftë apo situata të tjera që mund të pengojnë vajtjen në haxh.

3. Gruaja duhet të jetë e shoqëruar nga burri apo nga të afërmit (si: djali, vëllai, babai, apo ndonjë i afërm me të cilin e ka të ndaluar të martohet).

4. Gruas të cilës i ka vdekur burri apo është ndarë nga ai duhet të presë kohën e caktuar (*iddet*).

5. Të jetë i lirë, të mos ketë pengesa si burgu.

KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË HAXHIT

Për pranimin e haxhit duhet të plotësohen këto tre kushte:

1. Ihrami. Personi i cili bën nijet të kryejë haxhin gjatë

kohës së ihramit duhet të largohet nga disa vepra dhe sjellje dhe i ka të ndaluara deri në përfundim të kohës së ihramit.

2. Koha. Farzet e haxhit, hyrja në ihram, qëndrimi në Arafat dhe bërja e tavafit duhet të kryhen brenda një afati të caktuar.

Haxhi kryhet brenda dhjetë ditëve të muajit *Dhul Hixhxhe.* Të gjitha veprimet (qëndrimi në Arafat, tavafi, vrapimi mes dy kodrave, gjuajtja e shejtanit me gurë) duhet të kryhen brenda një afati të caktuar përndryshe haxhi nuk pranohet.

3. Vendi. Farzet e haxhit duhet të zbatohen në vende të përcaktuara. Qëndrimi në Arafat duhet të bëhet në Arafat ndërsa tavafi duhet të bëhet brenda xhamisë së shenjtë.

SHTYLLAT E HAXHIT

Qëndrimi në Arafat

Haxhi nuk pranohet nëse nuk bëhet qëndrimi në Arafat. Qëndrimi bëhet në Arafat në një vend 25 km në veri lindje të Mekës, jashtë zonës së shenjtë. Personat të cilët gjatë kohës së haxhit nuk mund ta arrijnë qëndrimin në Arafat duhet të presin një vit për ta plotësuar.

Kushtet e pranimit të qëndrimit janë këto:

Të veshësh ihramin me nijetin e haxhit.

Qëndrimi të bëhet në Arafat apo brenda kufijve të tij, që nga dreka e ditës së arefes (një ditë para Bajramit) deri në namazin e sabahut të ditës së Bajramit.

1. TAVAFI I VIZITËS

Haxhi nuk quhet i plotësuar nëse nuk bëhet tavafi i

vizitës. Tavafi fillon nga një qoshe e gurit të zi dhe vazhdon duke bërë shtatë rrotullime rreth Qabes. Çdo rrotullim quhet *shaut* dhe tavafi përbëhet nga shtatë shaute.

Kushtet e pranimit të tavafit janë:

Bërja e tavafit në kohën e caktuar: Tavafi i vizitës ndryshe quhet dhe *'tavafi ifada'*. Koha e tavafit të vizitës fillon nga sabahu i ditës së parë të Bajramit. Edhe pse mund të bëhet deri në fund të jetës, është më e preferuar të realizohet deri në perëndimin e diellit të ditës së tretë të Bajramit.

Nijeti.

Të bëhet pjesa më e madhe e rrotullimeve: Sipas medhhebit Hanefi tavafi pranohet nëse bëhen të paktën katër rrotullime.

VAXHIBET E HAXHIT

Përveç kushteve dhe shtyllave, haxhi ka disa vaxhibe. Haxhi pranohet edhe nëse nuk zbatohen ata. Por nëse braktisen pa asnjë shkak, atëherë konsiderohet tahrimen mekruh. Këto janë pesë:

1. **Vrapimi mes kodrave Safa dhe Merve**

Vrapimi mes dy kodrave Safa dhe Merve, të cilat ndodhen në pjesën lindore të Qabes, fillohet nga Safa dhe përfundon në Merve, ndryshe quhet edhe *sa'j*, përbëhet nga katër vajtje dhe tre ardhje. Çdo vrapim nga Safa në Merve dhe anasjelltas quhet një *shaut*.

Vrapimi bëhet pas hyrjes në ihram.

Vrapimi bëhet pas fillimit të muajve të haxhit.

Bëhet menjëherë pas një tavafi të pranuar.

Bëhet pjesa më e madhe e *shauteve*, të paktën katër.

Vrapimi të fillohet nga kodra Safa.

2. **Qëndrimi në Muzdelife**

Gjatë haxhit është sunet që natën e cila lidh ditën e arefesë me ditën e Bajramit ta kalosh në Muzdelife, një zonë mes Minasë dhe Arafatit. Ndërsa qëndrimi aty nga agimi deri në lindjen e diellit të ditës së parë të Bajramit është vaxhib.

Kushtet e pranimit të qëndrimit:

Të jesh i veshur me ihram me nijetin e haxhit.

Të ketë realizuar qëndrimin në Arafat.

Të bëhet brenda kufijve të Muzdelifes. Është sunet të bëhet rreth *Meshari Haramit*.

Të bëhet brenda një afati të caktuar.

3. **Goditja me gurë e shejtanit**

Gjatë ditëve të Bajramit haxhinjtë gjuajnë me gurë tre shtyllat, ditën e parë në Mina gjuajnë vetëm shtyllën e madhe pastaj në ditët e tjera gjuajnë dy shtyllat e tjera, të mesmen dhe të voglën. Goditja e shejtanit me gurë mund të fillojë nga sabahu i ditës së parë të Bajramit deri në perëndim të ditës së katërt të Bajramit.

Kushtet e vlefshmërisë së goditjes së shejtanit:

Shtyllave u hidhen gurë me dorë.

Gjërat që shërbejnë për të gjuajtur mund të jenë gurë, baltë e tharë apo materiale të tjera me të cilat mund të merret tejemum.

Gurët duhet të hidhen një nga një.

Gurët duhet të hidhen drejt shtyllës ose në hapësirën rrethuese të saj.

Gurët duhet të arrijnë në vendin e synuar.

Ai i cili ka fuqi t'i hedhë vetë gurët duhet ta bëjë vetë.

Gurët duhet të hidhen në intervale të caktuara.

4. Qethja tërësisht e flokëve ose shkurtimi i tyre

5. Tavafi i lamtumirës

Është tavafi që bëjnë haxhijtë jo vendali e që vijnë nga vende të largëta para se të kthehen në shtëpitë e atyre

SUNETET E HAXHIT

1. Të bësh tavafin kudum.
2. Dëgjimi i hutbeve të haxhit.
3. Kalimi i natës së arefesë në Mina.
4. Kalimi i natës së Bajramit në Muzdelife.
5. Qëndrimi në Mina gjatë ditëve të Bajramit.
6. Pushimi në Muhassab.

ETIKA E HAXHIT

• Adhurimi i haxhit duhet të bëhet me para të fituara në rrugë të lejuara.

• Personat të cilët nisen për haxh duhet t'i kërkojnë hallallëk personave që u kanë hyrë në hak.

• Duhet të pendohet sinqerisht dhe me vendosmëri

për të mos bërë më mëkate.

• Brenda mundësive duhet të bëjë kaza adhurimet e lëna pa i realizuar.

• Duhet të marrë njohuri rreth haxhit nga persona të mirinformuar.

• Të largohet nga vese si krenaria e mendjemadhësia, të pasqyrojë devotshmëri dhe bindje.

• Të ketë një shok rruge të përshtatshëm me të cilin mund të komunikojë mirë.

• Të falë nga dy rekate namaz para se të niset për rrugë dhe kur të kthehet në shtëpi.

• Të përshëndetet me miq e të afërm para se të niset.

• Gjatë udhëtimit si dhe gjatë periudhës së haxhit të qëndrojë larg sjelljeve ofenduese, grindjeve.

• S'duhet të harxhojë kohën kot por të bëjë dua, dhikër, tesbih, salavate dhe të lexojë Kuran.

UMRE

Është një adhurim i pakufizuar në një periudhë kohore, i cili konsiston në veshjen e ihramit, bërjen e tavafit dhe sa'jit, qethjes dhe daljes nga ihrami. Umreja mund të bëhet në çfarëdo lloj periudhe të vitit.

Umreja ka dy farze, ihramin dhe tavafin. Ihrami është kusht ndërsa tavafi është shtyllë e saj. Ndërsa vrapimi mes Safasë dhe Merves, qethja e flokëve janë vaxhibet.

SI BËHET UMREJA

Nëse personi i cili do të bëjë Umren është vendas, hyn

në Ihram në *mikat*, nëse është jashtë vendeve të shenjta, hyn në ihram sipas rregullave dhe fal dy rekat 'namaz ihrami'. Pas namazit bën nijetin kështu: *"O Allah, dua ta bëj këtë Umre për të fituar kënaqësinë Tënde. Ma lehtëso dhe pranoje!"* dhe më pas shton *"Lebbejk Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejk, innel hamde uen ni'mete leke uel mulk la sherike leke"*.

Kur vjen tek vendet e shenjta bën nijetin për tavafin *"O Allah dua ta bëj tavafin për të fituar kënaqësinë Tënde, ma lehtëso tavafin dhe ma prano!"* dhe pastaj vazhdon me tavafin. Pas tavafit fal dy rekat namaz tavafi, bën nijetin për *sa'jin* kështu: *"O Allah dua të bëj sa'jin për hatrin Tënd, me lehtëso dhe pranoje"*. Pas nijetit kryen vrapimin shtatë herë nga Safa në Merve, katër vajtje dhe tre ardhje. Pas sajit i qeth flokët tërësisht ose i shkurton dhe del nga ihrami. Në këtë mënyrë ai e plotëson Umren.

Ndryshimi i Umres nga Haxhi përveç specifikave në Arafat, Muzdelife dhe Mina është mosbërja e tavafit të të largtëve (kudum) dhe të lamtumirës.

LLOJET E HAXHIT

A. Llojet e haxhit sipas konkluzionit

Nga ana e konkluzioneve fetare, haxhi ndahet në tre lloje, farz, vaxhib dhe nafile.

Farz është haxhi i detyruar një herë në jetë për çdo mysliman që i plotëson kushtet e tij. Vaxhib është kryerja e haxhit të premtuar edhe pse nuk e ka farz kryerjen e tij. Edhe kazaja e haxhit të filluar por të prishur është vaxhib. Haxhi i bërë për dëshirën e Allahut jashtë farzit dhe vaxhibit është haxhi nafile. Haxhet të cilat kryhen përveç haxhit farz konsiderohen si haxhe nafile.

B. **Llojet e haxhit sipas përbërjes**

Sipas përbërjes haxhi ndahet në tre lloje: haxhi ifrad, haxhi temettu dhe haxhi kiran.

Haxhi ifrad

Haxhi i bërë pa umre. Është haxhi i cili bëhet brenda muajve të haxhit, me nijetin vetëm për haxh para të cilit nuk bëhet umre. Personat të cilët bëjnë haxhin ifrad pas mbarimit të haxhit mund të bëjnë umre sa të duan. Ata që kryejnë haxhin ifrad nuk e kanë vaxhib të therin kurban.

Haxhi temettu

Në kohën e haxhit, në fillim bëhet nijet për umre, hyhet në ihram dhe bëhet umreja. Pastaj po në atë kohë personi bën nijetin për haxh dhe hyn në ihram dhe kryen dhe haxhin.

Ata që duan të bëjnë haxhin temettu në fillim bëjnë nijetin dhe hyjnë nën ihram vetëm për umre. Pasi kryen umren, qethet, del nga ihrami dhe një ditë para ditës së arefes hyn përsëri në ihram me nijetin për haxh dhe zbaton rregullat përkatëse të haxhit.

Personat që bëjnë haxhin temettu e kanë vaxhib therjen e 'kurbanit të falenderimit'.

Haxhi kiran

Është kryerja e umres dhe e haxhit bashkë nën një qëllim dhe nën një ihram në kohën e haxhit.

Personat që bëjnë haxhin kiran hyjnë nën ihram në kufijtë e mikatit dhe bëjnë nijetin për haxh dhe umre bashkë. Kur vijnë në Mekë në fillim bëjnë umren dhe me të njëjtin ihram kryejnë haxhin në kohën e tij. Pasi kryejnë

haxhin dalin nga ihrami.

Ashtu si tek haxhi temettu, edhe personat që kryejnë haxhin kiran e kanë vaxhib therjen e kurbanit.

Kushtet e haxhit Temettu dhe Kiran

Vendasit, personat të cilët jetojnë brenda kufijve të mikatit, në zonat Harem dhe Hil, nuk e kanë të lejuar të kryejnë haxhin Temettu dhe Kiran. Këta mund të bëjnë vetëm haxhin ifrad.

Umreja dhe haxhi duhet të bëhen në muajt e haxhit të të njëjtit vit. Nëse umreja kryhet pa hyrë muajt e haxhit atëherë haxhi nuk quhet temettu apo kiran por është haxh ifrad.

Pas kryerjes së umres në muajt e haxhit nuk duhet të ketë 'sahih ilmam'. Sahih ilmam do të thotë kthimi në shtëpi pas umres ose dalja jashtë kufijve të mikatit.

Këta tre lloje haxhi mund t'i radhisim kështu:

Haxhi kiran, temettu, ifrad.

Obligimi i haxhit realizohet nëse kryhet ndonjëri prej tyre.

Njeriu i cili bën haxhin

• Pasqyron ndjenja të barazisë mes njëri-tjetrit duke u veshur thjesht dhe duke lëvizur nën të njëjtat kushte me haxhinjtë e tjerë.

• Beson se fama, pushteti, pasuria dhe mallrat edhe pse sot ekzistojnë nesër mund të zhduken. Në këtë mënyrë tek ai lind dhe zhvillohet ndjenja e drejtësisë.

• Kupton që ndryshimi mes racave, ngjyrës, gjinisë e gjuhës është i parëndësishëm. Beson në rëndësinë që feja islame i ka dhënë vëllazërimit.

• Mendon për ditën e fundit në të cilën do të japë llogari për veprat e tij dhe ndërgjegjësohet për përgatitjen për ahiret.

• Fiton virtyte të bukura si durimi, përballimi i vështirësive, të lëvizurit bashkarisht, ndihmesa ndaj njëri-tjetrit, mbështetja dhe besimi.

• Falënderon Allahun për mirësitë që i ka dhuruar si shëndeti, aftësitë, pasuria e të tjera.

• Përjeton më thellë mesazhet e Profetit (a.s) dhe të shokëve të tij duke parë e shëtitur në vendet ku kanë jetuar ata.

• Duke parë se krahas aspektit individual, feja i jep përparësi dhe atij kolektiv, ndërgjegjësohet për përgjegjësitë dhe detyrat që ka ndaj shoqërisë.

DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME HAXHIN

A është i lejuar haxhi nafile?

Fatkeqësisht njerëz të cilët nuk kanë lidhje me fenë islame flasin për haxhin si një adhurim i cili i sjell përfitime materiale arabëve dhe humbje valutore haxhijve. Këto fjalë ndikojnë te disa myslimanë, edhe pse haxhi është urdhër i Allahut (xh.sh). Gjërat të cilat përfitohen nga vizita e atyre vendeve të shenjta nuk mund të merren nga askund tjetër. Asgjë nuk mund të zërë vendin e haxhit. Ai është një nga pesë shtyllat mbi të cilat ndërtohet Islami. Ebu Hanife do të shprehej kështu: "Kërkova për të parë se cili është adhurimi më i frytshëm. Pasi shkova në haxh kuptova që ai është adhurimi më frytdhënës." Prandaj ai

person që ka mundësi financiare pas kryerjes së haxhit farz le të shfrytëzojë mundësitë dhe të bëjë haxh nafile dhe të mos largohet nga burimi i mëshirës.

Personi i cili kryen obligimin e haxhit bashkohet me ndjenjën e shërbimit me të cilën veprojnë një pjesë e shoqërisë, mund të dëgjojë këshillat e tyre, të drejtojë sjelljet dhe veprat e tij drejt rrugës së drejtë dhe mund të japë një kontribut shumë të rëndësishëm në emër të fesë Islame.

A mund të shkojë në haxh e shoqëruar nga një familje tjetër një grua e cila ka burrin të sëmurë?

Haxhi ka kushtet dhe disa domosdoshmëri të cilat pengojnë realizimin e tij. Përveç tyre çdo njeri e ka farz të shkojë në haxh. Por në rastin e gruas gjendja ndryshon pak.

Në fillim, për të kryer haxhin gruaja duhet të ketë aq pasuri personale për ta përballuar atë. Nëse ajo ka mundësi financiare për të përballuar shpenzimet e haxhit atëherë e ka farz kryerjen e tij. Meqë shpenzimet e fëmijëve dhe të tjerëve përballohen nga burri, kjo grua duhet të shkojë në haxh. Por për të shkuar atje përveç anës financiare gruaja duhet të jetë e shoqëruar nga një i afërm.

Duke u bazuar edhe tek hadithet e Profetit (s.a.s), një grua e cila beson Allahun dhe ditën e fundit nuk mund të ndërmarrë e vetme një udhëtim në një largësi tre ditore. Në transmetime të tjera ky numër ndryshon në dy ose në një ditë. Pra, një grua e cila ka mundësi financiare për të kryer haxhin por nuk plotëson kushtin e shoqëruesit të afërm, nuk ngarkohet me obligimin e haxhit. Për këtë arsye edhe ai haxh është i pavlefshëm. Sepse shoqërimi nga një i afërm është një nga kushtet e vlefshmërisë së haxhit. Prandaj kjo grua duke dashur të fitojë sevape

duke kryer një adhurim të urdhëruar thyen disa rregulla dhe bën mëkat.

Në fillim kjo mund të duket e çuditshme, por duke marrë parasysh gjendjen e Qabes në kohën e haxhit, mbipopullimin e saj e gjendjet e grave, ky kusht është mëshirë për gratë. Nëse e shohim çështjen nga ana e mirësive, kuptohet se një kusht i tillë është i domosdoshëm. Meqë nuk e ka obligim haxhin, në vend që të bëjë mëkat, kjo grua duhet të kryejë adhurimet me bindje e devotshmëri dhe të përjetojë në shpirt vuajtjen e mosshkuarjes në haxh, të përpiqet të përfitojë kënaqësinë e Allahut (xh.sh) dhe t'i lutet Atij për plotësimin e këtij obligimi në të ardhmen.

PJESA E SHTATË

KURBANI

Një mjet afrimi tek Allahu..

Kurbani



"Le të mos na afrohet ai i cili ka

mundësi të therë kurban dhe nuk e bën."

Hadith



Kurbani është një adhurim i cili bëhet në ditët e Bajramit me qëllimin e afrimit te Allahu (xh.sh) dhe konsiston në therjen e një bagëtie të përshtatshme për therje.

Sipas medhhebit Hanefi prerja e kurbanit është vaxhib ndërsa sipas medhhebeve të tjera është një sunet i fortë i cili nuk duhet braktisur.

Kurbani edhe pse mund të pritet në ditën e parë, të dytë dhe të tretë të Bajramit, më e pëlqyeshme është prerja në ditën e parë të tij.

KUSHTET E THERJES SË KURBANIT

Therja e kurbanit është vaxhib për personin i cili plotëson këto kushte:

1. Të jetë mysliman.
2. Ka zhvillim mendor normal dhe ka mbushur

moshën e pubertetit.

3. Të mos jetë udhëtar.

4. Të ketë pasurinë minimale në vlerën e *nisabit*. (Nëse personi veç plotësimit të nevojave të tij, nuk ka borxhe dhe ka një pasuri e cila ka vlerën në para të 85 gr ar ose 595 gr argjend.)

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KAFSHA PËR KURBAN

Kafsha e cila do të bëhet kurban duhet të plotësojë disa veçori:

1. Kurban bëhen kafshë të imta dhe të trasha si dashi, cjapi, dhia, lopa, bualli dhe deveja, të të dyja gjinive.

2. Nëse duam të therim kurban kafshë të imta si dashi apo cjapi, kafsha duhet të ketë mbushur vitin. Por edhe prerja e një dashi gjashtëmujor të zhvilluar si një dash një vjeçar është e lejuar. Ndërsa kafshë të tjera si lopa, bualli duhet të plotësojnë dy vjet, ndërsa devetë pesë vjet për t'u bërë kurban. Dashi apo cjapi theret në emër të një personi. Ndërsa kafshët si lopa, bualli, deveja mund të theren në emër të një deri në shtatë persona.

3. Kurbani i cili theret vetëm me qëllimin e afrimit tek Allahu (xh.sh) duhet të jetë i shëndetshëm dhe nuk duhet të ketë ndonjë mangësi e cila mund të bëhet pengesë për therjen e tij.

Mangësitë të cilat pengojnë bërjen kurban të kafshës

- Mosshikimi me një ose me të dy sytë.
- Nëse çalon dhe nuk mund të ecë deri tek vendi i therjes.
- Nëse e ka njërin ose të dy veshët e prerë.

• Nëse i kanë rënë shumica apo të tërë dhëmbët.

• Thyerja e brirëve nga rrënja.

• Nëse i ka të këputura gjëndrat seksuale dhe majat e gjirit.

• Nëse është këputur gjysma apo më shumë se një e treta e bishtit.

• Dobësia e tepërt dhe mosqëndrimi në këmbë.

• Nëse ka lindur pa vesh dhe bisht.

• Të jetë e pakontrollueshme.

• Nëse është e sëmurë rëndë.

• Nëse tek kurbani që keni marrë vini re një nga këto mangësi apo i shikoni më vonë, duhet ta ktheni dhe të therni një tjetër në vend të tij. Por nëse kurbani i një personi të varfër paraqet disa mangësi nuk është e nevojshme të marrë një tjetër.

Mangësi të cilat nuk pengojnë bërjen kurban të kafshës

• Nëse sytë i ka të shtrembër dhe ka shikim të dobët.

• Nëse çalon me njërën këmbë por mund t'i përdorë mirë tre këmbët e tjera.

• Nëse ka lindur pa brirë apo i ka të thyera.

• Nëse ka vrima në veshë dhe i ka si të përgjysmuar.

• T'i kenë rënë vetëm një pjesë e dhëmbëve.

• Nëse është i çekuilibruar por mund të kontrollohet.

• Nëse ka të prerë më pak se një të tretën e bishtit, gjëndrave seksuale dhe veshëve.

• Nëse ka lindur me veshë të vegjël.

• Mund të jetë me zgjebe por është e shëndoshë.

• Nëse ka përdredhje të organeve seksuale.

• Prerja e një kurbani me të tilla mangësi edhe pse është mekruh lejohet.

MËNYRA E THERJES SË KURBANIT

1. Kafsha e cila do të theret për kurban duhet të kthehet nga kibla pa u vrarë.

2. Këndohet lutja në këmbë.

3. Merret tri herë tekbir: "*Allahu ekber, Allahu ekber, la ilahe il'lallahu uallahu ekber, Allahu ekber ue lil'lahil hamd*".

Kurbani është mustehab të pritet nga i zoti apo nga ndonjë prerës i mirë i cili shoqërohet nga i zoti i kurbanit gjatë therjes.

Mishi i kurbanit të prerë ndahet në tre pjesë. Një pjesë ndahet për pjesëtarët e familjes, një e treta u ndahet të afërmve dhe komshinjve dhe një pjesë të varfërve.

KURBANI AKIKA

Është kurbani i cili theret në shenjë falënderimi ndaj Allahut për lindjen e një fëmije.

Kurbani akika është mubah sipas medhhebit hanefi ndërsa për medhhebet e tjera është sunet.

Profeti (a.s.) ka prerë nga një kurban për secilin prej nipërve Hasan dhe Husejn si dhe ka këshilluar umetin të presë kurban për lindjen e vajzës apo djalit.

Kurbani akika është mustehab të theret në ditën e shtatë të lindjes së fëmijës. Përveç kësaj mund të themi se ky kurban mund të pritet nga lindja deri në moshën e pjekurisë. Në të njëjtën ditë kështillohet dhe vendosja e emrit dhe prerja e flokëve, shpërndarja sadaka e vlerës së tyre në ar.

Çdo kafshë e cila plotëson kushtet për t'u bërë kurban është e përshtatshme për kurbanin akika. Nga mishi i kurbanit mund të hanë njerëzit e familjes dhe të varfrit.

Profeti (s.a.s) ka ndaluar zakonin e ngjyrosjes së fëmijës me gjakun e kurbanit.

DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME KURBANIN

Çfarë vendimi merret për ata persona që kanë mundësi të therin kurban por nuk e bëjnë?

Nëse një person gjatë ditëve të Bajramit ka mundësi të therë kurban por nuk e bën dhe nëse më vonë varfërohet e nuk mund të presë as kurban, atëherë ky person e ka obligim të japë sadaka në vlerën e një dashi. Kur të ketë mundësi duhet ta japë këtë shumë.

A mund të presim kurban për të vdekurit?

Një person mund të presë kurban për një të vdekur me qëllimin e shtimit të sevapeve të të vdekurit. Ashtu siç mund të bëhet haxhi, të jepet sadaka për të vdekurin ashtu mund të theret edhe kurban. Pikërisht Profeti (s.a.s) ka therë kurban në emër të atyre personave që nuk kanë pasur mundësi ta therin.

Edhe Aliu (r.a) ka therë dy deshë, njeri prej të cilëve e

therte në emër të Profetit. Kur e pyetën se pse vepronte kështu ai iu përgjigj: "I Dërguari i Allahut ma ka lënë amanet të pres kurban dhe për të sa të jem gjallë."

Porosia e Profetit për therjen e kurbanit tregon se ai parapëlqente të therej kurban në emër të tij. Prandaj, duke u nisur nga ky hadith, personat të cilët kanë mundësi financiare të mira le të presin për Profetin një herë në vit një dash apo cjap ose të jenë pjesë përbërëse e shtatë pjesëve të lopës. Allahu i Madhëruar na e mundësoftë prerjen e kurbanit në emër të Profetit (s.a.s)!

Një person i cili ther kurban për shpirtin e personit të vdekur mund të hajë nga mishi i kurbanit dhe t'ua shpërndajë të tjerëve. Kurbani i prerë me këtë qëllim nuk është kusht të pritet në ditët e Bajramit.

Nëse personi i cili ka vdekur ia ka lënë porosi të therin kurban në emër të tij atëherë duhet ta therim gjatë ditëve të Bajramit. Nga ky lloj kurbani nuk mund të hajë personi që e pret. I gjithë mishi duhet t'u shpërndahet të varfërve si sadaka.

A mund të jepet sadaka në vend të kurbanit?

Çdo adhurim zë një vend të veçantë. Zekati ka vendin e tij, sadakaja, kurbani... Thelbi i Kurban Bajramit është therja e kurbanit për kënaqësinë e Allahut (xh.sh). Nëse kjo nuk bëhet, atëherë nuk plotësohet obligimi i kurbanit. Për këtë arsye personat që në ditët e Bajramit japin sadaka në vend të kurbanit, ajo sadaka nuk zë asnjëherë vendin e tij.

A mund të theret kurban në tyrbe, ceremoni?

Nuk ka asnjë pengesë në vizitimin e varreve të personave të njohur dhe të ditur, për sa kohë nuk

kërkohet ndihmë prej tyre. Më përpara ka pasur persona, mes tyre të pasur, të cilët kanë therë kurbane gjatë vizitës në tyrbe dhe mishin e kurbanit ua kanë shpërndarë të varfërve. Kjo praktikë e bukur fatkeqësisht është harruar me kalimin e kohës dhe nënvlerësuar dhe në vend të qëllimit të pastër është vendosur qëllimi "do pres kurban për filan person". Kjo është shumë e rrezikshme nga ana e besimit dhe mund ta çojë njeriun në kufër. Ka pasur persona që i kanë quajtur 'qafirë' ato që therin kafshë në tyrbe me atë qëllim. Por nuk është e nevojshme të arrihet deri këtu. Sepse çdo kafshë theret në emër të Allahut dhe gjatë therjes shqiptohen fjalët '*Bismillah, Allahu ekber*'. Ajo që duhet nënvizuar këtu është qëllimi therësit të kurbanit. Vendimi lidhet me këtë qëllim. P.sh., nëse në një vend theret kurban për një burrë shteti atëherë mund të bëjmë fjalë për shirk dhe rrjedhimisht mishi i atij kurbani nuk hahet. Por nëse ai bëhet shkak për të bërë kurban në emër të Allahut, atëherë mishi mund të hahet. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për ceremonitë. Këtu e rëndësishme është zemra, qëllimi brenda saj, të cilin pas Allahut e di më mirë personi vetë. Të njëjtën gjë themi dhe për kurbanet që theren në tyrbe.

A mund të bëhen kurban gjeli dhe pula?

Kafshët të cilat bëhen kurban janë nga lloji i bagëtive të imta si dashi, cjapi, dhia, të bagëtive të rënda si lopa, bualli, buallica, deveja. Dashi duhet të plotësojë vitin për t'u bërë kurban. Por siç e thamë dhe më lart dhe një dash gjashtë muajsh i cili ka zhvillimin e një dashi një vjeçar mund të bëhet kurban.

Dashi, delja, cjapi mund të theren nga një person i vetëm ndërsa për lopën, devenë mund të bashkohen shtatë persona.

Kafshë si pula, gjeli, pata, gjeli i detit nuk mund të bëhen kurban. Madje personi i cili premton se do të bëjë kurban një nga këto kafshë nuk është i ngarkuar ta zbatojë premtimin. Sepse me këto lloj kafshësh nuk mund të kushtohet njeriu. Ai i cili përkushtohet dhe premton therjen e tyre nuk ka premtuar asgjë. Kafsha nuk theret për mish, por për kurban.

DISA SURE DHE DUA

SURJA FATIHA


بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيْمِ

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ رَبِّ الْعَالَمِيْنَ ۙ اَلرَّحْمٰنِ الرَّحِيْمِ ۙ مَالِكِ يَوْمِ الدِّيْنِ ؕ

اِيَّاكَ نَعْبُدُ وَاِيَّاكَ نَسْتَعِيْنُ ؕ اِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيْمَ ۙ

صِرَاطَ الَّذِيْنَ اَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ ۙ غَيْرِ الْمَغْضُوْبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّآلِّيْنَ

1. Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm
2. El hamdu lil'lâhi rabbil âlemîn
3. Er Rahmânir Rahîm.
4. Mâliki jeumid dîn
5. Ijjâke na'budu ue ijjâke nesteîn
6. Ihdines sirâtal mustekîm
7. Sirâtal ledhîne en'amte alejhim, gajril magdûbi alejhim ue led dâl'lîn. Âmîn

Kuptimi

1. Me emrin e Allahut, Mëshirëbërësit, Mëshirëplotit!

2. Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve,

3. të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit,


4. Sunduesit të Ditës së Gjykimit.

5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.

6. Udhëzona në rrugën e drejtë!

7. Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!

SURJA FIL




Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Elem tera kejfe feale rabbuke bi as'habil fîl
2. Elem jexh'al kejdehum fî tadlîl
3. Ue ersele alejhim tajran ebâ bîl
4. Termîhim bi hixhâratim min sixhxhîl
5. Fexhealehum ke asfim me'kûl

Kuptimi

1. Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?
2. A nuk ua prishi atyre kurthin,
3. duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh,
4. të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur?
5. Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë.

SURJA KUREJSH



Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Li îlâfi kurajsh

2. Îlâfihim rihletesh shitâi ues sajf

3. Fel ja'budû rabbe hâdhel bejt

4. El ledhî et'amehum min xhûin ue âmenehum min hauf

Kuptimi


1. (Të paktën) për mirësinë (e vazhdueshme të Zotit) e paqes dhe sigurisë së fisit Kurejsh,

2. për paqen dhe sigurinë në udhëtimet e tyre dimrit e verës.

3. Lëri ata ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes),

4. i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.

SURJA MAUN



Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Eraejtel ledhî jukedhdhibu bid dîn
2. Fe dhâlikel ledhî jedu'ul jetîm
3. Ue lâ jehuddu alâ taâmil miskîn
4. Fe uejlul lil musal'lîn
5. El ledhîne hum an salâtihim sâhûn
6. El ledhîne hum jurâûne
7. Ue jemneûnel mâûn

Kuptimi

1. A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?
2. Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët
3. dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit.
4. Mjerë për ata, të cilët kur falen,
5. janë të pakujdesshëm për namazet,
6. të cilët duan vetëm që të duken
7. dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve.

SURJA KEUTHER



Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Innâ e'tajnâkel keuther

2. Fe sal'li li rabbike uenhar

3. Inne shânieke huvel ebter


Kuptimi

1. Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira,

2. andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!

3. Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë.

SURJA KAFIRUN




Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Kul jâ ejjuhel kâfirûn
2. Lâ a'budu mâ ta'budûn
3. Ue lâ entum âbidûne mâ a'bud
4. Ue lâ ene âbidum mâ abedtum
5. Ue lâ entum âbidûne mâ a'bud
6. Lekum dînukum ue lije dîn

Kuptimi

1. Thuaj: "O ju mosbesimtarë!
2. Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni
3. dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj.
4. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni
5. dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!
6. Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!"

SURJA NASR



Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Idhâ xhâe nasrullâhi uel fet'h

2. Ue raejten nâse jed'hulûne fî dînil'lâhi efuâxhâ

3. Fe sebbih bi hamdi rabbike uestegfirhu innehu kâne teuuâbâ


Kuptimi

1. Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)

2. dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe,

3. atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.

SURJA MESED


بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيْمِ
تَبَّتْ يَدَآ اَبِيْ لَهَبٍ وَّتَبَّ ۭ مَآ اَغْنٰى عَنْهُ مَالُهٗ وَمَا كَسَبَ ۭ سَيَصْلٰى
نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ ۚ وَامْرَاَتُهٗ ۭ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ ۚ فِيْ جِيْدِهَا حَبْلٌ مِّنْ مَّسَدٍ

Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Tebbet jedâ ebî lehebin ue tebb
2. Mâ agnâ anhu mâluhu ue mâ keseb
3. Se jaslâ nâran dhâte leheb
4. Uemraetuhû hammâletel hatab
5. Fî xhîdihâ hablum mim mesed

Kuptimi

1. Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka!


2. Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera.

3. Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara,

4. po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit,

5. në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme.

SURJA IHLAS



Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Kul huuallâhu ehad

2. Allâhus samed

3. Lem jelid ue lem jûled

4. Ue lem jekun lehû kufuuen ehad

Kuptimi


1. Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!

2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.

3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur.

4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!"

SURJA FELEK



Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Kul eûdhu bi rabbil felak

2. Min sherri mâ halak

3. Ue min sherri gasikin idhâ uekab

4. Ue min sherrin neffâthâti fil ukad

5. Ue min sherri hâsidin idhâ hased

Kuptimi

1. Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit,


2. që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar

3. dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri

4. dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)

5. dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë."

SURJA NAS



Bismil'lâhi Rrahmâni Rrahîm

1. Kul eûdhu bi rabin nâs
2. Melikin nâs
3. Ilâhin nâs
4. Min sherril uesuâsil hannâs
5. El ledhî juvesuisu fî sudûrin nâs
6. Minel xhinneti uen nâs

Kuptimi

1. Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve,
2. Sundimtari i njerëzve,
3. i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve,
4. nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)
5. e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve,
6. (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!"

SUBHANEKE

Subhâneke allâhumme ue bi hamdike, ue tebârekesmuke, ue teâlâ xhedduke, ue lâ ilâhe gajruke.

AJETUL KURSI

Allâhu lâ ilâhe il'lâ Hû. El hajjul kajjum. Lâ te'hudhuhû sinetun ue lâ neum. Lehû mâ fis semâuâti ue mâ fil erd. Men dhel ledhî jeshfeu indehû il'lâ bi idhnihi. Ja'lemu mâ bejne ejdîhim ue mâ halfehum, ue lâ juhîtûne bi shej'in min ilmihî il'lâ bi ma shâe. Uesia kursijjuhus semâuâti uel erd, ue lâ jeuduhû hifdhuhumâ, ue huve alijjul adhîm.

DUAJA E KUNUTIT

Allâhumme innâ nesteînuke ue nestegfiruke ue nestehdîke ue nu'minu bike ue netûbu ilejke ue neteuekkelu alejke ue nuthnî alejkel hajra kul'lehû neshkuruke ue lâ nekfuruke ue nahleu ue netruku men jefxhuruk.

Allâhumme ijjâke na'budu ue leke nusal'lî ue nesxhudu ue ilejke nes'â ue nahfidu nerxhû rahmeteke ue nahshâ adhâbeke inne adhâbeke bil kuffâri mulhik.

ETTEHIJATU

Ettehijjâtu lil'lâhi ues salâuâtu uet tajjibâtu esselâmu alejke ejjuhen nebijju ue rahmetullâhi ue berekâtuh. Esselamu alejnâ ue alâ ibâdil'lâhis sâlihîn. Eshedu en lâ ilâhe il'lallâh ue eshedu enne muhammeden abduhû ue resuluh.

SALAVATET

Allâhumme sal'li ala muhammedin ue alâ âli muhammed, kemâ sal'lejte alâ ibrâhîme ue alâ âli ibrâhîme, inneke hamîdun mexhîd.

Allâhumme barik alâ muhammedin ue alâ âli muhammed, kemâ bârekte alâ ibrâhîme ue alâ âli ibrâhîme, inneke hamîdun mexhîd.

DUAJA

Rabbenâ âtinâ fid dunjâ haseneten ue fil âhireti haseneten ue kinâ adhâben nar.

Rabbengfir lî ue li uâlidejje ue lil mu'minîne jeume jekûmul hisâb.

Burimet që janë shfrytëzuar

Kurani Kerim

Axhluni, Ismail b. Muhamed, Keshful-hafa ve muzijlu'l-ilbas, (I-II),

Daru'l –Kutubil-Ilmijje, Bejrut-1985

Ahmed b. Hanbel, el-Musned, (I-IV), EL-Mektebetu'l –Islami, botimi i 5-të, Bejrut-1985

Akademi arastirma hejeti, Udhërrëfyesi i një myslimani, Isik yayinlari, Stamboll, 2005

Asim Efendi, Kamus tercemesi, (I-IV), Istanbul-1304 h.

El-Beyhaki, Ebu Bekr Ahmet b. Husejn, es-Sunenul- Kubra, (I-X), Darul-Mearif, Bejrut, ts.

--------, Shuajbul-iman, (I-VII), thk. Muhamed Said b. Besjuni Zaglul, Darul-Kutubil-Ilmijje, Bejrut-1990

Buhari, Muhamed b. Ismail, Sahihul-Buhari, (I-VIII), el-Mektebetul-Islamijje, Istanbul-1979

Ed-Darekutni, Ali b. Omer, Sunenud-Darekutni, (I-IV), thk, Abdullah Hashim Jemani, Kajro-1966.

Ed-Darimi, Ebu Muhamed Abdullah b. Abdirrahman, Sunenud-Darimi (I-II), Matbaatul-I'tidal, Damask-1349h.

Ebu Davud, Sulejmen b. Esh'as es-Sixhistani, es-Sunen, (I-IV), el-Mektebetul-Islamijje, Stamboll, ts.

Gylen, M. Fethullah, Lëkundjet që solli shekulli, I,II, III, IV, Shtëpia Botuese PRIZMI

----------, Fasildan fasila, I, II, III, IV, Nil yayinlari.

----------, Nën hijen e besimit, I, II, Shtëpia Botuese PRIZMI.

----------, Prizmi, I, II, III, IV, Nil yayinlari.

Hejet, E dua fenë time -2, Mushtu Yayinlari, Stamboll-2004

Hejat, Po mësoj fenë time, DIB yay, Ankara-2004

El-Hejsemi, Nureddin Ali b. Ebi Bekr, Mexhmeuz-zevaid ve menbeul-fevaid, (I-X), Mektebetul –kudsi, Kajro, ts.

El-Kevseri, Muhamed Zahid ibnul-Hasen, Malakatul-kevseri, el-Mektebetul-ezherijje li't-Turas, Kjaro 1994

Ibn Maxhe, Muhamed b. Jezid, es-Sunen, (I-II)Daru Ihjai Kutubil-Arabi, Egjypt-1993.

Ibn Manzur, Xhemaluddin Muhamed b. Mukerrem, Lisanul-arap (I-XV), Darul –fikr, botimi i parë, Bejrut-1994.

Malik b. Enes, Muvatta, thk. Muhamed Fuat Abdulbaki, Darul-hadis, Kajro.

Muslim, Ebul-Husejn el-Haxhaxh, el-Nejsaburi, Sahihul-Muslim, (I-V), El-Mektebetul-Islamijje, Stamboll, 1955.

Naim, Babanzade Ahmed dhe Kamil Miras, Sahihul Buhari Muhtasari Texhrid-i sarih Terxhemesi ve sherhi, Botimi i 9, Gaye matbaacilik ve Sanayai ve Ticaret A.S. Ankara -1987

Nesai, Ahmed b. Shuajb, es-Sunen, (I-VIII), Daru Ihjai't-Turasil-Arabi, Bejrut.

Nursi, Bediuzzaman Said, Risalei-Nur Kulliyati, I-II, Nesil yayinlari, Stamboll 2002

Tirmidhiu, Muhamed b. Isa, El- Xhamius-Sahih, (I-V) Daru Ihjai 't-Turasil-Arabi, Bejrut, 1938

Yazici, Seyfettin, Temel dini bilgiler, DIB yay. Ada Matbaacilik, Ankara 2004.

Ez-Zebidi, Muhibuddin Ebi Fejz es-Sejjid Muhamed Murtaza, Taxhul- arus, min xhevahiril-Kamus, (I-XX), Darul –Fikr, Bejrut, 1994

Zuhajli, el-Fikhul –Islami ve Edilletuhu, Darul-Fikr, Damask, 1985